BULETINI EKONOMIK

mars 2005

Banka e Shqipërisë

ARTIKUJT E PARAQITUR NË KËTË BOTIM, NUK SHPREHIN GJITHMONË OPINIONIN ZYRTAR TË BANKËS SË SHQIPËRISË. KËTYRE ARTIKUJVE LUTEMI T'U REFEROHENI SI MENDIME PERSONALE TË AUTORËVE.

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558

www.bankofalbania.org

Për komentet dhe sugjerimet tuaja na shkruani në:
Sektori i Publikimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.
E-mail: public@bankofalbania.org

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 640 kopje

P Ë R M B A J T J A

Rritja e besimit ndaj tregjeve financiare
Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani, në Konferencën e Pestë të Bankës së Shqipërisë "Banka qendrore në kohën e integrimit" 6

Intervistë e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani, dhënë radios Zëri i Amerikës, Uashington, 4 mars 2005 12

Fjala përshëndetëse e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani, në Kongresin e parë të Kontabilistëve dhe Financierëve, Pallati i Kongreseve, 10 shkurt 2005 15

Raporti mujor i Politikës Monetare 17
I. Zhvillimet kryesore të muajit 17
II. Ecuria e inflacionit në muajin mars 18
III. Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare 23

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë për vitin 2004 35
I. Llogaria korente 35
II. Llogaria kapitale dhe financiare 39

Vlerësimi i gjendjes financiare të sistemit bankar shqiptar për tremujorin e katërt të vitit 2004 41

Dokumenti "Për Misionin e Mbikëqyrjes" 45

Një rishikim i regjimit të targetimit monetar në Shqipëri me disa orientime për të ardhmen 47
1. Hyrje 47
2. Përshkrim i përgjithshëm i politikës monetare në Shqipëri gjatë tranzicionit 48
3. Problemi i komunikimit me regjimin aktual të targetimit monetar 50
4. Regjimi i shënjestrimit të inflacionit: argumentet pro dhe kundër tij për Shqipërinë 51
5. Pengesat në Bankën e Shqipërisë 52
6. Rreziqe të tjera në adoptimin e regjimit të IT 53
7. Regjimet alternative 57
8. Konkluzione 58

Sinjalet e Bankës së Shqipërisë, inflacioni i pritur nga publiku përballë atij të faktuar për vitin 2004 60
1. Hyrje. 60
2. Analiza e rezultateve. 61
3. Konkluzione 66

Banka e Shqipërisë në harkun e tre muajve (janar – mars 2005) 68

Ngjarjet juridike 72

Drejtimi i Bankës së Shqipërisë, 31 mars 2005 75

Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë 76

Banka dhe degë të bankave të huaja 76

Subjekte jobanka 79

Subjektet financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë së tyre, në mbështetje të vendimit nr. 26, datë 29.03.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë: "Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"". 81

Zyra të këmbimeve valutore 82

Unionet e shoqërive të kursim-kreditit 87

Zyra të përfaqësimit të bankave të huaja 87

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

Raporti mujor i Politikës Monetare

Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje). 18

Tabelë 2. Kontributi në inflacion i nëngrupeve të grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji". 20

Tabelë 3. Inflacioni vjetor, inflacioni mujor dhe kontributi i grupeve kryesore. 20

Tabelë 4. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në përqindje). 23

Tabelë 5. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë. 25

Tabelë 6. Ecuria e treguesve monetarë (në miliardë lekë). 28

Tabelë 7. Tregues të tepricës së kredisë ndaj totalit (në përqindje). 30

Tabelë 8. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në përqindje). 30

Tabelë 9. Normat e interesit në lekë (në për qind). 33

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë për vitin 2004

Tabelë 1. Bilanci i Pagesave (në milionë dollarë amerikanë). 40

Një rishikim i regjimit të targetimit monetar në Shqipëri me disa orientime për të ardhmen

Tabelë 1. Treguesit kryesorë ekonomikë të Shqipërisë. 48

Tabelë 2. Agregatët monetarë të planifikuar kundrejt atyre faktikë dhe inflacioni (fund i vitit, ndryshimi në përqindje). 51

Sinjalet e Bankës së Shqipërisë, inflacioni i pritur nga publiku përballë atij të faktuar për vitin 2004

Tabelë 1. Rezultatet përpunimit të përgjigjeve. 62

Tabelë 2: Pagat sipas sektorëve. 63

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

Raporti mujor i Politikës Monetare

Grafik 1. Inflacioni vjetor (në përqindje). 18
Grafik 2. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje). 19
Grafik 3. Inflacioni vjetor i grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në përqindje). 20
Grafik 4. Rritja e shpenzimeve buxhetore. 21
Grafik 5. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në përqindje). 22
Grafik 6. Ndryshimet vjetore të IÇP-së dhe IÇK-së për vitet 2002-2004. 23
Grafik 7. Ecuria e normës bazë të interesit. 24
Grafik 8. Rritja vjetore e agregatit M1 në terma realë. 25
Grafik 9. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë. 26
Grafik 10. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real. 27
Grafik 11. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3. 28
Grafik 12. Kontributi i rritjes së mjeteve valutore neto në rritjen vjetore të M3. 28
Grafik 13. Niveli i mjeteve valutore neto të sistemit bankar. 29
Grafik 14. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë). 29
Grafik 15. Niveli i likuiditetit në sistemin bankar (në milionë lekë). 31
Grafik 16. Normat e interesit në lekë. 32
Grafik 17. Normat e interesit në valutë (mesatare e ponderuar për të gjitha afatet). 34
Grafik 18. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut. 34

Një rishikim i regjimit të targetimit monetar në Shqipëri me disa orientime për të ardhmen

Grafik 1. Normat reale të interesit. 49
Grafik 2. Inflacioni i çmimeve të konsumit dhe inflacioni bazë. 49
Grafik 3. Kursi i këmbimit. 57

Sinjalet e Bankës së Shqipërisë, inflacioni i pritur nga publiku përballë atij të faktuar për vitin 2004

Grafik 1. Ecuria e inflacionit në Shqipëri (1995-2004). 61
Grafik 2. Rritja e parashikuar e pagave (2004) - Konsumatorët. 62
Grafik 3. Rritja e parashikuar e pagave (2004) - Bizneset. 62
Grafik 4. Norma e pritur e inflacionit ndaj asaj të realizuar. 65

RRITJA E BESIMIT NDAJ TREGJEVE FINANCIARE

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI, NË KONFERENCËN E PESTË TË BANKËS SË SHQIPËRISË "BANKA QENDRORE NË KOHËN E INTEGRIMIT".

Zonja dhe Zotërinj,

Është një kënaqësi e madhe që të ndaj me ju disa opinione dhe ide në lidhje me gjendjen aktuale të tregut financiar dhe perspektivat e tij në Shqipëri. Veshur me petkun e Guvernatorit të ri, mund të ndalesha në çështje më të përgjithshme. Megjithatë, vendosa që ta titulloj fjalimin tim "Rritja e besimit ndaj tregjeve financiare", nisur nga vizioni im se krijimi i një tregu financiar të zhvilluar nuk bën gjë tjetër veçse i shërben më mirë objektivave tona themelore, veçanërisht ambicieve tona në fushën e politikës monetare si dhe të politikave të tjera ekonomike.

Banka e Shqipërisë është e kënaqur me rezultatet e politikës monetare që ka hartuar dhe zbatuar gjatë 13 viteve të fundit. Gjithësesi, për të qenë të sinqertë, shpesh inflacioni ka patur edhe devijime për shkak të periudhave të rënies dhe të ngadalësimit të zhvillimit ekonomik. Megjithatë, kthimi i tij në nivele të pranueshme ka qenë i shpejtë dhe, në ndonjë rast, edhe këndshëm jemi surprizuar nga normat e ulëta.

Ne mendojmë se ka ende hapësira në rritjen e saktësisë në matjen e çmimeve dhe të peshave, që zënë grupet e ndryshme në shportën e mallrave dhe të shërbimeve të konsumatorit. Disa mallra ende nuk janë të përfshira në shportë, ndërkohë që disa lëvizje çmimesh janë të vështira të justifikohen. Sidoqoftë, indeksi i çmimeve të konsumit është marrë i mirëqenë, i painfluencuar nga banka qendrore, duke shërbyer si tregues me të cilin matet objektivi final i politikës monetare.

Nisur nga supozimi që normat e inflacionit kanë qenë të sakta, çdokush mund të mendojë se ekonomia shqiptare është një ekonomi mjaft fleksibël, përderisa arrin të sjellë inflacionin në nivele normale brenda një kohe të shkurtër. Ky është një argument që dua ta besoj dhe unë. Mungesa e fleksibilitetit, e vërejtur në disa ekonomi të tjera, duket nuk përbën rast për Shqipërinë. Kam parasysh procedurat e gjata të marrjes apo të largimit nga puna apo shumëllojshmërinë e rregullave që lidhen me tregjet e mallrave dhe të shërbimeve. Mbi të gjitha, vendosja e regjimit të kursit fleksibël të këmbimit ka qenë dhe është një nga kontribuesit kryesorë, i cili ndikon drejtpërdrejt në këtë shkallë të lartë mobiliteti të ekonomisë shqiptare.

Duke iu rikthyer performancës së mirë të politikës monetare, Banka e Shqipërisë deri diku bashkohet me idenë se ndërmjet të tjerash nganjëherë kemi pasur edhe pak fat. Ekonomisë shqiptare vazhdojnë t'i mungojnë disa tipare të rëndësishme dhe kësisoj kanalet e transmisionit të politikës monetare akoma nuk janë plotësisht funksionale.

Nga ana tjetër, sektori financiar është akoma i brishtë dhe ka nevojë për reforma të mëtejshme dhe vigjilencë të madhe. Vetë zhvillimi dhe hapja e tregut do të sjellë më shumë ekspozim e për rrjedhim, mbajtja e stabilitetit financiar bëhet më e vështirë. Është kjo arsyeja që më shtyn të konsideroj rritjen e konfidencës së tregut financiar, si një nga ambiciet e mia si Guvernator i Bankës së Shqipërisë.

Ndryshe nga shumë vende të tjera, historia e Shqipërisë është e varfër në drejtim të trashëgimisë në institucione financiare dhe në instrumente financiare. Tradita jonë nuk është ajo e vendeve të zhvilluara.

Ndonëse nga të dhënat arkivore, përpjekjet e para për të ngritur një bankë kombëtare datojnë me fillimin e shekullit të kaluar, institucionet e ngritura kanë qenë kryesisht në funksion të lehtësimit të transfertave reciproke me vendet e tjera. Edhe pas krijimit të Bankës Kombëtare, përsëri duhet thënë se në Shqipëri institucionet financiare nuk kanë pasur ndonjë rol parësor në jetën ekonomiko – financiare të vendit, megjithë progresin e admirueshëm në konsolidimin e ambientit ekonomik në përgjithësi. Po kështu, edhe gjatë viteve të gjata të ekonomisë së centralizuar, sistemi bankar ishte tipik si ai i vendeve të Evropës Lindore. Një bankë e vetme kryente funksionet e bankës qendrore dhe asaj tregtare, ndërkohë që depozitat e popullatës grumbulloheshin nga arkat e kursimeve dhe paralelisht, një bankë e vogël ishte e specializuar në kreditimin e fermave dhe të kooperativave bujqësore. Jam i bindur se edhe gjatë kësaj periudhe të gjatë për shkaqe nga më të ndryshmet, sektori financiar në Shqipëri për nga shkalla e ndërmjetësimit dhe e fleksibilitetit nuk mund të krahasohet me modelet standarde të Lindjes, përfshirë dhe vendet e rajonit.

Nga ana tjetër, nuk më mbetet të bëj komente në lidhje me segmentet e tjera të sektorit financiar, pasi të gjithë jemi dëshmitarë se faktet historike janë shumë të rralla në këtë kontekst, ndërkohë që i vetmi zhvillim institucional i përket pranisë së një shoqërie shtetërore sigurimesh, e cila kishte një rol të kufizuar në fushën e sigurimeve pa asnjë rol tjetër në ndërmjetësim.

Pa dyshim, që reformat e vërteta për herë të parë u prezantuan në fillim të viteve '90, të cilat kulmuan në mesin e vitit '92, me miratimin e të parit ligj për bankën qendrore dhe për sistemin bankar në Shqipëri.

Që nga viti 1992 e në vazhdim, sistemi bankar ka ardhur në rritje, për të ardhur në ditët e sotme, kur numërohen 16 banka aktive, ndërkohë që një bankë tjetër ka marrë licencën paraprake.

Duke u ndalur pak më gjatë në sektorin financiar, do të doja të shtoja se kohët e fundit ka zhvillime edhe në segmente të tjera të tij. Ka rritje të numrit të operatorëve në fushën e sigurimeve. Po kështu, janë shfaqur operatorët e parë në fushën e pensioneve, ashtu sikurse ekziston dhe një numër modest operatorësh të vegjël financiarë në fushën e kreditimit, kryesisht në formën e shoqërive të kursim-kredive dhe të institucioneve financiare jobanka.

Nga një vështrim i shpejtë, duket se kemi një sektor financiar që po gjallërohet nga njëri vit në tjetrin. Megjithatë, është e dukshme se zhvillimet

cilësore i takojnë sistemit bankar. Aktualisht, besoj se kemi një sistem bankar, konfidenca publike ndaj të cilit sa vjen e rritet. Veçanërisht këto kohët e fundit po punohet shumë në drejtim të mbulimit gjeografik të vendit me shërbime bankare, ashtu sikurse zhvillime pozitive ka edhe në infrastrukturën e pagesave. Konstatoj me kënaqësi se marrëdhëniet biznes – bankë janë në nivel më dinjitoz.

Një tjetër shtysë do të jetë edhe prezantimi i sistemit të kryqëzimit të pagesave në vlerë të vogël. Ky sistem do të lehtësojë pagesat e vogla ndërmjet individëve, pavarësisht distancave gjeografike, ndërkohë që do të krijojë shtratin e sigurtë për zhvillime më të sofistikuara në fushën e pagesave elektronike.

Gjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave, kemi pasur hapa konkrete edhe në drejtim të reduktimit të ekonomisë cash, gjë që pasqyrohet qartë në ecurinë e raporteve përkatëse monetare.

Gjithësesi, mendoj se sfidat që qëndrojnë para nesh janë akoma të shumta dhe të mëdha. Besoj se ende shkalla e ndërmjetësimit financiar është e ulët. Nga ana tjetër, ende sektori me potencial të madh ekonomik, bujqësia, vazhdon të mos e jetë i mbuluar me biznes bankar, ndërkohë që shkalla e penetrimit të kartave elektronike të pagesës në jetën e përditshme është në nivele modeste.

Ne si Bankë e Shqipërisë kemi arritur në përfundimin se sistemi bankar ka nevojë për më shumë fleksibilitet, sidomos nga ana rregullative. Për këtë qëllim, jemi duke menduar për një rivlerësim të kornizës rregullatore të lidhur me funksionimin e tregut të parasë, të politikave të kreditimit dhe të tregut valutor. Unë do të shpresoja që bankat të kishin një rol proaktiv. Sigurisht që rregullimet do të jenë pjesë e një vlerësimi më të gjerë, jo vetëm brenda vendit por edhe nga ana e institucioneve dhe organizmave të specializuara ndërkombëtare.

Po pjesa tjetër e sektorit financiar?

Siç e përmenda më sipër, vërehet se ka një shtim të operatorëve në treg. Megjithatë, konstatoj se aktiviteti operacional i tyre është akoma larg standardeve dhe praktikave më të mira. Për më tepër, edhe kuadri i tyre legjislativ, rregullator dhe mbikëqyrës nuk është i plotë. Për këtë qëllim mendoj se sfidat janë të shumta dhe masat korrigjuese duhet të jenë të menjëhershme. Gjykoj se është në vetë interesin e kompanive të sigurimit, që të jenë më të mbikëqyrura, sepse vetëm kështu do të arrijnë standarde të ngjashme me ato të sistemit bankar. Duke i mbajtur të pandryshuara praktikat aktuale nuk bëhet gjë tjetër veçse vështirësohet rruga e tyre drejt procesit të pakthyeshëm të krijimit të një tregu financiar eficient. Në të kundërt, ato do të vazhdojnë të mbeten pjesë periferike të sistemit financiar. Ka ardhur koha që të mos kënaqemi vetëm me shtimin numerik të operatorëve në treg, por duhet të synojmë ndërtimin e një sektori financiar të rregulluar, me vlera, fleksibël dhe transparent.

Po kështu, edhe insitucionet e tjera financiare, përfshi edhe ndërmjetësit dhe ndihmësit e specializuar, gjykoj se kanë hapësira për më shumë rol në ndërmjetësim, ashtu sikurse edhe për to, do të apeloja që aktiviteti i tyre paraprakisht të mbulohet me korniza ligjore dhe mbikëqyrjeje të plota dhe bashkëkohore.

Konfidenca në një treg as nuk mund të dekretohet nga autoriteti monetar, por as nuk mund të imponohet. Ajo është një proces i vështirë që kërkon punë të vazhdueshme. Ajo kërkon rregulla loje dhe njohje të saktë të tyre nga të gjithë aktorët. Ajo kërkon zhdërvjelltësi, transparencë, luajalitet dhe mbikëqyrje të kujdesshme. Vetëm kështu aktorët e saj do të rrisin besimin reciprok ndaj njëri-tjetrit, si dhe ndaj organizatorëve dhe mbikëqyrësve të tregut.

Një bankë qendrore është aq e besueshme sa i besueshëm është vetë sistemi bankar. Është e vështirë të kuptohet se një treg flegmatik, me inventar të pakët instrumentesh financiare, me konkurrencë ende të ulët, të fitojë kredo, të zgjojë interesimin e investitorëve dhe t'i japë shtytje të forta formalizimit të ekonomisë, veprime këto, që në fund të fundit do të rrisnin besimin e publikut ndaj tregut financiar. Pra, konfidenca monetare është një aksiomë e cila vërtetohet çdo ditë, vetëm në qoftë se do të kemi një treg financiar likuid, të hapur dhe transparent.

Forcat e tregut janë më të efektshme, kur numri i pjesëmarrësve është i madh dhe kur principet e tregut njihen dhe përdoren në mënyrën e duhur prej të gjithë pjesëmarrësve. Ndërkaq, sentimentet e tregut janë si valët e detit. Ato vijnë e ikin. Sa më shumë të zhvillohet tregu, aq më të forta do të bëhen ato. Ne mund t'i shikojmë këto valë në ekonomitë ku tregjet financiare të zhvilluara janë forca drejtuese në ekonomi. E rëndësishme është që të ideojmë dhe të zbatojmë politika monetare, fiskale dhe politika të tjera ekonomike të mençura, me qëllim që t'i akomodojmë këto valë në mënyrë të përshtatshme.

Nuk do të doja që në fjalimin tim të ndalesha në detaje në segmentet e veçanta të tregut financiar, ku ne si sistem bankar jemi organizatorë dhe aktorë kryesorë. As nuk do të doja të bëja analiza për mundësimin e përfshirjes aktive të institucioneve të tjera financiare në to.

Ajo që do të doja të ndalesha në vijim, ka të bëjë me një debat të hapur të kohëve të fundit në Bankën e Shqipërisë. Tashmë është pranuar në shkallë të gjerë, se tregu i bonove të thesarit ka hapësira të mëdha për t'u zgjeruar dhe thelluar më shumë. Nga ana tjetër, të gjithë jeni dëshmitarë se, prej një periudhe disavjeçare, Banka e Shqipërisë ka hapur sportelet e saj për t'i shitur drejtpërdrejt bono thesari individëve.

Në gjithë debatin e ditëve të fundit, në asnjë rast, Banka e Shqipërisë nuk ka menduar se individët duhen të përjashtohen nga tregu primar dhe t'u jepet mundësia për të blerë bono vetëm nëpërmjet tregut sekondar.

Kështu, kam bindjen që rritja nga njëri vit në tjetrin e interesimit të popullatës për bonot e thesarit, ka qenë një proces i natyrshëm, i cili mbi të

gjitha pasqyron rritjen e kuptimit publik mbi investimin dhe forcimin e besimit publik mbi ekonominë e vendit në përgjithësi.

Mendoj se aktualisht ka ardhur koha që ky biznes të drejtohet drejt sistemit bankar. Nga bashkëbisedimet e kohëve të fundit, bankat janë të interesuara për këtë biznes dhe janë të gatshme që të përfshihen në të. Sigurisht që jam dakord me idenë se ka nevojë për një zhvendosje graduale dhe të studiuar mirë, në mënyrë që pjesa e individëve në stokun e bonove të mos rrudhet. Unë i mirëkuptoj bankat për kostot që kanë, ashtu sikurse e kuptoj edhe parimin që çdo shërbim e ka një çmim. Gjykoj se në momentet që flasim, investitorët e vegjël e kanë kuptuar që nuk mund të fitosh for free.

Nga ana tjetër, mendoj se eksperienca e viteve të kaluara ishte e mjaftueshme në familjarizimin e individëve me përfitimet nga investimi në bonot e thesarit. Për rrjedhim, mendoj se ritmet e rritjes së kohëve të fundit do të ruhen duke e bërë të qëndrueshëm kontributin e publikut të gjerë në financimin e borxhit publik.

Gjithësesi, dëshiroj të sqaroj auditorin se, me çfarë thashë më sipër, nuk kam parasysh vetëm tregun primar të bonove të thesarit. Përkundrazi, do të inkurajoja bankat që të jenë më agresive në drejtim të tregut sekondar të bonove. Bëjani të qartë publikut se kushdo që është i interesuar, mund të skontojë bonot e tij në çdo moment, ashtu sikurse çdo individ që ka pak para mënjanë, në çdo kohë mund t'i drejtohet sistemit bankar jo vetëm për të depozituar, por edhe për të blerë bono thesari.

E shoh të arsyeshme që edhe roli i ndërmjetësave financiarë duhet rritur në përgjithësi. Sasia e parasë në qarkullim është e madhe. Kjo tregon se arkëtimet e biznesit vazhdojnë të flenë ose të konvertohen në mënyrë jo shumë inteligjente, kryesisht në pasuri të paluajtshme. Vetë Ministria e Financave mund të hapë sportelet e saj për t'i shitur drejtpërdrejt publikut bonot e thesarit. Qeveria duhet të ketë portofolin e saj të bonove të thesarit për të korrektuar pasaktësitë e ndryshme në planifikim, të cilat e kanë imponuar atë t'i drejtohet si alternativë marrjes hua nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Nuk mund të rri pa i kujtuar sistemit bankar se tregu ndërbankar mund dhe duhet të përmirësohet. Në ditët e sotme, bankat tregtare shkëmbejnë një sasi të madhe likuiditeti me bankën qendrore. Por, duhet të intensifikohet edhe shkëmbimi i këtij likuditeti ndërmjet bankave tregtare. Kjo do të siguronte më shumë mundësi financuese dhe investuese për individët dhe firmat, përfshirë dhe bankat.

Bankat kanë gjithashtu mundësi t'i kushtojnë më shumë vëmendje tregjeve të valutës dhe të bonove të thesarit, në drejtim të thellimit dhe të zgjerimit të mëtejshëm të tyre. Kështu, përveç paraqitjes së instrumenteve financiare të reja, do të ishte gjithashtu e nevojshme të avancohej në përdorimin e instrumenteve ekzistuese. Këto përmirësime do të ishin në përfitim të ekonomisë në përgjithësi, pra, të individëve, kompanive dhe vetë bankave, por edhe të bankës qendrore dhe qeverisë. Kështu, individët do të kishin më tepër mundësi

për të investuar kursimet e tyre, kompanitë do të mund të shfrytëzonin më mirë aktivitetet e reja të biznesit, bankat do të kishin përfitime më të larta dhe banka qendrore bashkë me qeverinë do të bëheshin më eficiente në zbatimin e politikave të tyre.

Fitimi i besimit të publikut, përmirësimet në sistemin bankar dhe thellimi i tregjeve financiare do ta bënte politikën monetare më efektive. Kjo politikë monetare më efektive do ta bënte më të qëndrueshëm stabilitetin e çmimeve. Çmimet e stabilizuara do të garantonin norma më të ulëta të interesit dhe rritje të lartë ekonomike.

Ritmet e larta të rritjes ekonomike janë një dukuri e kënaqshme, pasi janë kontribueset kryesore që ngushtojnë dallimet tona me pjesën tjetër të Evropës. Aktualisht, Shqipëria është një vend pak a shumë i hapur, që vazhdimisht tenton t'i afrohet Evropës dhe për më shumë, të integrohet në të.

Megjithatë, ka shumë gjëra për t'u bërë, ndonëse unë shoh dhe konstatoj shenja pozitive në ekonominë shqiptare. Sistemi i pagesave do të bëhet edhe më eficient. Ndërsa, besimi i publikut në sistemin bankar do të konsolidohet më tej. Njëkohësisht, politika monetare do të bëhet më efektive dhe më e përshtatshme për absorbimin e fenomeneve shock. Gjithashtu, ajo do ta përgatisë Shqipërinë më mirë për të gjitha llojet e bashkëpunimeve me vendet evropiane dhe ato joevropiane.

Me përmirësimin e sistemit financiar, rreziqet dhe kërcënimet ndaj sistemit mund të bëhen më të dukshme. Lëvizjet më të shpejta dhe më të mëdha të parasë në Shqipëri, midis individëve, bankave, kompanive, tregut financiar, bankës qendrore dhe qeverisë mbartin me vete edhe rritjen e ekspozimit më të madh të palëve ndaj njëri-tjetrit. Kjo është një çështje që i përket konceptit "stabilitet financiar".

Së fundmi, unë mendoj se kemi shumë çështje mbi të cilat duhet të thellohemi gjatë punimeve të kësaj konference. Edhe njëherë, unë shpresoj se në vazhdimësi do të kemi prezantime me vlerë dhe interesante, jo vetëm për ekonominë e vendit tonë, por edhe për ekonomitë e vendeve të tjera.

Jam i bindur, siç edhe ju e dini, se shumë sfida të tjera na presin përpara.

Faleminderit.

INTERVISTË E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI, DHËNË RADIOS ZËRI I AMERIKËS, UASHINGTON, 4 MARS 2005*

1 - Zoti Fullani, megjithë vlerësimet pozitive të bordit për qëndrueshmërinë makroekonomike, politikat e shëndosha monetare dhe mbajtjen e inflacionit të ulët, Fondi Monetar thekson se ruajtja e ritmeve të larta të zhvillimit, do të kërkojë ndryshime të rëndësishme në infrastrukturë, forcim të qeverisjes dhe të shtetit ligjor. Për çfare ndryshimesh bëhet fjalë, a mund të na jeni ndonjë hollësi ?

Ajo që mund të thuhet është klima që ekziston tashmë në Fondin Monetar dhe Bankën Botërore, do të thoja ekziston një klimë, siç mund ta themi në shqip, e një historie të sukseshme. Ky është një vlerësim mjaft i madh që i bëhet Shqipërisë sot. Kjo i jep mundësi Shqipërisë që të vlerësojë me kujdes shkaqet e arritjeve, por njëkohësisht të marrë parasysh dhe ç'duhet të bëhet në të ardhmen. Ajo që presupozohet është që Shqipëria ka arritur rezultate të mira makroekonomike, rritje të fortë dhe të qëndrueshme, konsolidim i anëve fiskale, njëkohësisht rritje e qëndrueshme e vlerës së monedhës kombëtare dhe përparim i duksshëm në reformat strukturore.

Ajo që duhet dhe është mjaft e rëndësishme për të ardhmen është pikërisht vazhdimi i reformave strukturore dhe institucionale, në mënyrë që Shqipëria të ketë mundësi të hapë një kapitull të ri me Fondin Monetar dhe Bankën Botërore. Për këtë do të shihen disa kushte: situata e bilancit të pagesave, situata e kanalizimit të fondeve nga vendet donatore, situata fiskale dhe konsolidimi fiskal dhe historia me Fondin Monetar. Në këtë kuptim, unë do të thoja ajo ne po diskutojmë sot me Fondin është arritja e një mirëkuptimi. Do me thënë, Fondi nuk është më sot në rolin e një tutori, por ne jemi në ralin e ndarjes së mendimeve të njejta për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Ky është rol partneriteti, që është mjaft i rëndësishëm, që për mua, është një nga gurët e themelit, që ne duhet të mbajmë fort për zhvillimin e marrëdhënieve tona me Fondin Monetar në të ardhmen. Në këtë koncept synimi ynë është të përcvaktojmë çfarë marrëveshje të re do të kemi me Fondin. Ajo që kuptohet sot është që Shqipëria është maturuar mjaftueshëm për të kaluar në një marrëveshje të re dhe kjo marrëveshje do t'i jepte më tepër fleksibilitet Shqipërisë. Natyrisht duke vazhduar me mjaft forcë reformat strukturore dhe institucionale, por do t'i jepte mundësi Shqipërisë për pjesëmarje të gjerë, që bëhet për herë të parë, në tregjet e kapitalit.

2 - Ndërsa ju flisni për fazën e re që po bëhet gati të hyjë Shqipëria me Fondin Monetar Ndërkombëtar, le të ndalemi për pak momente tek problemet ekonomike dhe financiare që ekzistojnë sot në Shqipëri. Një ndër kryesoret

** Data e publikimit 07.03.2005.*

është zhvillimi i biznesit me para në dorë. Sa pengesë përbën kjo për zhvillimin e vendit dhe për sistemin bankar në përgjithësi ?

Një nga diskutimet që ne patëm me Fondin Monetar dhe Bankën Botërore ishte pikërisht edhe zhvillimi i sistemit bankar dhe financiar. Duke filluar me vlerësimet e padiskutueshme, mjaft pozitive për menazhimin e ri të Bankës së Shqipërisë dhe perspektivat dhe vizionin e ri që ky menazhim ka për zhvillimin e sektorit financiar dhe bankar në Shqipëri. Pikërisht këtu qëndron e reja. Qëndron në atë që do të shohim një frymë më të afërt, më të mirë, më bashkëpunuese të sistemit bankar në Shqipëri dhe zhvillimit të sistemit financiar. Në ç'kuptim e them këtë? Që ne duhet të luftojmë më tepër për ta zhvilluar këtë sistem bankar.

3 - Si mund t'i tërhiqni paratë që kanë njerëzit në duar, t'i fusni këto në kanalet bankare ? A kemi të bëjmë këtu me prapambetje të bankave, apo është interesi i biznesit për t'u zhvilluar me pare në dorë, që të shmangë tatimet ?

Natyrisht situata është mjaft komplekse dhe qëndrojnë të gjitha këto që thatë ju. Ajo që ne popërpiqemi ne sot si Bankë e Shqipërisë, është të krijojmë një klimë sa më të mirë me biznesin dhe me sistemin bankar privat. Në ç'kuptim kjo? Në kuptimin e thithjes së parasë, por jo me anën e parrullave, jo me anën e konferencave boshe, por me atë që është më e domosdoshme: krijimin e strukturave të biznesit, krijimin e strukturave të pagesave, krijimin e shërbimeve.

Ajo që ne luftojmë sot është që, sistemi bankar të shkojë tek klienti, t'i thotë atij: "hajde tek unë, jo se unë jam më i miri, jo se të siguroj besimin, jo se të siguroj transferemin e fondeve, por hajde tek unë se unë do të të shërbej, do të të krijoj mundësi që këto para t'i menaxhosh më mirë, dhe do të të krijoj mundësi që jeta jote, në lidhje me biznesin, të bëhet sa më e thjeshtë".

4 - Një problem tjetër që ka të bëjë pikërisht me shërbimin që bankat u ofrojnë klientëve është edhe problemi i kreditimit. Kreditimi në Shqipëri sot është në nivele të ulta. A ka vend për t'u zgjeruar kjo dhe çfarë mund të bëni ju si bankë qendrore për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë për kreditimin?

Natyrisht kjo lidhet edhe me pikën e parë që thamë, me marrëdhëniet bankë-biznes që ne po krijojmë, për të patur një klime tjetër bashkëpunimi, e cila do të bëjë që sistemi bankar të jetë i vlefshëm për t'u shërbyer të gjithëve. Filozofia jonë e re si bankë qendrore është që, sistemi bankar të jetë pranë të gjithëve, pranë klientelës dhe të jetë i përdorshëm nga të gjithë. Kjo gjë nuk ka ekzistuar, për të qënë të hapur, sepse ekzistonin mjaft pengesa, natyrisht këtu kemi parasysh sistuatën e ligjit për tokën, kemi parasysh rregulloret e shtrënguara të Bankës së Shqipërisë dhe sistemit bankar, kemi parasysh dhe një mjedis të dobët të biznesit vetë.

Ndërsa ne sot kemi një klimë totalisht tjetër ku marrëdhëniet bankë-biznes po zhvillohen në drejtim të kreditimit të ekonomisë. Kjo do të thotë që bankat

po rrisin praninë e tyre në të gjithë vendin, bankat po konsolidohen, bankat po kërkojnë të jenë sa më të shëndetshme. Bankat po riinvestojnë kapitalin e tyre në teknologji dhe ç'është më kryesorja bankat po krijojnë një rrjet të gjerë pagesash. Ne po i vemë mjaft rëndësi krijimit të pagesave elektronike, të kartave të kreditit, sepse besojmë se ajo do të jetë një hap i rëndësishëm për reduktimin e keshit në ekonomi, por njëkohësisht edhe për zbutjen e ekonomisë informale.

FJALA PËRSHËNDETËSE
E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI, NË KONGRESIN E PARË TË KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE, PALLATI I KONGRESEVE, 10 SHKURT 2005

Përshëndetje të dashur miq, të njohur dhe kolegë!

Sinqerisht ndjehem mirë që jam i ftuar të marr pjesë në një eveniment të parë të këtyre përmasave, të kontabilistëve shqiptarë. Dhe akoma më shumë, më vjen mirë, që midis të pranishmëve në këtë sallë, shoh mjaft nga kolegët dhe miqtë e mij, ndërkohë që shoh edhe të rinj midis jush!

Gjatë viteve që kemi lënë pas, shpesh na ka rënë rasti të debatojmë rreth çështjeve që lidhen me evidencat kontabile. Shthurja e ekonomisë së planifikuar në fund të viteve '80 dhe në dy- tre vitet e para të dekadës në vijim, përveç të tjerash, krijoi një lloj amullie edhe në drejtim të kontabilitetit financiar. Transformimi i madh ekonomik, lindja e shpejtë e sipërmarrjeve private, konceptimi i ri i menaxhimit të aseteve dhe ndërmarrjeve publike, shteti ende i pakonsoliduar, mungesa e eksperiencave ndërkombëtare dhe shumë shkaqe të tjera, krijuan një konfuzion, i cili megjithë kalimin e viteve, mendoj se vazhdon të na shoqërojë edhe në ditët e sotme.

Nga pozicioni që jam sot, më vjen mirë të theksoj se biznesi bankar, ishte ndër të parët që investoi dhe u azhornua shumë shpejt me praktikat ndërkombëtare në këtë drejtim. Si rezultat, bilancet kontabile dhe pasqyrat financiare të këtyre institucioneve, janë pothuajse të njësuara me modelet e përparuara ndërkombëtare, duke bërë që: llogaridhënia, transparenca dhe besueshmëria e tyre të fitojnë përmasa bashkëkohore.

Nga ana tjetër, në qarqet e ndryshme vendimmarrëse, në grupet e ndryshme të mendimit ekonomik, në institucionet e ndryshme monitoruese kombëtare apo ndërkombëtare, ekziston ideja se evidenca aktuale kontabile në segmente të ndryshme të ekonomisë, lë për të dëshiruar. Për më tepër, shpeshherë shërben edhe si levë për të materializuar përpjekjet për evazion fiskal, pse jo edhe për aktivitete të tjera të jashtëligjshme.

Unë e kuptoj, që para së gjithash, kemi të bëjmë me një problem etike profesionale, një shtrembërim i qëllimshëm i të cilës, krijon premisat për të mbajtur në këmbë dhe për të rritur pambarimisht përmasat e ekonomisë informale.

Iniciativa e sotme mendoj se është një zhvillim pozitiv me përmasa madhore, i cili mbi gjithçka do të shërbejë në vlerësimin më të mirë të figurës së vetë kontabilistit. Tashmë duhet ta pranojmë se për një etikë dhe përgjegjshmëri më të lartë të ekspertit kontabël duhet të investohemi të gjithë ne, pa përjashtim. Është e vërtetë se ka nevojë për mbështetje më të madhe të ekspertit kontabël,

ashtu sikurse ka nevojë edhe për më shumë investime në drejtim të kualifikimit dhe të trainimit.

Një vëmendje më e madhe në këtë drejtim, duhet të jetë dhe hyrja e literaturës së re bashkëkohore, në lidhje me teknikat e kontabilizimit dhe të analizës financiare, në përgjithësi.

Unë jam i bindur, që investimi në dije për kontabilistët, do të sjellë një rikthim të shpejtë e të sigurt të rolit tuaj në ekonomi.

Në përfundim të kësaj përshëndetjeje të shkurtër, përfitoj nga rasti të apeloj, se tashmë ka ardhur koha që në rang ekonomie të kemi një standard të unifikuar të evidencës kontabile, plotësisht në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raporteve Financiare (ndryshe njihet IFRS). Pasqyrat tona financiare duhet të jenë të sakta, të ndershme dhe lehtësisht të krahasueshme. Bilancet tona kontabile duhet të pasqyrojnë me vërtetësi gjendjet e llogarive kontabile, në fund të periudhave ushtrimore.

Sistemi bankar do ta kishte shumë herë më të lehtë ndërtimin e politikave të tij krediduese në rast se bilancet dhe raportet financiare do të ishin të vërteta, të standardizuara dhe publikisht të njohura. Po kështu, tregu i kapitaleve, për të cilin kaq shumë kemi biseduar, do të kishte një shans real zhvillimi. Një biznes mund të kapitalizohet vetëm kur është i ndershëm dhe i hapur, gjë që nënkupton etikë dhe profesionalizëm nga ana juaj.

Mendoni se produkti juaj, përbën dokumente bazë, nga do të burojë informacioni aq i dëshiruar statistikor, për të bërë përgjithësime të mëtejshme dhe për të ushqyer statistikat makroekonomike të vendit.

Nga ana tjetër, bilancet e ndershme do të ndihmonin autoritetet përkatëse të kontrollonin më mirë informalitetin, evazionin dhe fitimet e pamerituara.

Unë jam i bindur se të fituarit më të mëdhenj do të jeni vetë ju!

Për këtë qëllim, nuk hezitoj që edhe një herë tjetër, t'ju përgëzoj për këtë iniciativë dhe t'ju siguroj që tek ne do të gjeni gjithnjë një dritare të hapur komunikimi dhe bashkëpunimi reciprok.

Në fund, do t'ju sugjeroja të gjithëve që keni zgjedhur të ushtroni këtë profesion të nderuar, të bëni tuajin sloganin "vërtetësi me ndershmëri !".

Faleminderit!

RAPORTI MUJOR I POLITIKËS MONETARE

I. ZHVILLIMET KRYESORE TË MUAJIT

- Norma e inflacionit vjetor në muajin mars ishte 1.7 për qind ndërsa norma mujore e inflacionit 0 për qind. Norma mesatare vjetore e inflacionit, gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, ishte 2.5 për qind, duke qenë pranë kufirit të poshtëm të intervalit objektiv të Bankës së Shqipërisë.

- Muaji mars është karakterizuar nga një normë negative e çmimeve të mallrave ushqimorë, dhe nga një normë relativisht e lartë e inflacionit vjetor të grupit "Qira, ujë, energji elektrike", inflacioni i të cilit është ndikuar nga rritja e çmimit të energjisë elektrike në muajin janar të këtij viti.

- Rritja e shpenzimeve buxhetore dhe tejkalimi i planit të shpenzimeve për muajin shkurt, nuk duken të kenë ushtruar presione inflacioniste deri në muajin mars.

- Politika monetare ka vazhduar të ruajë kahun zbutës, duke synuar uljen e mëtejshme të normave të interesit në tregun bankar dhe nxitjen e zhvillimit të eknonomisë nëpërmjet kreditimit. Ulja prej 0.25 pikësh përqindjeje e normës bazë të interesit në fund të muajit mars, u bë në kushtet e normave aktuale dhe të pritshme të ulëta të inflacionit dhe në prani të ecurisë pozitive të treguesve monetarë.

- Ecuria e treguesve monetarë gjatë muajit shkurt është karakterizuar nga zhvendosja e mëtejshme e ofertës monetare drejt mjeteve më afatgjata. Raporti i parasë jashtë bankave, në fund të muajit shkurt arriti, në 25.4 për qind, duke shënuar nivelin e tij më të ulët historik.

- Norma vjetore e rritjes së ofertës monetare në muajin shkurt arriti në 15.1 për qind, kundrejt 13.7 për qind që ishte ky tregues në fund të muajit janar. Rritja e ofertës monetare është mbështetur kryesisht në rritjen e depozitave në valutë, ndërkohë që norma vjetore e agregatit M2 ka shfaqur një rritje të lehtë si rezultat i ecurisë së moderuar të kërkesës së qeverisë për para.

- Kreditimi i ekonomisë gjatë dy muajve të parë të vitit 2005 ka paraqitur një ecuri pozitive. Teprica e kredisë është rritur me rreth 6 miliardë lekë duke arritur në nivelin 76 miliardë lekë. Shkurti i këtij viti u prezantua si periudha me rritjen më të madhe të tepricës së kredisë, me rreth 4 miliardë lekë.

- Gjatë muajit mars, normat e interesit të lekut kanë vazhduar të ulen në tregun e bonove të thesarit dhe në atë të depozitave në lekë.

- Zhvillimet në tregun valutor flasin për një stabilitet të vlerës së lekut në raport me monedhat kryesore euro dhe usd. Mbiçmimi në bazë vjetore i lekut ndaj këtyre dy monedhave ka zbutur presionet inflacioniste nga mallrat e importuar të konsumit, si edhe ka shërbyer si amortizues i rritjes së çmimit të naftës.

II. ECURIA E INFLACIONIT NË MUAJIN MARS

Norma mesatare vjetore e inflacionit gjatë tremujorit të parë të vitit 2005 ishte 2.5 për qind, duke qenë pranë kufirit të poshtëm të intervalit objektiv të Bankës së Shqipërisë. Norma më e lartë vjetore për këtë tremujor është shënuar në muajin janar (3.3 për qind) ndërkohë që muajt shkurt dhe mars shënuan rënie të ndjeshme të normës vjetore të inflacionit.

Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në për qind).

	2001	2002	2003	2004	2005
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.7
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	
Mesatare	3.1	5.2	2.2	3.0	2.5

Burimi: INSTAT.

Norma vjetore e inflacionit në muajin janar u shkëput nga vlerat relativisht të ulëta të regjistruara gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2004, si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë elektrike me 25.7 për qind. Muajt shkurt dhe mars vazhduan të karakterizoheshin nga norma negative të çmimeve të mallrave ushqimorë si edhe nga zbutja e presioneve inflacioniste të shkaktuara nga lëvizjet e çmimeve të administruara. Politika fiskale gjatë tremujorit të parë të vitit, nuk ka ushtruar presione inflacioniste, ndërkohë që ulja me 25 pikë përqindjeje e normës bazë të interesit nga ana e Bankës së Shqipërisë, në fund të muajit mars, u mbështet në ecurinë dhe pritshmëritë për nivele të kontrolluara të inflacionit dhe të treguesve monetarë.

Grafik 1. Inflacioni vjetor (në përqindje).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Kursi i këmbimit, i cili ka vazhduar të shënojë pikë në favor të lekut edhe gjatë tremujorit të parë të vitit, ka qenë një tjetër faktor që ka ndikuar pozitivisht në absorbimin e presioneve inflacioniste nga ana e çmimeve të importit.

II.1 ECURIA E INFLACIONIT DHE E GRUPEVE PËRBËRËSE

Muaji mars i vitit 2005 u karakterizua nga ulja e mëtejshme e inflacionit vjetor (1.7 për qind), ndërkohë që në bazë mujore çmimet e konsumit nuk shënuan ndryshim në krahasim me muajin shkurt. Zhvillimet në çmimet e konsumit vazhdojnë të përcaktohen ndjeshëm nga ecuria e inflacionit të grupeve "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji", "Ushqime dhe pije joalkoolike" dhe "Komunikim" (grafiku 2).

Prej mëse dhjetë muajsh (maj '04 – mars '05) me përjashtim të muajit dhjetor 2004, grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" ka regjistruar norma negative të inflacionit vjetor, duke ushtruar presion në rënie mbi indeksin e përgjithshëm të çmimeve të konsumit. Çmimet më të ulëta të mallrave ushqimorë kanë ardhur si rrjedhojë e situatës së mirë në tregun bujqësor. Nga ana tjetër, zhvillimet në kursin e këmbimit, si dhe çmimet më të ulëta të këtyre produkteve në tregjet partnere kanë lehtësuar rënien e tyre.

Në inflacionin vjetor të muajit mars, grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" kontribuoi me – 0.7 pikë përqindjeje, duke shënuar një kthesë të kahut në krahasim me muajin mars të vitit të kaluar, kur kontributi i këtij grupi në normën vjetore të inflacionit ishte 2.3 pikë përqindjeje.



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Grafik 2. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).

Ndërkohë që grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" ka ushtruar presion në rënie mbi nivelin e përgjithshëm të çmimeve, grupi "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" ka vazhduar të rrisë normën vjetore të inflacionit edhe në tre muajt e parë të vitit 2005. Grupi "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" ka kontribuar me 2.4 pikë përqindjeje në formimin e normës vjetore të inflacionit të muajit

mars. Norma të larta rritjeje vjetore janë regjistruar pothuajse në të gjitha nëngrupet e këtij grupi (tabela 2).

Tabelë 2. Kontributi në inflacion i nëngrupeve të grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji".

	Inflacioni vjetor	Kontributi në (pp)
Qira, ujë, lëndë djegëse, energji	9.9	2.4
1. Qira	5.9	0.1
2. Renta e imputuar	5.9	0.9
3. Lëndë djegëse, energji	22.7	1.3

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Presionet inflacioniste dhënë nga ky grup janë kundërbalancuar jo vetëm nga rënia në bazë vjetore e çmimeve të produkteve ushqimore, por dhe nga normat negative të inflacionit vjetor të grupit "Komunikim". Grupi "Komunikim", duke dhënë një kontribut të qëndrueshëm negativ prej – 0.5 pikë përqindjeje në normën vjetore të inflacionit, ka ushtruar ndikim rënës mbi normën e inflacionit për periudhën dhjetor '04 – mars '05.

Efekti i ndryshimit të tarifave të telefonisë fikse, pritet të shuhet në muajin prill të këtij viti, gjë që do të thotë që pas muajit mars, kontributi i inflacionit të këtij grupi nuk do të jetë më negativ.

Çmimet e grupeve të tjera të shportës së konsumit janë luhatur në mënyrë të moderuar, duke mos shkaktuar ndryshime në strukturën e inflacionit. Në inflacionin vjetor të muajit mars, këto grupe kanë dhënë një kontribut prej 0.3 pikë përqindjeje (tabela 3).

Tabelë 3. Inflacioni vjetor, inflacioni mujor dhe kontributi i grupeve kryesore.

	Inflacioni në (%)		Kontributi në (pp)	
	Mujor	Vjetor	Mujor	Vjetor
Ushqime dhe pije joalkoolike	-0.2	-1.7	-0.1	-0.7
Qira, ujë, lëndë djegëse, energji	0.0	9.9	0.0	2.4
Komunikim	0.0	-24.4	0.0	-0.5
Të tjera			0.04	0.3
- Transport	0.8	2.5	0.04	0.1
- Hotele, kafene dhe restorante	0.6	1.9	0.00	0.1
Totali	4.0	1.6	4.0	1.6

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Grafik 3. Inflacioni vjetor i grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Ndër këto grupe, vlejnë për t'u veçuar ndryshimet në grupet "Transport" dhe "Hotele, kafene dhe restorante". Inflacioni vjetor i grupit "Transport" u ndikua nga rritja e nivelit të çmimit të nëngrupit "Shërbime ndaj mjeteve personale"[1] , i cili shënoi një inflacion vjetor dhe mujor përkatësisht 7.3 për qind dhe 1.6 për qind. Rritja e çmimit të naftës vlerësohet të ketë ndikuar në inflacionin e këtij grupi.

II.2 AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE ÇMIMET E KONSUMIT

Inflacioni vjetor në muajin mars vazhdoi të ishte nën kufirin e poshtëm të intervalit objektiv prej 2-4 për qind, për të dytin muaj rradhazi. Në përgjithësi, gjatë tremujorit të parë të vitit, zhvillimet në faktorët e kërkesës dhe të ofertës nuk kanë ushtruar presione inflacioniste. Muajt shkurt dhe mars, ndryshe nga muaji janar nuk u karakterizuan nga ndryshime strukturore të rëndësishme, të cilat mund të rezultonin në luhatje të ndjeshme të çmimeve të konsumit.

II.2.1 Faktorët e kërkesës

Gjatë muajit mars të këtij viti, faktorët e kërkesës kanë mundësuar krijimin e një klime të favorshme për mbajtjen nën kontroll të normës së inflacionit, duke mos ushtruar presione inflacioniste.

Politika fiskale dhe treguesit fiskalë. Viti 2004 është karakterizuar nga një politikë fiskale e matur. Shpenzimet e përgjithshme nuk e kanë tejkaluar planin vjetor, ndërkohë që rritja e tyre në dhjetor ishte gjithashtu, brenda parashkimeve.

Po kështu, edhe viti 2005 në vijim të traditës së krijuar ka filluar relativisht i qetë, për t'i lënë vendin muajit shkurt gjatë të cilit u regjistrua një rritje mujore e shpenzimeve buxhetore. Shpenzimet e personelit kanë shënuar një rritje mujore në masën 20 për qind, ndërkohë që shpenzimet kapitale, gjithashtu, janë rritur ndjeshëm gjatë këtij muaji. Kjo rritje ka bërë që shpenzimet totale si dymujor të kenë kaluar planin në masën 2.5 për qind. Edhe pse për momentin vlerësohet, se kjo rritje në shpenzime nuk ka ushtruar presione inflacioniste, shpenzimet buxhetore duhet të trajtohen me kujdes për periudhën në vazhdim, sidomos në kuadrin e zgjedhjeve të këtij viti.



Grafik 4. Rritja e shpenzimeve buxhetore.

[1] *Në këtë grup përfshihet dhe çmimi i naftës për automjete.*

Politika monetare dhe treguesit monetarë. Banka e Shqipërisë vazhdon të ndjekë një politikë monetare zbutëse, gjë që reflektohet në uljet e kontrolluara të normës bazë të interesit. Megjithëse në minimumin e saj historik, kjo normë, në sajë të inflacionit të ulët, i cili nënkupton norma interesi pozitive në terma realë, vazhdon të jetë një mjet tërheqës për të thithur fondet e lira dhe për t'i përqëndruar ato në sistemin bankar. Ky zhvillim evidentohet edhe nga ulja e raportit të parasë jashtë bankave ndaj M3.

Gjithashtu, rritja e ofertës monetare, ndonëse më e lartë se fundi i vitit 2004 vlerësohet si jo problematike, duke mos prishur ekuilibrat makroekonomikë, si dhe duke mos dhënë shtysa për rritje n e inflacionit.

Grafik 5. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kursi i këmbimit. Gjatë muajit mars, zhvillimet në kursin e këmbimit ruajtën të njëjtën tendecë të mbiçmimit të lekut, megjithëse me hapa më të ngadaltë. Në këtë muaj, leku në nivel vjetor u mbiçmua mesatarisht me 9.8 për qind dhe me 3.1 për qind në krahasim me dollarin dhe euron. Mbiçmimi i lekut vepron si një faktor antiinflacionist, duke ulur çmimet e mallrave të importit në monedhën vendase.

Tregues të tjerë të kërkesës së brendshme. Rritja e kërkesës së brendshme[2], situata e mirë në tregun e pakicës[3], si dhe rritja e pagave në sektorin publik nuk gjeneruan presione inflacioniste në vend.

II.2.2 Faktorët e ofertës

Gjatë muajit mars të këtij viti, faktorët e ofertës kanë dhënë një ndikim stabilizues në zhvillimet e çmimeve të konsumit, duke mos çekuilibruar stabilitetin e treguesve makroekonomikë.

Inflacioni i importuar. Normat e ulëta të inflacionit në vendet kryesore partnere të shkëmbimeve tregtare flasin për një ambient të jashtëm ekonomiko – tregtar me tendenca joinflacioniste. Duke qenë se ekonomia jonë është e orientuar drejt importit, mungesa e presioneve inflacioniste të përcjella nëpërmjet këtij kanali, lejon formimin e normës së inflacionit si pasojë e veprimit të faktorëve të brendshëm.

[2] *E vlerësuar nga indeksi i shitjes me pakicë, i cili shënoi një rritje vjetore, në tremujorin e katërt të vitit 2004 me 14.6 për qind.*
[3] *Indeksi i vëllimit të shitjeve me pakicë, në tremujorin e katërt të vitit 2004 regjistroi një rritje vjetore prej 16.4 për qind.*

	Qershor	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor '04	Janar '05	Shkurt
Greqi	3.0	2.9	3.3	3.2	3.1	4.2	3.2
Italì	2.4	2.1	2.1	2.0	2.4	2.0	2.0

Burimi: Eurostat News Release.

Tabelë 4. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në përqindje).

Ecuria e prodhimit të brendshëm bujqësor. Situata e mirë në tregun e produkteve bujqësore ka favorizuar rënien e çmimeve të mallrave ushqimorë. Prodhimi më i bollshëm bujqësor i vitit 2004, që erdhi kryesisht nga rritja e investimeve në sera, ishte faktori i brendshëm, i cili, i kombinuar me faktorë të jashtëm si tendenca rënëse e çmimeve të mallrave ushqimorë në tregun e jashtëm dhe mbiçmimi i lekut ndaj euros dhe dollarit, çoi në rënien e çmimeve ushqimore dhe të inflacionit të përgjithshëm në vend. Ndonëse norma vjetore e inflacionit, edhe në muajin mars është kushtëzuar në masë të madhe nga inflacioni i lartë vjetor i grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji", rënia në çmimet e mallrave ushqimorë ka shërbyer si faktor ekuilibrues, duke ushtruar presion në rënie mbi normën totale vjetore të inflacionit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Ndryshimet vjetore të IÇP-së dhe IÇK-së për vitet 2002-2004.

Çmimet e naftës. Një rrezik potencial për inflacionin në vend, si gjatë vitit 2004, ashtu dhe gjatë këtij tremujori ishte rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare. Ashtu siç është shpjeguar dhe në raportet e mëparshme, një sërë faktorësh kanë zbehur pasqyrimin e plotë të kësaj rritjeje. Pesha e vogël që zë ky produkt në shportën e konsumit, mbiçmimi i lekut ndaj dollarit si dhe përshtatja e kërkesës në vend për këtë produkt , kanë penguar transmetimin e plotë të rritjes së çmimit të këtij produkti në tregun vendas. Inflacioni vjetor i grupit "Transport" në muajin mars ishte 2.5 për qind duke qenë pak më i lartë se ai i regjistruar në muajin shkurt, por më i ulët se inflacioni vjetor i muajit janar.

III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

III.1 POLITIKA MONETARE DHE OBJEKTIVAT SASIORË

Në vijim të politikës monetare lehtësuese të ndjekur gjatë vitit të kaluar, Banka e Shqipërisë ka ndikuar në zbutjen e mëtejshme të kushteve monetare në muajt shkurt dhe mars. Kjo politikë është bazuar në nivelet e ulëta faktike të inflacionit dhe në parashikimet optimiste për ecurinë e tij në të ardhmen. Gjithashtu, lehtësimi monetar gjatë kësaj periudhe është mbështetur në reagimin e favorshëm të treguesve monetarë, të reflektuar në ecurinë e kontrolluar të ekuilibrave dhe të ritmeve të rritjes së agregatëve monetarë.

Edhe gjatë periudhës shkurt-mars të këtij viti, Banka e Shqipërisë ka transmetuar politikën e saj monetare nëpërmjet operacioneve për administrimin e likuiditetit në tregun ndërbankar. Ndryshe nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar, Banka e Shqipërisë ka akomoduar rritjen sezonale të likuiditetit të tepërt, duke bërë vetëm tërheqjen e përkohshme të tij me anë të instrumentit të repove njëjavore.

Lejimi i niveleve të larta të likuiditetit në sistemin bankar ka synuar ushtrimin e presionit për rënien e normave të interesit në tregun e parasë. Në përgjigje të kësaj politike, normat e interesit të bonove të thesarit dhe të depozitave në lekë, në të gjitha maturitetet, kanë shënuar rënie. Krahas presioneve të likuiditetit, rënia e normave të interesit ka reflektuar edhe stabilizimin e pritjeve inflacioniste, si rezultat i stabilitetit të çmimeve gjatë muajve të fundit.

Ky fakt, ka bërë që uljet e normave të interesit të jenë veçanërisht të dukshme për instrumentet me afate të gjata maturimi, duke sjellë sheshimin e kurbës kohore të normave të interesit.

Të dhënat e fundit për inflacionin dhe zhvillimet aktuale dhe të pritshme ekonomike tregojnë se presionet inflacioniste janë të ulëta dhe të orientuara kryesisht nga ana e ofertës. Bazuar në këtë vlerësim, Banka e Shqipërisë vendosi të ndërmarrë një tjetër hap lehtësues në politikën monetare, duke ulur me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, në fund të muajit mars. Vendimi për uljen e normës bazë të interesit mori në konsideratë nevojën e përshtatjes së kushteve monetare aktuale me objektivin e inflacionit në prani të ecurisë pozitive të treguesve monetarë.

Grafik 7. Ecuria e normës bazë të interesit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e treguesve monetarë gjatë muajit shkurt është karakterizuar nga zhvendosja e mëtejshme e ofertës monetare drejt mjeteve më afatgjata. Raporti i parasë jashtë bankave në fund të muajit shkurt arriti në 25.4 për qind, duke shënuar nivelin e tij më të ulët historik.

Ky zhvillim ka bërë të mundur një rritje të kontrolluar të likuiditetit në ekonomi. Ndonëse ritmi i rritjes vjetore të agregatit M1 në terma realë ka shfaqur tendencë në rritje, vlera e këtij treguesi në muajin shkurt ka rezultuar lehtësisht nën nivelin e programuar.



* Seria e të dhënave të agregatit M1 është korrigjuar me efektin e riklasifikimit të depozitave nga banka "Raiffeisen".

Grafik 8. Rritja vjetore e agregatit M1 në terma realë.*

Zhvillimet në tregun valutor flasin për një stabilitet të vlerës së lekut në raport me monedhat kryesore euro dhe usd. Për pasojë kontributi i faktorit "kurs këmbimi" në ecurinë e treguesve monetarë, gjatë muajve shkurt dhe mars ka qenë pothuajse neutral.

Ulja e fundit e normës bazë të interesit pritet të reflektohet në uljen e normave të interesit në tregun e bonove të thesarit, të depozitave dhe të kredive në lekë. Lehtësimi i kushteve monetare do të shërbejë si një faktor nxitës për rritjen e aktivitetit ekonomik në të ardhmen.

Politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka bërë të mundur respektimin e objektivave sasiorë të saj deri në muajin shkurt.

	Qershor '04	Shtator '04	Dhjetor '04	Janar '05	Shkurt '05
Rezerva ndërkombëtare neto e Bankës së Shqipërisë (në milionë dollarë)					
Objektivi	765.8	923.7	941.7	985.3	1,029.0
Aktuale	961.5	1043.6	1,105.2	1,108.8	1,108.7
Diferenca	195.7	119.9	163.5	123.5	79.7
Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë (në miliardë lekë)					
Objektivi	85.0	70.0	79.0	73.1	67.2
Aktuale	54.7	55.4	61.0	56.3	56.5
Diferenca	-30.3	-14.5	-18.0	-16.7	-10.7
Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë)					
Objektivi	270.1	279.1	286.4	288.3	290.2
Aktuale	263.6	272.0	286.1	286.9	289.4*
Diferenca	-6.5	-7.1	-0.3	-1.4	-0.8

* Të dhëna operative.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

III.2 AGREGATËT MONETARË – OFERTA MONETARE

Treguesit monetarë gjatë muajit shkurt kanë shënuar ritme më të larta rritjeje në krahasim me një muaj më parë. Norma vjetore e rritjes së ofertës monetare në muajin shkurt arriti në 15.1 për qind, kundrejt 13.7 për qind që ishte ky tregues në fund të muajit janar. Rritja e ofertës monetare është mbështetur kryesisht në rritjen e depozitave në valutë, ndërkohë që norma vjetore e agregatit M2 ka shfaqur një rritje të lehtë, si rezultat i ecurisë së moderuar të kërkesës së qeverisë për para. Zhvillimet në strukturën kohore të ofertës monetare janë karakterizuar nga zhvendosja e saj drejt mjeteve më pak likuide, gjë që është reflektuar në rënien e mëtejshme të raportit të

parasë jashtë bankave ndaj M3. Nga ana tjetër, rritja relativisht më e shpejtë e depozitave në valutë ndaj përbërësve të tjerë të M3 është shoqëruar me rritjen e peshës së përbërësit valutor në ofertën monetare.

Grafik 9. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Oferta monetare gjatë muajit shkurt shënoi një rritje mujore me rreth 5.1 miliardë lekë ose 1.0 për qind. Kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë depozitat në valutë, të cilat rezultuan me një rritje mujore prej 2.6 miliardë lekësh ose 2.1 për qind. Norma vjetore e rritjes së depozitave në valutë, në muajin shkurt, u rrit ndjeshëm në 24.8 për qind, nga 21.1 për qind që ishte në muajin e kaluar.

Mbiçmimi i lekut, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ka ndikuar negativisht në ritmin vjetor të rritjes së depozitave në valutë. Në mungesë të efektit të kursit të këmbimit, ecuria e depozitave në valutë paraqitet me tendencë në rritje, duke shënuar një rritje vjetore reale të lartë, prej 32.3 për qind.

Ritmi i lartë i rritjes së depozitave në valutë ka reflektuar kryesisht rritjen më të shpejtë të depozitave me afat në valutë të individëve, të cilat përbëjnë rreth 58 për qind të depozitave totale në valutë. Fluksi i lartë i depozitave valutore nga individët, është shenjë e rritjes së besimit të publikut në sistemin bankar. Normat në rritje të interesave në dollarë kanë nxitur investimin në depozita në valutë.

Gjithashtu, një zhvillim i veçantë për muajin shkurt ka qenë rritja e ndjeshme e depozitave pa afat në valutë të sektorit privat, të cilat kanë kontribuar me 35 për qind në rritjen mujore të depozitave në valutë gjithsej.

Treguesi i parasë jashtë bankave ka shënuar një rënie mujore prej 0.8 miliardë lekësh. Megjithatë, norma vjetore e rritjes së parasë jashtë bankave në muajin shkurt është rritur lehtësisht nga 9.1 për qind në 10.1 për qind, kryesisht si pasojë e rritjes më të lartë vjetore të ofertës monetare në lekë, agregatit M2.

Paraja jashtë bankave ka vazhduar kthimin e saj në sistem me ritme të kënaqshme, e ndihmuar nga ecuria e qëndrueshme e interesave realë në lekë.

Kjo prirje është nxitur edhe nga kalimi i pagave të administratës shtetërore në sistemin bankar. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj agregatit M3, në muajin shkurt, zbriti në 25.4 për qind, duke shënuar një rënie me 0.4 pikë përqindjeje nga niveli i muajit të kaluar.



Grafik 10. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real (shkalla djathtas).

Rritja e agregatit M2 dhe kthimi i parasë jashtë bankave në sistem janë reflektuar në rritjen e depozitave në lekë. Norma e rritjes vjetore të tyre në muajin shkurt u rrit në 13.4 për qind, nga 12.9 që ishte një muaj më parë. Rritja e depozitave në lekë është reflektuar veçanërisht në ecurinë pozitive të depozitave me afat në lekë të individëve, të cilat kanë shënuar një rritje prej 3.3 miliardë lekësh[6] ose rreth 94 për qind të rritjes mujore të depozitave totale në lekë.

Pavarësisht rënies së normave nominale të interesit në lekë, rritja e depozitave në lekë vlerësohet e kënaqshme dhe reflekton rritjen e besimit në monedhën vendase dhe në normat pozitive reale të interesit. Struktura kohore e depozitave në lekë ka njohur një rritje të pazakontë të kontributit të depozitave pa afat, si pasojë e zhvendosjes së depozitave të sektorit shtetëror nga depozita me afat në ato pa afat, me rreth 1.5 miliardë lekë. Ky zhvillim, së bashku me normën më të lartë vjetore të parasë jashtë bankave ka ndikuar në rritjen e ritmit vjetor të agregatit më likuid monetar M1.

Norma e rritjes vjetore të këtij treguesi, në muajin shkurt, arriti në 22.3 për qind ose 3.5 pikë përqindjeje më e lartë se në muajin e kaluar[7]. Ritmi i më i lartë i rritjes së depozitave në valutë kundrejt një ecurie normale të mjeteve monetare në lekë është reflektuar në rritjen e peshës së tyre në ofertën monetare. Në vijim të prirjes afatgjatë rritëse, raporti i depozitave në valutë ndaj M3, në muajin shkurt, u rrit në 24.1 për qind.

[6] E përllogaritur duke mënjanuar efektin e zhvendosjes së depozitave në lekë me afat në depozita pa afat nga ana e Bankës "Raiffeisen" në muajin shkurt, me rreth 1 miliard lekë.
[7] Rritja e agregatit M1 është ndikuar edhe nga riklasifikimi, që prej muajit nëntor, i depozitave në lekë sipas maturimit nga Banka "Raiffeisen". Në mungesë të këtij efekti, norma vjetore e M1 në muajin shkurt do të ishte 15.6 për qind ose 2.7 pikë përqindjeje më e lartë se në muajin janar.

Grafik 11. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Ecuria e treguesve monetarë (në miliardë lekë).

	Shkurt	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
	2005	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Para jashtë bankave	132.0	-0.8	-0.6	12.3	10.2
Depozita totale	388.0	6.0	1.6	55.9	16.8
- në lekë	262.5	3.4	1.3	31.0	13.4
- në valutë	125.5	2.6	2.1	24.9	24.8
Depozita pa afat	85.8	3.3	4.0	26.8	45.4
- në lekë	39.4	2.4	6.4	18.9	92.6
- në valutë	46.4	1.0	2.1	7.9	20.4
Depozita me afat	302.2	2.6	0.9	29.1	10.7
- në lekë	223.1	1.0	0.4	12.0	5.7
- në valutë	79.1	1.7	2.1	17.1	27.5
M1	171.4	1.5	0.9	31.2	22.3
M2	394.5	2.5	0.6	43.2	12.3
M3	520.0	5.1	1.0	68.2	15.1
Baza monetare	174.5	0.1	0.1	18.7	12.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

III.3 KËRKESA E EKONOMISË PËR PARA

III.3.1 Mjetet valutore neto

Rritja vjetore e mjeteve valutore neto në muajin shkurt dha një kontribut prej 50.8 për qind në rritjen vjetore të ofertës monetare. Kontributi i mjeteve valutore është ulur përsëri në muajin shkurt pas rritjes që pësoi në muajin janar.

Grafik 12. Kontributi i rritjes së mjeteve valutore neto në rritjen vjetore të M3.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në total, rritja mujore e mjeteve valutore të sistemit bankar për muajin shkurt është 4.4 milionë usd. Rritja me 15.8 milionë usd e rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë ka mbuluar rënien prej 11.3 milionë usd në mjetet valutore neto të bankave tregtare. Rritja më e madhe e rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë vihet re në kërkesën ndaj qeverive të huaja.

Mbiçmimi i euros ndaj dollarit, me rreth 1.6 për qind, ka ndikuar rezervën valutore të Bankës së Shqipërisë duke rritur vlerën e investimeve në euro të shprehur në dollarë amerikanë. Duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit mjetet valutore të sistemit bankar rezulton të jenë ulur me rreth 11.6 milionë usd. Kjo rënie ka ardhur si rezultat i rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me 15.3 milionë usd dhe i rritjes së këtyre mjeteve për Bankën e Shqipërisë me 3.7 milionë usd.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 13. Niveli i mjeteve valutore neto të sistemit bankar.

III.3.2 Kërkesa e qeverisë për para

Si çdo fillim viti, kërkesa e qeverisë për mjete monetare është paraqitur e moderuar. Nga suficit buxhetor në muajin janar, muaji shkurt shënoi deficit buxhetor në nivelin 2.4 miliardë lekë. Financimi gjithsej i deficitit buxhetor deri në shkurt arriti në 1.3 miliardë lekë[8]. Forma kryesore e financimit, këtë muaj, ka qenë emetimi i obligacioneve dyvjeçare në masën 1.2 miliardë lekë. Emetimi i bonove të thesarit ka qenë në nivele të ulëta dhe portofoli i bonove të thesarit rezulton me ulje në muajin shkurt, me 0.1 miliardë lekë. Bankat e nivelit të dytë kanë pakësuar portofolin e tyre të bonove të thesarit me rreth 1 miliard lekë ndërsa individët, institucionet dhe Banka e Shqipërisë kanë rritur lehtësisht portofolet e tyre.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).

[8] *Diferenca midis deficitit buxhetor dhe financimit të brendshëm të deficitit buxhetor përfaqëson gjendjen e llogarisë të qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë.*

III.3.3 Kredia për ekonominë nga sistemi bankar

Kreditimi i ekonomisë gjatë dy muajve të parë të vitit 2005 ka paraqitur një ecuri pozitive. Teprica e kredisë është rritur me rreth 6 miliardë lekë duke arritur në nivelin 76 miliardë lekë. Shkurti i këtij viti u prezantua si periudha me rritjen më të madhe të tepricës së kredisë, me rreth 4 miliardë lekë. Ky ndryshim pasqyron jo vetëm prirjen e bankave për të akorduar më shumë kredi, të vënë re gjatë gjithë vitit 2004, por nga ana tjetër tregon dhe qëndrueshmërinë e tendencës së kohëve të fundit për të kredituar në afate të gjata maturimi. Në fund të muajit shkurt, teprica e kredisë afatmesme dhe afatgjatë zë rreth 66 për qind të totalit të kredisë. Forcimi i marrëdhënieve bankë – klientë, po rrit besimin e bankave për të investuar më shumë në aktivitetin kreditues duke rritur rolin e tyre si ndërmjetës financiarë.

Tabelë 7. Tregues të tepricës së kredisë ndaj totalit (në përqindje).

	2002	2003	2004	Janar '05	Shkurt '05
Teprica e kredisë (në mld lekë)	38.7	50.7	70.0	72.0	76.0
Kredi afatshkurtër	53.8	46.0	34.0	32.0	34.0
Kredi afatmesme	30.1	33.3	36.0	35.0	35.0
Kredi afatgjatë	16.1	20.7	30.0	33.0	31.0
Lekë	21.3	19.6	20.0	20.0	20.0
Valutë	73.7	80.4	80.0	80.0	80.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja sektoriale e kredisë, në dy muajt e parë të vitit, dëshmon se preferenca e bankave drejt sektorëve prodhues po konsolidohet. Gjatë muajve të fundit vihet re tendenca për uljen e portofolit të kredisë për tregtinë, ndërkohë që teprica e kredisë së akorduar në degë më pak të zhvilluara të ekonomisë si industria përpunuese dhe bujqësia, ka ardhur duke u rritur. Në total, për këto të fundit, gjatë dy muajve të parë, është akorduar rreth 25 për qind e kredisë së re për ekonominë.

Tabelë 8. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në përqindje).

		2002	2003	2004	Jan '05	Shk '05
1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.8	1	1.5	1.4	1.5
2	Peshkimi	0.2	0	0.1	0.1	0.2
3	Industria nxjerrëse	0.2	1	0.3	0.2	0.8
4	Industria përpunuese	17.0	17	17.1	15.5	16.1
5	Prodhimi, shpërndarja energji elektrike, gaz dhe ujë	3.3	3	2.8	4.1	3.2
6	Ndërtimi	8.6	10	9.8	9.6	11.3
7	Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë	40.4	34	23.3	21.3	19.9
8	Hotele dhe restorante	6.0	6	8.3	7.5	5.3
9	Transporti dhe telekomunikacioni	2.4	1	2.0	1.9	1.8
10	Aktivitete financiare	-	0	0.2	0.4	1.1
11	Pasuritë e patundshme	9.1	13	9.8	16.7	14.8
12	Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	0.5	0	0.5	0.4	0.4
13	Shërbime kolektive, sociale dhe personale	4.2	8	4.8	6.4	6.7
14	Të tjera	7.3	4	19.3	14.4	17.1
	Totali	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

III.4 TREGJET DHE ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

III.4.1 Ecuria e likuiditetit

Tre muajt e parë të vitit janë karakterizuar nga një tepricë e konsiderueshme dhe në rritje e likuiditetit në sistemin bankar. Shkaqet për këtë rritje kanë qenë kthimi i parasë jashtë bankave dhe rritja e nivelit të depozitave në lekë në sistemin bankar, si dhe kërkesa e ulët për financim nga qeveria, prirje që vihen re çdo fillim viti. Niveli mesatar ditor i likuiditetit për muajin mars ishte 10.2 miliardë lekë nga 9.3 miliardë që ishte në muajin shkurt.

Instrumenti më i përdorur për tërheqjen e likuiditetit ka vazhduar të jetë ai i repos njëjavore, me çmim fiks dhe shumë të pakufizuar. Niveli mesatar ditor i repos njëjavore për muajin mars, ishte 8.9 miliardë nga 6.5 miliardë lekë në muajin shkurt.

Depozita njëditore ka gjetur më pak përdorim këtë muaj në krahasim me një muaj më parë. Vlera mesatare e investuar në depozitat njëditore për muajin mars rezultoi 0.72 miliardë lekë nga 0.79 miliardë lekë. Në këto kushte teprice likuiditeti, lehtësia e kredisë njëditore është përdorur rrallë. Për muajin mars mesatarja ditore e kredisë njëditore rezultoi 3 milionë lekë nga 8 milionë lekë një muaj më parë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 15. Niveli i likuiditetit në sistemin bankar (në milionë lekë).

Nevojat afatshkurtra për likuiditet janë plotësuar në tregun ndërbankar. Niveli mesatar i transaksioneve për muajin mars në këtë treg regjistroi vlerën 0.69 miliardë lekë ose 0.08 miliardë lekë më shumë se një muaj më parë.

Investimi mesatar javor në letra me vlerë të qeverisë, bono thesari dhe obligacione dyvjeçare për muajin mars ishte 11 miliardë lekë, duke rezultuar 3.47 miliardë lekë më shumë se një muaj më parë. Megjithë rritjen e investimit në letra me vlerë mesatarja e raportit të shumës së shpallur fituese ndaj totalit të ofruar nga pjesëmarrësit, në ankandet e letrave me vlerë qeveritare, për muajin mars ishte 62.7 për qind nga 67.7 për qind që ishte në muajin shkurt.

Rritja e tepricës së likuiditetit në këtë treg është mbështetur dhe nga ulja e financimit të deficitit me bono thesari nga bankat tregtare[9]. Ndërkohë,

[9] *Investimet e maturuara kanë tejkaluar vlerën e investimeve të reja.*

kërkesa për të investuar në letra me vlerë të qeverisë, ka ndikuar në rritjen e konkurrencës dhe në uljen e yield-eve për to.

III.4.2 Ecuria e normave të interesit

Gjatë muajit mars, normat e interesit të lekut kanë vazhduar të ulen në tregun e parasë dhe në atë të depozitave, por jo në tregun e kredive. Fakti që normat e interesit të kredive kanë lëvizur në kah të kundërt me tendencën e përgjithshme, mund të jetë tregues i një konkurrence të ulët dhe i përqëndrimit të kredive në duar të huamarrësve të veçantë. Për më tepër, pjesa më e madhe e kredisë akordohet në valutë, gjë që zbeh ndjeshëm eficiencën e këtij kanali të rëndësishëm për transmetimin e politikës monetare. Zgjerimi i tregut të kredisë në lekë, do të rrisë natyrshëm edhe shkallën e reagimit të sistemit bankar ndaj përqindjeve të kredisë në lekë. Aktualisht, duket se bankat janë ende indiferente kundrejt alternativës së kreditimit në lekë.

Në kushtet e një niveli të ulët të inflacionit dhe të likuiditetit të tepërt në treg, lehtësimi i politikës monetare i shprehur nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje (nga 5.25 në 5.00 për qind), u konsiderua si një lëvizje që nuk do të rrezikonte objektivin e inflacionit dhe gjendjen e tregut.

Grafik 16. Normat e interesit në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tregun ndërbankar, normat e interesit për transaksionet njëditore, që zënë dhe peshën kryesore në këtë treg, janë luhatur në intervalin 2.70 – 3.00 për qind. Këto vlera kanë qenë të përafërta me ato të muajve shkurt dhe janar, ndërkohë që reduktimi i mëtejshëm i normës bazë të interesit pritet të ndikojë në uljen e normave që aplikon ky treg.

Normat e interesit kanë rënë më ndjeshëm në tregun primar. Ndryshimi më i madh është vënë re në *yield*-in e bonove të thesarit me maturitet dymbëdhjetëmujor, i cili në fund të muajit mars ra në 7.14 për qind ose 0.60 pikë përqindjeje më poshtë *yield*-it të fundmuajit shkurt. Krahasuar me muajin dhjetor, vlera e *yield*-it dymbëdhjetëmujor në fund të muajit mars është 0.97 pikë përqindjeje më e ulët. Tek obligacionet dyvjeçare, rënia e *yieldi*-it është edhe më e thellë. Në muajin mars, *yield*-i ra në 7.85 për qind nga 9.00 për qind në muajin dhjetor.

Në raport me yield-in e bonove të thesarit janë ulur dhe normat e interesit për depozitat në lekë. Norma e interesit për depozitat dymbëdhjetëmujore, në fund të muajit shkurt ishte, 5.72 për qind ose 0.09 pikë përqindjeje më e ulët se ajo e muajit janar dhe 0.27 pikë përqindjeje më e ulët se ajo e muajit dhjetor. Ulja e normës së depozitave në lekë nuk ka zhvlerësuar kursimet, pasi këto të fundit janë favorizuar nga norma e ulët e inflacionit.

Norma reale e interesit për depozitat vjetore në muajin shkurt arriti 3.95 për qind, ndërkohë që kjo normë ka shënuar 2.52 për qind në muajin janar[10] dhe 3.79 në muajin dhjetor. Të dhënat paraprake për muajin mars evidentojnë ulje të mëtejshme të normave të interesit të depozitave në lekë. Sipas këtyre të dhënave, niveli i interesit vjetor ka zbritur në 5.24 për qind dhe ai i interesit real në 3.58 për qind.

Tabelë 9. Normat e interesit në lekë (në për qind).

	Dhjetor 04	Janar 05	Shkurt 05	Mars 05
Tregu ndërbankar				
Njëditore	3.18	2.84	2.82	2.84
Njëjavore	5.76	5.55	5.40	5.40
Tregu primar				
3-mujore	6.09	5.85	5.50	5.24
6-mujore	7.22	7.11	6.97	6.51
12-mujore	8.11	8.04	7.74	7.14
Obligacione dyvjeçare	9.00	8.95	8.35	7.85
Tregu i depozitave				
1-mujore	3.39	3.55	3.68	
3-mujore	4.48	4.49	4.36	4.02*
6-mujore	5.41	5.36	5.18	4.79*
12-mujore	5.99	5.81	5.72	5.24*
Mesatare e ponderuar	5.00	5.06	4.95	4.75*
Tregu i kredive				
0-6 muaj	10.98	11.82	12.39	
6-12 muaj	13.73	14.91	14.45	
1-3 vjet	20.42	16.69	19.69	
Mbi 3 vjet	12.89	13.57	12.87	
Mesatare e ponderuar	13.71	13.88	15.03	

* Të dhëna paraprake.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e ponderuar e kredisë në lekë në muajin shkurt u rrit në 15.03 për qind, duke qenë 1.15 pikë përqindjeje më e lartë sesa norma në muajin janar. Ky tregues nuk paraqet një pririje të dukshme, por luhatet nga muaji në muaj në varësi të peshës që zë portofoli i një banke të caktuar apo maturiteti në kredinë që akordohet në periudhën në konsideratë. Përsa i përket monedhës së huaj, normat e interesit në sistemin tonë bankar ndjekin zhvillimet në tregun ndërkombëtar dhe konkretisht, normat e interesit libor dhe euribor. Norma mesatare e interesit për depozitat në dollarë është rritur në nivelin 1.86 për qind ose 0.10 pikë përqindjeje më shumë se në janar dhe 0.25 pikë përqindjeje më shumë se në dhjetor. E kundërta ka ndodhur me normat e depozitave në euro. Norma mesatare e ponderuar për to është ulur me 0.19 pikë përqindjeje krahasuar me janarin dhe me 0.12 pikë përqindjeje krahasuar me dhjetorin, duke zbritur në nivelin 1.59 për qind.

[10] *Në muajin janar, ulja e interesit real reflektoi rritjen e çmimeve të administruara që çuan në rritjen e normës së inflacionit në 3.3 për qind.*

Grafik 17. Normat e interesit në valutë (mesatare e ponderuar për të gjitha afatet).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Normat e interesit për kredinë në dollarë dhe në euro kanë arritur përafërsisht vlera të barabarta. Norma mesatare e ponderuar për kredinë në dollarë në muajin shkurt, rezultoi në vlerën 8.32 për qind ose 0.12 pikë përqindjeje më e ulët se një muaj më parë. Norma e interesit për euron rezultoi në vlerën 8.35 për qind ose 0.16 pikë përqindjeje më e ulët se në muajin janar.

III.4.3 Kursi i këmbimit

Tregu valutor i këmbimit ka qenë relativisht i qetë gjatë muajve të parë të vitit. Në këta muaj vihet re një frenim i prirjeve të shfaqura në kursin e këmbimit të lekut kundrejt monedhave euro dhe usd, deri në fund të vitit. Megjithë luhatjet e pësuara leku është këmbyer në nivelet e fundvitit 2004, duke mos thelluar mbiçmimin kundrejt dollarit dhe nënçmimin kundrejt euros. Që nga fillimi i vitit leku është nënçmuar lehtë, përkatësisht me 0.43 për qind kundrejt euros dhe me 2.55 për qind kundrejt dollarit amerikan.

Për muajin mars është vërejtur një mbiçmim i lekut kundrejt euros me rreth 0.9 për qind. Leku është nënçmuar kundrejt dollarit amerikan me 1.07 për qind. Në fund të muajit mars, leku është këmbyer në nivelin 125.81 lek/euro dhe 97.15 lek/usd. Krahasuar me një vit më parë, leku vazhdon të jetë i mbiçmuar kundrejt të dyja monedhave kryesore. Mbiçmimi vjetor në muajin mars kundrejt dollarit është 9.82 për qind ndërsa kundrejt euros është 3.11 për qind.

Grafik 18. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR VITIN 2004*

Bilanci i përgjithshëm i pagesave, për vitin 2004, rezultoi me një tepricë prej 288 milionë dollarësh. Hyrjet neto të kapitalit regjistruan një nivel rekord në 531 milionë dollarë, duke mundësuar plotësisht financimin e deficitit korent, si dhe kanë çuar në rritje të rezervës valutore.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Zvogëlim të deficitit korent, në krahasim me një vit më parë, si në vlerë absolute ashtu edhe në përqindje ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB).
- Rritje të qëndrueshme në eksporte pavarësisht nga përkeqësimi në konkurrueshmëri (zhvillimet në kursin e këmbimit).
- Përmirësim në raportin e mbulimit të importeve nga eksportet.
- Dyfishohen flukset hyrëse në formën e investimeve të huaja direkte.
- Rritje në detyrimet financiare ndaj jorezidentëve, shkaktuar kryesisht prej rritjes së fluksit të investimeve të huaja direkte, si dhe rritjes së huamarrjes private.
- Rritje e pretendimeve të vendit ndaj jorezidentëve, e shprehur kryesisht në rritje të depozitave të njësive rezidente jashtë.
- Rritje në stokun e rezervave valutore të autoritetit monetar si dhe në koeficientin e mjaftueshmërisë së rezervave valutore për importe mallrash dhe shërbimesh.

Në vlerësimin e rezultateve të kësaj analize, duhet marrë në konsideratë fakti që një pjesë e rëndësishme e rritjes së vëllimit të transaksioneve reflekton normën vjetore të zhvlerësimit (llogaritur mbi kursin mesatar mujor të këmbimit) të monedhës raportuese – dollari amerikan kundrejt euros (7.7 për qind) dhe njësisë së monedhës vendase lekut (15.7 për qind) regjistruar në vitin 2004. Një numër i madh i transaksioneve midis rezidentëve dhe jorezidentëve kryhet në euro[1] dhe jo në monedhën e raportimit të bilancit të pagesave.

I. LLOGARIA KORENTE.

Situata e favorshme e ekonomike në vend është pasqyruar pjesërisht edhe në fushën e transaksioneve me jashtë. Transaksionet korente vlerësohen në

** Përgatitur nga Sektori i Bilancit të Pagesave.*
[1] Për shembull, sipas vlerësimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, rreth 57 për qind e transaksioneve për importe mallrash kryhen në monedhën evropiane euro, 39 për qind në dollarë amerikanë dhe rreth 4 për qind në monedha të tjera.

rreth 6.2 miliardë dollarë ose 24 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Deficiti korent vlerësohet në rreth 404 milionë dollarë ose 0.6 për qind më i vogël se në vitin 2003 (në vlerë absolute zvogëlimi i deficitit korent vlerësohet në 2.5 milionë dollarë), i barazvlefshëm me 5.3 për qind të PBB nga 7.1 për qind në vitin 2003. Përmirësimi i pozicionit të deficitit korent erdhi si rezultat i rritjes së transfertave pa shpërblim dhe i zvoglimit të deficitit në shërbime, si dhe i luhatjeve të vërejtura në këmbimin e dollarit kundrejt euros dhe lekut. Ndërkohë që, është thelluar deficiti i tregtisë në mallra dhe janë zvogëluar të ardhurat neto nga investimet.

Megjithë rritjen në vëllimin e transaksioneve që ka karakterizuar zhvillimet në këmbime mallrash dhe shërbimesh, gjatë vitit 2004, indikatori i hapjes ekonomike të Shqipërisë[2] vlerësohet në rënie. Këtë vit hapja ekonomike e Shqipërisë llogaritet në nivelin 62 për qind nga rreth 66 në vitin 2003. Megjithëse, Shqipëria vlerësohet si një ndër ekonomitë më të shpejta të rajon në vitin 2004, me një rritje ekonomike rreth 6 për qind për të dytin vit rradhazi, shkalla e hapjes ekonomike lë ende shumë për të dëshiruar në raport me vendet e rajonit.

I. 1. TREGTIA E JASHTME.

Transaksionet tregtare (importe plus eksporte) gjatë këtij viti kanë përfaqësuar mëse 45 për qind të shkëmbimeve korente mes Shqipërisë dhe botës. Vëllimi i përgjithshëm tregtar kapi shifrën e 2.8 miliardë dollarëve, me një rritje vjetore prej 568 milionë dollarësh ose 25 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Rritja ka qenë më e shpejtë në krahun e eksporteve. Të ardhurat nga eksporti i mallrave regjistruan 603 milionë dollarë, duke qenë 35 për qind (23 për qind në euro) më të larta se ato të vitit të kaluar. Shenjat e përmirësimit, edhe pse të ngadalta, të ekonomisë evropiane (partnerit kryesor tregtar të Shqipërisë) si dhe përpjekjet për reforma strukturore brenda vendit, duket se po japin efektet e para. Megjithë përkeqësimin në konkurrueshmëri (kursi reali i këmbimit u vlerësua me 7.3 për qind gjatë këtij viti krahasuar me 4.5 për qind zhvlerësim në të njëjtën periudhë të vitit 2003) eksporti i mallrave është karakterizuar nga një rritje premtuese përgjatë dy viteve të fundit. Kontributi i eksporteve në PBB këtë vit vlerësohet në 7.9 për qind me 0.1 pikë përqindje rritje vjetore. Ekonomia shqiptare mbetet me orientim drejt importeve, të cilat përfaqësuan 78 për qind të vëllimit të tregtisë së jashtme. Shpenzimet për importe mallrash vlerësohen të larta, në rreth 2.2 miliardë dollarë. Rritja nominale vjetore prej 411 milionë dollarësh ose 23 për qind (12 për qind në euro) tregon se edhe ky vit ka pasuar trendin e theksuar në rritje që ka karakterizuar importet gjatë viteve 2000. Rritja e aktivitetit kreditues të ekonomisë ka ndihmuar në mbajtjen në nivele relativisht të larta të fuqisë blerëse të qytetarëve shqiptarë.

Analiza e dinamikës strukturore të importit nxjerr në pah rritjen e vazhdueshme të importeve në mallra kapitale, si dhe në importe të lëndëve të para për

[2] *E llogaritur si raport i vëllimit tregtar në mallra dhe shërbime ndaj PBB-së.*

industrinë e përpunimit aktiv në vend. Kështu, në masë të konsiderueshme (33 për qind) rritja vjetore në importe është shkaktuar nga importe të larta në makineri e pajisje dhe mjete transporti. Kërkesa e lartë e sektorit privat për mallra kapitale, është një tregues pozitiv për nivelin e investimeve, rinovimin e bazës teknologjike si dhe të produktivitetit të tij. Sektorët më të avancuar përsa i përket rinovimit të bazës teknologjike janë ata të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si dhe industria e ndërtimit.

Pavarësisht nga zhvillimet pozitive që kanë karakterizuar eksportin e mallrave gjatë këtij viti, struktura e tij vazhdon të vuajë shkallën e ulët e diversifikimit. Nuk ka akoma evidenca të strategjive të marketingut të bizneseve shqiptare drejt tregjeve të huaja. Kështu, edhe këtë vit ecuria e eksportit të mallrave u përcaktua konsiderueshëm nga ndryshimet në industrinë e përpunimit në vend (prodhim mall i porositur). Eksportet e kësaj kategorie realizuan rreth 75 për qind të të ardhurave vjetore në eksporte mallrash. Megjithatë, premtuese është rritja e eksporteve nga prodhimi vendas me tregje kryesisht në vendet e rajonit, të nxitura nga marrëveshjet e tregtisë së lirë në rajon. Me një rritje vjetore prej rreth 48 milionë dollarësh, këto të fundit kanë rritur nivelin e përfaqësimit në totalin e eksportit në 25 për qind nga 23 për qind në vitin e kaluar.

Në vlera absolute, rritja e importeve, nga viti në vit, është shoqëruar me rritje modeste të eksporteve. Megjithatë, gjatë dy viteve të fundit rritja e eksporteve ka qenë më premtuese. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet këtë periudhë arriti në 28 për qind nga 25 për qind në vitin 2003.

Deficiti tregtar për vitin 2003 arriti në rreth 1.6 miliardë dollarë ose 19 për qind më i lartë sesa ai i vitit paraardhës. Pozicioni i deficitit tregtar ndaj PBB-së vlerësohet të jetë përmirësuar në 21 për qind nga 23.4 për qind në vitin paraardhës. Importet kanë rënë më 2.3 pikë përqindjeje ndaj PBB-së në 28.9 për qind të PBB-së. Reduktimi i nevojave të brendshme për energji elektrike, nxitur nga kushtet e favorshme atmosferike si dhe nga përmirësimi i rrjetit shpëndarës e miradministrimi i energjisë elektrike, shoqëruar me një politikë të kujdesshme fiskale mund të jenë faktorë pas përmirësimit të pozicionit neto të tregtisë në PBB.

I. 2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE.

Eksporti neto i shërbimeve për vitin 2004 u vlerësua në - 24 milionë dollarë, duke qenë mjaft më i ulët se ai prej -82.7 milionë dollarësh, i regjistruar në fund të vitit 2003.

Eksporti i shërbimeve vazhdon të dominohet nga aktiviteti i turizmit. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, turizmi ka gjeneruar rreth 673 milionë dollarë flukse të ardhurash në shërbime ose rreth 11 për qind më shumë se eksporti i mallrave. Përveç ndikimit të luhatjeve në kursin e këmbimit të monedhës raportuese – dollarit amerikan kundrejt euros, në të cilën Shqipëria përfiton në masën më të madhe të ardhurat nga shërbimet e ofruara për

turizëm[3], rritja vjetore e të ardhurave nga turizmi është influencuar gjithashtu, nga lëvizjet në treguesit e vlerësuar (rritje në numrin e shtetasve të huaj dhe emigrantëve si dhe rritje të moderuar në shpenzimet ditore).

Ndërkohë, shqiptarët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 560 milionë dollarë ose sa 58 për qind të totalit të dërgesave nga emigrantët. Në krahasim me vitin e kaluar, të ardhurat nga turizmi janë rritur më shumë se shpenzimet e të njëjtës kategori shërbimi. Në fund të vitit, bilanci pozitiv i kësaj kategorie vlerësohej 112 milionë dollarë nga 33 në vitin 2003.

Shërbimet e transportit dhe ato të sigurimit ndjekin zhvillimet në aktivitetin tregtar të mallrave. Rritja e vëllimit të importit ka shkaktuar rritjen e importit të shërbimeve të këtyre kategorive. Njëkohësisht, pjesëmarrja gjithnjë e më e madhe e shoqërive rezidente të transpedicionit, që ofrojnë shërbime në tregtinë e jashme, ka rritur ndjeshëm të ardhurat e kësaj katerorie. Megjithatë, në fund të vitit deficitet në shërbime transporti dhe sigurimi vlerësohen në rritje ndaj vitit të kaluar, respektivisht me 21 dhe 9 për qind.

Kategoria "shërbime të tjera" ka regjistruar një deficit prej 11 milionë dollarësh, duke mbetur rreth të njëjtit nivel të deficitit të një viti më parë. Deficiti i sivjetshëm është shkaktuar kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit të shpenzimeve qeveritare si dhe deficitit në kategoritë shërbime kulturore dhe biznesi. Ndërkohë që, ndjeshëm janë rritur të ardhurat që gjenerohen nga shërbimet e telekomunikacionit, kategori e cila u mbyll me një bilanc pozitiv prej 54 milionë dollarësh nga 27 të regjistruara përgjatë vitit të kaluar.

Bilanci pozitiv i të ardhurave, në fund të vitit, vlerësohet rreth 168 milionë dollarë. Ky suficit i dedikohet të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë dhe atyre kufitarë. Të ardhurat neto të kësaj kategorie vlerësohen 12 për qind më të larta ndaj një viti më parë, ndikuar nga rritja e kërkesës për fuqi punëtore në shtetin fqinjë Greqi, gjatë organizimit të Lojërave Olimpike 2004. Pjesa tjetër e të ardhurave që sigurohen nga investimet, regjistroi rënie, duke bërë që suficiti i kategorisë "të ardhura" të zvogëlohet lehtë në rënie (1.3 për qind) ndaj një viti më parë.

Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit në tregti mallrash dhe shërbimesh dhe gjatë vitit 2004 janë vlerësuar në nivelin 972 milionë dollarë, duke qenë 25 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar. Megjithatë, duke pasur parasysh monedhat në të cilat kryhen këto transferta, mund të themi se edhe në këtë zë, efekti i kursit të këmbimit është i ndjeshëm.

Prurjet nga emigrantët (972 milionë dollarë) janë shoqëruar edhe nga transferta shtetërore, kryesisht në formë të asistencës teknike (46 milionë dollarë), të cilat vlerësohen në rënie (9 për qind).

[3] *Sipas vlerësimeve të sektorit të bilancit të pagesave në rreth 80 për qind hyrjet në valutë janë në euro (duke përfshirë këtu shtetas të ardhur nga vendet e Bashkimit Europian si dhe nga Kosova dhe Mali i Zi).*

II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE.

Lëvizjet e kapitalit, gjatë vitit 2004, regjistruan një fluks neto prej rreth 531 milionë dollarë, duke mundësuar plotësisht financimin e deficitit korent, si dhe kanë çuar në rritjen e rezervës valutore. Transfertat kapitale shënojnë 132 milionë dollarë ose 25 milionë më pak krahasuar me fundin e vitit 2003, ndërkohë që, llogaria financiare u mbyll me një bilanc pozitiv prej 399 milionë dollarësh. Ky import kapitalesh i realizuar në masën më të madhe prej thithjes së investimeve të huaja direkte dhe prej lëvrimeve të kredive afatgjata dhe të zbutura nga jashtë, ka shkaktuar rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës, me rreth 558 milionë dollarë. Kjo rritje vlerësohet 70 për qind më e lartë se ajo e një viti më parë.

Investimet e huaja direkte, për vitin 2004, vlerësohen në nivelin 341 milionë dollarë. Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit. Këtë vit ato prezantohen kryesisht në formën e privatizimit të sistemit bankar, me një fluks 92 për qind më të lartë kundrejt vitit të kaluar.

Faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare kanë qenë lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë. Këtu përfshihen, gjithashtu, edhe përdorimet e huave dhe kredive në Fond prej 12 milionë dollarësh. Huamarrja nga jashtë është përdorur në masë të konsiderueshme (34 për qind) nga sektori privat dhe vlerësohet rreth 6 herë më e lartë, në krahasim me vitin 2003. Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë periudhës arritën në 48 milionë dollarë.

Detyrimet financiare në formën e depozitave të jorezidentëve në sistemin tonë bankar janë rritur me rreth 3.4 milionë dollarë. Detyrimet në formën e kredisë tregtare u rritën me 23 milionë dollarë, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për këtë periudhë.

Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me 159 milionë dollarë ose rreth 27 për qind më shumë se në një vit më parë. Rreth 45 për qind e kësaj rritjeje është regjistruar gjatë tremujorit të tretë, kryesisht si pasojë e rritjes në depozitat e njësive rezidente jashtë. Ky fluks i madh depozitash nga brenda-jashtë ka ardhur kryesisht nga konvertimi i kapitalit të bankës "Raiffeisen" si dhe nga një zhvendosje në formën e investimit – nga investime portofoli në depozita. Kështu, në fund të vitit rritja në investimet e portofolit vlerësohet në rreth 3.6 milionë dollarë dhe ajo në depozita, në 90 milionë dollarë.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 348.6 milionë dollarë. Rezerva valutore e vlerësuar në 1.374 miliardë dollarë në fund të vitit 2004, qëndron në nivele të pranueshme duke mbuluar rreth 5.2 muaj importe. Rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë, janë ndikuar ndjeshëm nga efekti i kursit të këmbimit. Vetëm si pasojë e këtij të fundit, gjatë vitit 2004, rezervat valutore janë rritur me 54.8 milionë dollarë.

Tabelë 1. Bilanci i Pagesave (në milionë dollarë amerikanë).

Bilanci i Pagesave						
në milionë dollarë amerikanë USD						
	Viti '03	3m-I '04	3m-II '04	3m-III '04	3m-IV '04	Viti '04
Llogaria korente	-406.7	-77.9	-106.1	-26.0	-194.2	-404.2
Eksporti i mallrave	447.2	136.5	156.5	148.7	161.7	603.3
Importi i mallrave	-1,783.5	-454.4	-514.6	-554.5	-671.5	-2,194.9
Bilanci tregtar	-1,336.3	-317.9	-358.0	-405.8	-509.8	-1,591.6
Shërbimet: Kredi	719.7	196.7	240.3	255.4	248.3	940.7
Shërbimet: Debi	-802.4	-202.8	-237.2	-228.3	-296.3	-964.7
Të ardhurat: Kredi	194.8	41.6	40.4	65.2	49.3	196.5
Të ardhurat: Debi	-24.4	-5.3	-8.3	-6.1	-8.6	-28.3
Transferta private pa shpërblim	781.7	196.8	200.5	281.7	298.8	977.8
Transferta shtetërore pa shpërblim	60.3	13.0	16.4	11.9	24.1	65.4
Llogaria kapitale	157.0	34.0	25.7	35.6	37.0	132.3
Llogaria financiare	190.9	31.0	220.5	-16.4	151.8	386.9
Investime direkte	178.0	35.0	176.7	71.9	57.7	341.3
Investime portofoli	-22.5	-1.3	4.0	119.8	-126.1	-3.6
Kapitale të tjera*	29.8	-2.7	39.8	-208.0	220.2	49.3
Gabime dhe harresa neto	147.4	21.8	-22.7	96.2	66.0	161.3
Bilanci i përgjithshëm	99.7	14.9	117.4	95.3	60.6	288.3
Rezervat dhe zëra të lidhur me to						
Mjetet e rezerviës	-99.6	-14.9	-117.4	-95.3	-60.6	-288.3
Përdorim huash e kredish nga FMN	11.1	6.0	0.0	5.9	0.0	11.9
Për t'u mbajtur në vëmendje						
Ndryshimi total në rezerva	-182.3	-2.6	-113.9	-103.2	-123.4	-343.0
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	85.2	-12.3	-3.6	7.8	62.8	54.8

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përgatitur nga Sektori i Bilancit të Pagesave dhe Vrojtimeve

VLERËSIMI I GJENDJES FINANCIARE TË SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR PËR TREMUJORIN E KATËRT TË VITIT 2004.

Gjatë vitit 2004 aktivet e sistemit bankar shënuan rritje me 52.8 miliardë lekë (ose 14.1 për qind), rreth 18.5 miliardë lekë më e lartë se rritja e aktiveve e evidentuar në vitin 2003. Megjithëse viti 2004 njohu hyrjen e një banke të re në treg, Banka Popullore, ndikimi i saj në rritjen e aktiveve të sistemit ishte vetëm 4 miliardë lekë. Kjo tregon se bankat në vend po prezantojnë ritme rritëse progresive nga njëri vit në tjetrin.

Tremujori i fundit i vitit 2004 prezantoi rritje të aktiveve për grupin e bankave G3 me 9 miliardë lekë në krahasim me tremujorin e tretë, për grupin G1 me 3.5 miliardë lekë, ndërsa grupi G2 shënoi rënie me 0.45 miliardë lekë. Sistemi bankar në vend vazhdon te jete i përqendruar ndaj bankave të mëdha (G3), këto të fundit përbëjnë 83 për qind të totalit të aktiveve të sistemit. Gjithsesi, duke marrë në konsideratë një tregues tjetër të përqendrimit, indeksin H (Herfindahl), i cili fokusohet mbi peshën specifike të secilës bankë, vlerat e tij në rënie flasin për reduktim të këtij fenomeni gjatë viteve.

Gjatë vitit 2004, teprica e kredisë së sistemit bankar shënoi rritje me 19.3 miliardë lekë ose 38 për qind në krahasim me fundvitin 2003. Kjo rritje i atribuohet jo vetëm bankave të mëdha të sistemit, por edhe disa prej bankave të grupit G1 dhe G2.

Tremujori i katërt dallon rritje të kredisë së re në krahasim me tremujorin e mëparshëm, megjithëse ky element është pakësuar me 3.6 miliardë lekë ose 12 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Faktor i këtij kufizimi është gjetja e mundësive të reja të investimit nga bankat e sistemit, sikurse janë "letrat e tjera me vlerë", të cilat sjellin norma të larta kthimi dhe vlerësohen me risk më të ulët se kreditimi.

Në lidhje me kontributin e grupbankave në rritjen e tepricës së kredisë për tremujorin e katërt evidentohen grupet G3 dhe G1 (respektivisht me 6.3 dhe 2 miliardë lekë), ndërkohë që ndikimi i grupit G2 llogaritet vetëm 0.98 miliarë lekë.

Pesha e kredisë afatshkurtër ndaj tepricës së kredisë rezulton 26.7 për qind nga 40.3 për qind në fundvitin 2003, ndërsa kredia afatmesme dhe ajo afatgjatë evidentojnë rritje respektivisht me 5.7 dhe 6.1 pikë përqindjeje ndaj tepricës së kredisë së sistemit bankar. Keto ndryshime strukturore te portofolit te kredive duket te flasin per nje tendencë në rritje të bankave për të financuar dhe mbështetur projektet për investime sesa nevojat për mjete qarkulluese të bizneseve duke kontribuar në këtë mënyrë më mirë në rritjen e ekonomisë.

Treguesi "kredi me probleme / tepricës së kredisë (bruto)", i cili vlerëson efektivitetin e menaxhimit të portofolit të kredisë, llogaritet 4.2 për qind nga

4.6 për qind në fundvitin 2003. Kjo rënie shpjegohet me ritmin më të lartë rritës të portofolit të kredive, rreth 39% ndaj ritmit të përkeqësimit portofolit të kredive me probleme, rreth 25%. Pra, nga jashtë duket që përmirësimi i këtij treguesi vjen më tepër si rrejdhojë e influencës së elementit sasior sesa atij cilësor që ka të bëjë me ecurinë e portofolit të kredive me probleme.

Megjithë dominimin e kredisë në valutë, kredia në lekë prezanton rritje të lehtë të peshës së saj ndaj tepricës së kredisë (në 19.5 për qind nga 17.9 për qind në fundvitin 2003[1]. Nga analiza, rezulton se kredia në valutë, kur fluksi i të ardhurave të kredimarrësit është në lekë llogaritet 48 për qind e totalit të tepricës së kredisë dhe 63 për qind e tepricës së kredisë në valutë. Ndonëse, në pamje të parë, sistemi shfaqet i ekspozuar ndaj riskut indirekt të kreditit, skenarët hipotetikë që marrin në konsideratë nënçmimin e lek-ut rezultojnë në nje rënie te pakonsiderueshme te normës së mjaftueshmërisë së kapitalit per sistemin bankar.

Fitimi neto i sistemit bankar në fund të vitit 2004 është rreth 650 milionë lekë më i lartë se një vit më parë. Kjo performance e mirë mbështetet jo vetëm nga rritja e volumit të aktiveve dhe në përgjithësi aktivitetit të sistemit bankar, por edhe rritja e rentabilitetit.

Rentabiliteti i G1 rezulton të jetë më i larti nga të tre grupimet, në ndryshim nga renditja përgjatë vitit 2004, gjë që lidhet më tepër me elemente rastësore. Ndërsa rentabiliteti i G3 edhe pse më i ulët, por që vlerësohet i mirë, tregon për qendrueshmëri të tyre.

Së fundi, rritja e nivelit të treguesit të efikasitetit, apo përkeqësimi i tij, lidhet kryesisht me ndodhjen e ngjarjeve pozitive për sistemin, që kanë të bëjnë me përmirësime strukturore, zgjerim aktiviteti apo edhe rritje të konkurrencës.

Viti 2004 vazhdon të njohë rritje të mëtejshme të niveleve të kapitalit aksioner të sistemit duke shënuar këtë fundvit vlerën 26 miliardë lekë ose rreth 4 miliardë lekë më shumë se në fundvitin 2003. Treguesi i sistemit ndikohet kryesisht nga grupi i bankave të mëdha (G3) me rreth 2 miliardë lekë dhe bankave të vogla (G1) me rreth 1.2 miliardë lekë, ndërkohë që kontributi i bankave të mesme (G2) evidentohet vetëm 0.8 miliardë lekë.

Elementi kryesor i kapitalit aksioner - kapitali i paguar,- vazhdon të ruajë peshën kryesore (rreth 72%) në kapitalin aksioner të sistemit dhe me një kontribut prej 5 miliardë lekë ose rreth 1 miliardë lekë më shumë se kontributi i tij në fundvitin 2003. Sistemit ju shtua një bankë e re gjatë vitit dhe disa banka rritën nivelet e kapitalit të paguar duke ndikuar pozitivisht në rritjen e niveleve të treguesit për sistemin. Gjithashtu, nivelet e konsiderueshme të fitimit ndikojnë pozitivisht në kapital (5.1 miliardë lekë), ndonëse efekti pozitiv i tyre zbehet nga efekti negativ i diferencave debitore të rivlerësimit (5 miliardë lekë) si rezultat i nëncmimit të dollarit kundrejt lekut.

[1] *Për rrjedhojë, në fundvitin 2004 pesha e kredisë në valutë llogaritet 80.5 për qind nga 82.1 për qind një vit më parë*

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar në fundvitin 2004 evidentohet 21.6 për qind ose rreth 7 pikë përqindjeje më i ulët se në fundvitin 2003. Rënia e raportit të mjaftueshmërisë shpjegohet me ritmet më të larta të rritjes së aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut (rreth 33 miliardë lekë ose 52 për qind) se ritmet e rritjes se kapitalit rregullator (rreth 3 miliardë lekë ose 15 për qind). Tremujori i fundit i vitit konsolidon tendencën në rënie të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit si rezultat kryesisht i rritjes së investimeve të bankave në aktivitete më me rrezik.

Analiza e mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave të sistemit dallon grupin e bankave të vogla (G1) me rënie të ndjeshme të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit krahasuar me fundivitin 2003, ndonëse ky grup vazhdon të ruajë nivelin më të lartë të raportit te mjaftuesjmerise se kapitalit, nderkohë që dy grupbankat e tjera njohin rënie josinjifikuese të treguesit, por shënojnë nivele më të ulëta të tij. Rënia e ndjeshme e treguesit në G1 shpjegohet me rritjen e konsiderueshme të nivelit të kredidhënies kryesisht nga dy banka të grupit, ndërsa në grupin e bankave të mesme (G2) dhe të mëdha (G3) janë disa banka aktive në kredidhënie, të cilat vazhdojnë të kontribuojnë në nivelet më efektive të raportit te mjaftueshmerise se kapitalit.

Analiza e mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat e sistemit vazhdon të dallojë për një bankë nivele të RMK shumë afër nivleve minimale të kërkuara, madje me tendencë në rënie, ndërkohë që bankat e tjera të sistemit ruajnë nivelet e mjaftueshmërisë së kapitalit mbi ato minimale të kërkuara (12 për qind).

Viti 2004 konsolidoi rritjen në vazhdimësi të aktivitetit të bankave me tendencë investimet më me rrezik, rritje kjo që shoqëroi tendencën në rënie të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, ndersa bankat e sistemit shfaqën nivele të mjaftueshmërisë së kapitalit mbi ato minimale të kërkuara (12 për qind).

Treguesit e likuiditetit dëshmuan edhe gjatë vitit 2004 një situatë të kënaqshme likuiditeti. Lehtësirat e ofruara nga Banka e Shqipërisë për likuiditetin krijuan mundësinë për thithjen e tepricave të likuiditetit nga bankat e sistemit si dhe plotësimin e nevojave për këtë të fundit. Në fund të periudhës që analizojmë, treguesi i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve për bankat e sistemit ruan nivel të kënaqshëm (mbi 27 për qind). Në sistem dallojnë disa banka me nivele më të larta të treguesit te cilat gjejnë shpjegim në nivelet modeste të kredidhënies në aktivitetin e këtyre bankave.

Treguesi i aktiveve afatshkurtra ndaj pasiveve afshkurtra për sistemin evidentohet 97 për qind në këtë fundvit ose rreth 10 pikë përqindjeje më i ulët krahasuar me fundvitin 2003. Rënia e treguesit shpjegohet me rritjen me ritme më të larta të pasiveve afatshkurtra sesa aktivet afatshkurtra. Treguesi ndonëse njeh rënie vazhdon të ruajë nivel të kënaqshëm për sistemin (afër 100%) që flet për menaxhim të mirë të likuidtetit. Në sistem dallohen disa banka të cilat njohin vlera të ulëta të treguesit, por niveli i kënaqshëm i

aktiveve likuide në totalin e aktiveve të tyre nuk i ekspozon këto të fundit ndaj riskut të likuiditetit.

Së fundi, sipas testimit hipotetik të aftësisë së sistemit bankar për të thithur humbje që mund të shkaktohen nga situata shock, rrjedhojë e zhvillimeve të padëshirueshme të disa treguesve të caktuar, evidentohen banka të veçanta me pamjaftueshmëri kapitali. Megjihtëkëtë, perspektiva e rritjes së niveleve të kapitalit minimal të kërkuar deri në 1 miliardë lekë në periudhën afatmesme 2005-2008 vlerësohet si një masë paraprake mbrojtëse për tërë sistemin bankar në të ardhmen.

DOKUMENTI "PËR MISIONIN E MBIKËQYRJES"

V E N D I M

NR.11, DATË 09.02. 2005

Për
"Miratimin e dokumentit "Për misionin e mbikëqyrjes"".

Funksioni i mbikëqyrjes ushtrohet nga Banka e Shqipërisë, si bankë qendrore, në bazë të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" nr. 8269, datë 23.12.1997 dhe të ligjit " Për bankat në Republikën e Shqipërisë" nr. 8365, datë 02.07.1998.

Misioni i mbikëqyrjes

Banka e Shqipërisë, në zbatim të përgjegjësive ligjore si autoriteti mbikëqyrës i bankave dhe i subjekteve të tjera, që kryejnë veprimtari financiare të licencuara prej saj, ka për qëllim që:

- të sigurojë veprimtari të shëndoshë bankare në harmoni të plotë me /dhe në zbatim të kuadrit ligjor e rregullativ përkatës, me qëllim parandalimin e krizave financiare dhe mbrojtjen e depozituesve;

- të ruajë stabilitetin e sistemit bankar dhe më gjerë, duke monitoruar zhvillimet e tregut dhe duke rekomanduar masat e nevojshme, në mënyrë që bankat t'iu përshtaten këtyre zhvillimeve dhe të administrohen në vazhdimësi sipas parimeve më të mira;

- të forcojë besimin e publikut tek sistemi bankar si edhe të nxisë disiplinën e tregut, duke kërkuar rritjen e transparencës së sistemit bankar;

- të ndikojë në zhvillimin e një konkurrence të ndershme në sistemin bankar dhe më gjerë, dhe të sigurojë trajtimin e barabartë të subjekteve të licencuara dhe të klientëve të tyre;

- të ofrojë një komunikim të vazhdueshëm profesional ndaj operatorëve të tregut finaciar si edhe ndaj institucioneve të tjera që ndikojnë në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përmirësimit të funksionimit të tregut financiar dhe të operatorëve të tij.

Banka e Shqipërisë, do të realizojë funksionin e saj mbikëqyrës, nëpërmjet:

a) ndërtimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës, në mënyrë që ai të jetë në harmoni me parimet më të mira ndërkombëtare dhe i zbatueshëm në praktikë;

b) inspektimeve në vend dhe analizës së treguesve të institucioneve të licencuara, si edhe ndërmarrjes së veprimeve korrektuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;

c) orientimit të procesit mbikëqyrës drejt identifikimit të rrezikut me të cilin ndeshen institucionet e licencuara, duke rekomanduar zgjidhjet përkatëse;

d) ndërtimit të politikave, të cilat synojnë orientimin e sistemit bankar drejt zhvillimeve të dëshiruara;

e) bashkëpunimit me institucionet financiare që mbikëqyren, me institucione të tjera financiare brenda vendit si edhe me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera;

f) përmirësimit të vazhdueshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse.

Në zbatimin e kërkesave të funksionit mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë do të synojë nivelet më të larta të integritetit, të profesionalizmit, të eficiencës dhe të transparencës.

NJË RISHIKIM I REGJIMIT TË TARGETIMIT MONETAR NË SHQIPËRI ME DISA ORIENTIME PËR TË ARDHMEN

FATOS IBRAHIMI* DHE ERJON LUÇI*,**

Në këtë punim jemi përpjekur të analizojmë përshtatshmërinë e regjimit të targetimit monetar të zbatuar aktualisht në Shqipëri, nën dritën e zhvillimeve të fundit ekonomike. Edhe pse performanca e tij e deritanishme ka qenë e kënaqshme, regjime alternative si ai i inflacionit të shënjestruar (inflation targeting) mund të jenë më efikase për të ruajtur stabilitetin e çmimeve në të ardhmen. Më pas, jemi përqëndruar gjithashtu dhe në kërkesat, në problemet dhe në mundësinë e kalimit nga regjimi aktual në regjimin formal të inflacionit të shënjestruar.

1. HYRJE

Një objektiv i ndërmjetëm efikas duhet të përfshijë të gjithë informacionin e nevojshëm për parashikimin e inflacionit. Agregatët monetarë mund të mos e përmbushin një kusht të tillë. Për këtë arsye, Shqipëria si dhe shumë vende të tjera, po konsideron të kalojë nga regjimi i kontrollit monetar drejt regjimit të shënjestrimit të inflacionit për të drejtuar politikën e saj monetare. Banka e Shqipërisë tashmë ka filluar t'i bëjë të njohur publikut objektivin për inflacionin e fundvitit. Por, siç argumenton Mishkin (2002), raportimi i një objektivi për inflacionin mund të mos jetë i mjaftueshëm për të klasifikuar një vend si shënjestrues inflacioni. Kalimi nga ky regjim i nënkuptuar i shënjestrimit të inflacionit drejt regjimit formal të shënjestrimit të inflacionit kërkon elemente të tjera, të cilat mbartin rreziqe në rast se më parë nuk përmbushen disa kushte të caktuara.

Në këtë material jemi përpjekur të shqyrtojmë mundësinë e zbatueshmërisë të regjimit të shënjestrimit të inflacionit (*inflation targeting, IT*) në periudhën afatmesme, duke përshkruar problemet potenciale që mund të lindin me adoptimin e tij në Shqipëri. Materiali është organizuar si më poshtë. Në Pjesën e dytë jepet një përshkrim i përgjithshëm i politikës monetare në Shqipëri. Pjesa e tretë analizon vështirësitë potenciale të komunikimit që mund të ketë regjimi aktual i targetimit monetar në zbatimin e politikës monetare. Pjesa e katërt përmbledh disa nga përparësitë dhe problemet që karakterizojnë regjimin e IT. Në pjesën e pestë përqëndrohemi në mënyrë më të detajuar në problemet që lidhen kryesisht me aftësinë e Bankës së Shqipërisë për të adoptuar regjimin e IT. Pjesa e gjashtë trajton disa probleme të tjera të regjimit të IT që janë përtej kontrollit të Bankës së Shqipërisë. Në pjesën e shtatë trajtojmë shkurtimisht disa regjime alternative. Pjesa e tetë konkludon.

* Zëvendësguvernator i Parë, Banka e Shqipërisë.
* Drejtor i Departamentit të Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.
** Pikëpamjet e shprehura në këtë kumtesë janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

2. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I POLITIKËS MONETARE NË SHQIPËRI GJATË TRANZICIONIT

Shqipëria ka qenë mjaft e suksesshme në uljen e inflacionit. Nga 237 për qind që ishte në vitin 1992, inflacioni u ul në 6 për qind në vitin 1996. Inflacioni i shkaktuar nga pasiguria pas rënies së skemave piramidale u ul gjithashtu, me shpejtësi. McNeilly etj. (1998) suksesin e Shqipërisë në arritjen e inflacionit të ulët ia atribuon liberalizimit të hershëm të çmimeve, shoqëruar me politikat mbështetëse për rritjen e konkurrencës dhe rritjes së hershme të ofertës agregate të mallrave dhe shërbimeve, krahas një politike monetare kufizuese të ndjekur nga Banka e Shqipërisë (Banka e Shqipërisë).

Fillimisht Banka e Shqipërisë është mbështetur në instrumente direkte për drejtimin e politikës monetare. Para mesit të vitit 1995 oferta e parasë gjithsej (M3) kontrollohej nëpërmjet vendosjes së tavaneve për zgjerimin e kredisë së brendshme të sistemit bankar. Tavanet e kredisë, në përputhje me normën e synuar të inflacionit dhe me rritjen e prodhimit, vendoseshin për kredinë e bankave për ekonominë - përfshirë dhe kredinë për qeverinë.

Tabelë 1. Treguesit kryesorë ekonomikë të Shqipërisë.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Rritja reale e PBB (%)	12.7	8.9	7.7	6.5	4.7	6.0	6.0
PBB për frymë (USD)	842	1,052	1,086	1,329	1,460	1,833	2,434
Norma e papunësisë	17.8	18.0	16.9	14.6	15.8	15.0	14.5
Norma e inflacionit (fund viti)	8.7	-1.0	4.2	3.5	2.1	3.3	2.2
Bilanci i përgjithshëm i qeverisë (% e PBB, përjashtuar grantet)	-11.4	-12.1	-9.2	-8.2	-6.9	-4.5	-6.5
Bilanci i përgjithshëm i qeverisë (% e PBB, përfshirë grantet)	-10.9	-9.3	-8.2	-7.6	-6.3	-4.1	-5.85
Borxhi i brendshëm (% e PBB)	36.2	37.4	42.6	39.5	38.8	38.0	37.2
Bilanci tregtar (% e PBB)	-22.8	-19.3	-22.3	-24.2	-23.9	-22.8	-21.5
Bilanci i llogarisë korente (% e PBB përjashtuar grantet)	-7.1	-7.9	-7.4	-6.2	-9.0	-7.6	-7.5
Bilanci i llogarisë korente (% e PBB përfshirë grantet)	-3.9	-3.9	-4.4	-3.2	-6.5	-5.1	-5.5
Borxhi i jashtëm (% e PBB)	36.9	32.3	31.8	28.2	24.4	20.2	21.0
Kursi i këmbimit lek/usd (mesat.)	150.6	137.7	143.7	143.5	140.1	121.9	102.8
Kursi i këmbimit lek/euro (mesat.)	-	146.9	132.6	128.5	132.4	137.5	127.7
Investimet e huaja direkte (% e PBB)	1.5	1.4	3.7	4.8	2.6	2.7	5.0

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Pasi zbritej tavani i kredisë së bankës qëndrore ndaj qeverisë nga kufiri total, shuma e mbetur ndahej midis bankave tregtare, duke vendosur tavane të veçanta për secilën bankë. Prej vitit 1995, Banka e Shqipërisë u përpoq të rrisë kontrollin e M3 nëpërmjet rregullimit të normave të interesit të depozitave bankare. Në lidhje me politikën e normave të interesit, Banka e Shqipërisë synonte mbajtjen e normave reale të interesit të vendosura për depozitat e bankave shtetërore në nivele pozitive, me qëllim që të evitohej rrjedhja e aseteve monetare vendase dhe të shmangej keqndërmjetësimi bankar (Fig.1). Në vitin 1999, Banka e Shqipërisë hoqi tavanet e kredisë për bankat e nivelit të dytë, ndërkohë që nxori rregullin që bankat me një raport të kredive të këqija ndaj totalit të kredisë, mbi 20 për qind, ndaloheshin të jepnin kredi të reja. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2000, Banka e Shqipërisë gjithashtu, hoqi plotësisht kontrollin direkt mbi normat e interesit të depozitave, duke

kaluar në përdorimin e instrumenteve indirekte për zbatimin e politikës monetare. Aktualisht, Banka e Shqipërisë përpiqet të influencojë normat e interesit nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur në bono thesari (REPO).



Grafik 1. Normat reale të interesit.

Deri më sot ky regjim ka treguar rezultate mbresëlënëse lidhur me stabilitetin e çmimeve. Inflacioni është stabilizuar në nivele të moderuara sipas shifrave të fundvitit dhe mesatares vjetore, ndonëse ndonjëherë janë vërejtur devijime nga objektivi, për shkak të goditjeve të paparashikuara dhe faktorëve spekulativë që kanë qenë kryesisht përtej kontrollit të bankës qendrore (për shembull, çmimet më të larta të bukës, ndryshimi i tarifave të elektricitetit dhe të telekomunikacionit). Politika monetare do të vazhdojë të synojë mbajtjen e inflacionit brenda objektivit prej 2-4 për qind. Megjithatë, banka po bën përpjekje të paraprijë rreziqet që mund të pengojnë atë në arritjen e objektivit në të ardhmen dhe përshtatjen e strategjisë së politikës së saj monetare në përputhje me realitetin. Këto rreziqe mund të lidhen me efektivitetin e regjimit aktual të politikës monetare dhe/apo me rreziqe të jashtme. Më poshtë do të përpiqemi t'i analizojmë këto dy çështje më hollësisht.



Grafik 2. Inflacioni i çmimeve të konsumit dhe inflacioni bazë.

3. PROBLEMI I KOMUNIKIMIT ME REGJIMIN AKTUAL TË TARGETIMIT MONETAR

Sipas Estrella dhe Mishkin (1997), kur inflacioni sillet nën kontroll, roli informues i agregatëve monetarë zvogëlohet pasi "zhurmat" relative të goditjeve (shokeve) të shpejtësisë së parasë rriten. Kjo, sipas tyre, mund të jetë një arsye e rëndësishme pse vendet e industrializuara dhe shumë nga ato në zhvillim, gjatë periudhës së stabilitetit të çmimeve, nuk mbështeten në kontrollin monetar. Ndryshueshmëria e shpejtësisë së qarkullimit të parasë mund t'i atribuohet kryesisht paqëndrueshmërisë së kërkesës për para, që është rritur sidomos me përparimet dhe me ndryshimet strukturore të sistemeve financiare.

Rasti i Shqipërisë është përmendur shpesh si një rast i suksesshëm i përdorimit të kontrollit monetar në uljen e inflacionin. Megjithatë, nuk është e qartë nëse ky sukses mund t'i atribuohet vetëm ose në një shkallë të lartë, kësaj strategjie dhe nëse ky regjim do të mbetet i suksesshëm edhe në të ardhmen, duke konsideruar të metën e përmendur nga Estrella dhe Mishkin (1997).

Banka e Shqipërisë ka ndjekur disa objektiva gjatë viteve në tranzicion si, uljen e inflacionit, rritjen e rezervave të saj valutore, zbutjen e luhatshmërisë së kursit të këmbimit, përmirësimin e stabilitetit financiar si dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik. Përsa i përket objektivit të saj kryesor të përcaktuar në ligj, stabilitetit të çmimeve, komunikimi me publikun është realizuar duke shpallur normën e rritjes vjetore të parasë gjithsej (M3), bazuar në programin monetar të përpiluar çdo fillim viti dhe të azhornuar çdo tremujor.

Rritja e parasë matet bazuar në një ekuacion sasior të parasë në përputhje me një nivel të caktuar inflacioni, dhe projeksione të rritjes së mundshme të prodhimit dhe shpejtësisë së parasë. Ky lloj shënjestrimi monetar është i ngjashëm me shënjestrimin e PPB nominale. Disa autorë (Taylor, 1985), argumentojnë se ky regjim funksionon më mirë për zbutjen e goditjeve të ofertës sepse një rënie e PPB-së reale automatikisht çon në një politikë monetare lehtësuese.

Gjithashtu, vitet e fundit Banka e Shqipërisë ka bërë publik nivelin e objektivit zyrtar për inflacionin, gjë e cila ka shtyrë Stone (2003) ta klasifikojë Shqipërinë si një vend me shënjestrim inflacioni të pjesshëm (të butë) në krahasim me vendet me IT të plotë.

Siç mund të shihet nga tabela 1, strategjia e shënjestrimit të agregatëve monetarë, në pamje të parë, ka funksionuar jo keq po të konsiderohet fakti që niveli i inflacionit të fundvitit është sjellë dy herë nën kontroll, pas 1992 dhe pas 1997. Megjithatë, mund të bëhen edhe disa vërejtje të tjera. Së pari, norma aktuale e rritjes së M3 deri në vitin 2000 është shmangur ndjeshëm nga objektivi i planifikuar. Në kontrast me këtë, objektivi i inflacionit zyrtar gjatë të njëjtës periudhë ka qenë në shumicën e kohës nën nivelin e planifikuar. Ky fakt ngre dyshime rreth rëndësisë relative të ankorimit nominal të përdorur për arritjen e niveleve të ulëta të inflacionit.

Viti	Baza Monetare		M3		Inflacioni	
	Projeksioni	Aktuale	Projeksioni	Aktuale	Niveli i dëshiruar	Niveli aktual
1993	-	-5.9	44.1	74.4	-	30.9
1994	-	-2.0	29.0	41.0	24.0	15.8
1995	-	-1.1	23.0	51.8	10.0	6.1
1996	-	2.6	22.0	43.8	12.0	17.4
1997	-	12.0	-	28.5	53.0	44.6
1998	-	14.1	23.0	20.6	10.0	8.7
1999	-	21.6	15.0	22.2	7.0	-1.0
2000	-	24.1	12.1	12.8	2-4	4.2
2001	11.4	18.1	15.4	19 9	2-4	3.5
2002	10.8	11.2	6.2	5.1	2-4	1.7
2003	-0.6	-1.9	9.5	8.3	2-4	3.3
2004	7.9	11.2	10.6	13.5	2-4	2.2
2005	5.7	-	8.3	-	2-4	-

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 2. Agregatët monetarë të planifikuar kundrejt atyre faktikë dhe inflacioni (fund i vitit, ndryshimi në %).

Së dyti, ndonëse prej vitit 2000 rritja e M3 ka qenë shumë afër objektivit të saj, normat e rritjes kanë ndryshuar gjerësisht, nga 5 në 13 për qind, krahasuar me normat relativisht të qëndrueshme të inflacionit. Kjo e bën të vështirë për publikun që të kuptojë synimin e saktë të Bankës së Shqipërisë, duke u mbështetur thjesht në objektivat e shpallur të rritjes së M3. Për shembull, objektivi 3 për qind i nivelit të inflacionit mund të lidhet me një shtrirje të gjerë të normave të rritjes së M3, nga 9 deri 15 për qind. Kjo mbështet argumentin e Estrella dhe Mishkin (1997), që agregatët monetarë e humbasin funksionin e tyre informativ për nivele të ulëta inflacioni.

Banka e Shqipërisë e ka njohur problemin e mësipërm për sa kohë që vendimet për ndryshimet e pozicionit të politikës monetare janë bazuar në një gamë më të gjerë informacioni se sa thjesht norma e rritjes së M3. Veçanërisht, prej disa kohësh, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje të veçantë parashikimit të inflacionit, i cili përfshin disa informacione shtesë si: presionet inflacioniste të ardhura nga luhatjet e kursit të këmbimit, ndryshimet e çmimeve në tregje të ndryshme, përfshirë dhe tregjet e huaj, goditjet e ofertës etj.. Kjo mënyrë drejtimi e politikës monetare përngjason shumë me regjimin e shënjestrimit të inflacionit. Megjithatë, ka dy elemente të rëndësishme që e dallojnë Shqipërinë nga vendet e tjera me regjim IT formal. Këto janë komunikimi i strategjisë së politikës monetare përfshirë publikimin dhe shpjegimin e parashikimit të inflacionit, si dhe ngritja e një mekanizmi formal që e bën Bankën e Shqipërisë të përgjegjshme për objektivin e shpallur të inflacionit.

Megjithëse mund të duket i drejtpërdrejtë, zbatimi i IT ka dhe disa probleme, sidomos për ekonomitë në zhvillim. Në seksionin tjetër do të përpiqemi të analizojmë më hollësisht disa nga përparësitë dhe problemet që mund të hasë Banka e Shqipërisë në kalimin në një regjim formal IT.

4. REGJIMI I SHËNJESTRIMIT TË INFLACIONIT: ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR TIJ PËR SHQIPËRINË

Përderisa agregatët monetarë nuk përmbajnë gjithë informacionin e mjaftueshëm për parashikimin e inflacionit, mbështetja në regjimin e kontrollit

monetar mund të jetë jo optimale. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë është duke shqyrtuar kalimin në një regjim formal IT në një periudhë afatmesme. IT bazohet në idenë se objektivi më i mirë i ndërmjetëm i politikës monetare që synon kontrollin e inflacionit është parashikimi i vetë inflacionit (Cukierman and Liviatan, 1992; Svensson, 1997). Parashikimi i inflacionit, në dallim nga agregatët monetarë, është i pakufizuar në informacionin që mbulon. Çdo informacion i rëndësishëm për inflacionin e ardhshëm mund të merret parasysh.

Në dekadën e fundit një literaturë e gjerë ka argumentuar përparësitë e regjimit IT krahasuar me regjimet e tjera, të përmbledhura në një seri studimesh nga Mishkin etj. (1997, 2000, 2002). Ndër përparësitë më të rëndësishme të IT mund të përmendim: bazën më të gjerë të informacionit në të cilin bazohet, fleksibilitetin relativisht më të lartë në lidhje me goditjet e ofertës, faktin që është lehtësisht i kuptueshëm nga publiku etj..

Megjithatë, adoptimi i një regjimi IT paraqet edhe probleme. Problemi kryesor për Shqipërinë lidhet me rrezikun më të lartë që ai mbart për reputacionin e Bankës së Shqipërisë krahasuar me regjimin aktual të kontrollit të parasë. Siç u përmend më lartë, megjithëse objektivat për M3 nuk janë arritur në mënyrë të vazhdueshme deri në vitin 2001 (shih tabelën 1) inflacioni është zvogëluar, gjë që tregon se reputacioni i Bankës së Shqipërisë të paktën nuk është përkeqësuar, ndërkohë që dhe mund të jetë përmirësuar. Kjo ndoshta është e lidhur me nivelin e ulët të njohjes së saktë të lidhjes midis M3 dhe inflacionit nga ana e publikut, gjë që i jep bankës më shumë hapësirë të shpjegojë mosarritjen e objektivit. Në rastin e regjimit IT mosarritja e objektivit mund të jetë më e kushtueshme përsa i përket reputacionit të bankës.

Vitet e fundit, reputacioni i BANKËS SË SHQIPËRISË përsa i përket objektivit të inflacionit rreth nivelit 3 për qind, pa dyshim që është forcuar. Sidoqoftë, pretendimi që niveli aktual i reputacionit është i kënaqshëm për të adoptuar një regjim të shënjestrimit të inflacionit do të ishte i parakohshëm. Ekzistojnë disa probleme që mund të kufizojnë konfidencën e Bankës së Shqipërisë në përmbushjen e objektivit të inflacionit të ulët, që mund të rrezikojnë reputacionin e saj në të ardhmen në arritjen e shënjestrimit të inflacionit. Një pjesë e këtyre problemeve ka të bëjë me vetë Bankën e Shqipërisë, ndërkohë që ka dhe faktorë jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë. Le të përqëndrohemi më hollësisht në disa nga këto probleme.

5. PENGESAT NË BANKËN E SHQIPËRISË

Problemet që lidhen me Bankën e Shqipërisë për adoptimin e IT janë më tepër teknike e disi më pak institucionale. Banka e Shqipërisë gëzon një nivel relativisht të lartë pavarësie dhe me ligj ka si objektiv të saj kryesor ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Megjithatë, shkalla e lartë e pavarësisë ligjore të Bankës së Shqipërisë nuk tranformohet plotësisht në pavarësi reale, e cila akoma mendohet të jetë më e ulët se ajo e përcaktuar me ligj. Disa të dhëna empirike (Luçi 1999) sugjerojnë që Banka e Shqipërisë përpiqet të

ruajë pavarësinë e saj nga qeveria edhe pse mungesa e instrumenteve dhe pasiguria e mekanizmit të transmisionit e bën të vështirë arritjen gjithmonë të objektivave. Një hap i rëndësishëm në përmirësimin e pavarësisë reale të Bankës së Shqipërisë do të ishte eliminimi i plotë i mundësisë së financimit të qeverisë, e cila për momentin është 5 për qind (e të ardhurave mesatare të 3 viteve të fundit). Kjo do të ndihmonte Bankën e Shqipërisë për të shmangur akoma më shumë ndërhyrjet e qeverisë në politikën e saj monetare dhe do të rriste presionet ndaj kësaj të fundit për të konsoliduar më tej politikën e saj fiskale, ose nëpërmjet rritjes së të ardhurave të saj ose nëpërmjet uljes së shpenzimeve.

Adoptimi i regjimit IT mund të kërkojë disa përmirësime të mëtejshme të ligjit, por për momentin nuk parashikohet ndonje pengesë e veçantë në lidhje me këtë pikë. Përsa i përket anës teknike, një regjim IT i suksesshëm kërkon një kuptim të mirë të mekanizmit të transmisionit të politikës monetare, një model të mirë për parashikimin e inflacionit dhe një kuadër komunikimi eficient me publikun. Megjithëse nga ana e Bankës së Shqipërisë janë bërë përpjekje pozitive në të gjitha këto drejtime, përsëri mbetet shumë për t'u bërë, sidomos në lidhje me dy pikat e para. Departamenti i Kërkimeve në bashkëpunim me Departamentin e Politikës Monetare dhe me Departamentin e Operacioneve Monetare ka përpiluar një listë të problemeve teknike që duhen përballur, e cila përgjithësisht ka për qëllim përmirësimin e të kuptuarit tonë të mekanizmit të transmisionit të politikës monetare, të burimeve të inflacionit dhe të funksionimit të ekonomisë shqiptare në tërësi.

Puna mbi këto probleme mund të kërkojë kohë përpara se të shihen rezultate konkrete. Në veçanti dy janë problemet që duhen adresuar sa më herët, për të përshpejtuar progresin. Ato janë: ekspertiza e pamjaftueshme teknike për të siguruar instrumentet e nevojshme për implementimin e regjimit të IT dhe gjendja e rënduar e statistikave kombëtare ekonomike. Problemi i parë është adresuar nëpërmjet ekspertizës teknike të institucioneve ndërkombëtare si FMN. Megjithatë, për të siguruar një progres të qëndrueshëm në kohë, po merret në shqyrtim dhe një strategji për zhvillimin e kapitalit njerëzor brenda bankës. Përsa i përket pengesave lidhur me të dhënat statistikore, janë ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar burimet e këtyre të dhënave si: kryerja e vrojtimeve, intervistave si dhe ndihmesa dhënë INSTAT-it për të përmirësuar frekuencën dhe cilësinë e statistikave të llogarive kombëtare.

6. RREZIQE TË TJERA NË ADOPTIMIN E REGJIMIT TË IT

Edhe sikur Banka e Shqipërisë të arrijë ta vërë veten në pozita për ta adoptuar në mënyrë eficiente regjimin e IT, ekzistojnë probleme të tjera jashtë kontrollit të saj që mund të pengojnë arritjen e objektivit [të inflacionit]. Këtu mund të përfshihen ndryshimet e çmimeve administrative dhe reformat strukturore në përgjithësi, mungesa e disiplinës fiskale, dollarizimi, ulja e të ardhurave nga emigrantët si dhe luhatshmëria e mundshme e kursit të këmbimit, zhvillimi dhe stabiliteti i sistemit financiar etj..

Çmimet e kontrolluara nga qeveria mund të përbëjnë një kërcënim për arritjen e objektivit të inflacionit të shpallur. Ky fenomen ka shkaktuar probleme për Bankën e Shqipërisë edhe në të kaluarën. Një zgjidhje e këtij problemi mund të jetë shënjestrimi i inflacionit, bazuar në një shportë që lë jashtë çmimet administrative. Megjithatë, kjo e bën objektivin më pak të qartë për publikun. Një zgjidhje tjetër mund të kërkojë që qeveria të ketë një plan më të saktë për liberalizimin e çmimeve në mënyrë që BANKA E SHQIPËRISË të përshtasë më mirë objektivin final në përputhje me këtë plan.

Autorë të ndryshëm (Masson et al., 1997; Stone, 2003) kanë theksuar rëndësinë e disiplinës fiskale në suksesin e regjimit IT. Edhe pse disiplina fiskale, deri më tani, ka ndihmuar në uljen e inflacionit në Shqipëri, në të ardhmen probleme të ndryshme, sidomos ato që lidhen me disa reforma strukturore, mund të detyrojnë qeverinë ta zbusi disi këtë disiplinë. Ndërmjet këtyre problemeve vlen të përmendet mënyra se si ligji i kompensimit të pronarëve të tokave do të zbatohet. Në qoftë se qeveria do të mbulojë shumicën e shpenzimeve të kompensimit nga buxheti i saj, kjo do të krijojë presione jo të vogla inflacioniste.

Një shkallë e lartë e zëvendësimit të monedhës (euroizim, dollarizim) mund të shkaktojë probleme serioze për IT (Mishkin, 2000). Dollarizimi i pjesshëm mund ta bëjë regjimin e IT-së, që kërkon zbatimin e një kursi fleksibël këmbimi, të cënueshëm ndaj paqëndrueshmërisë financiare (Mishkin dhe Sevastano, 2002). Në Shqipëri shkalla e dollarizimit, e llogaritur si raport i depozitave në valutë ndaj aktiveve gjithsej të sistemit bankar, është rreth 20-30 për qind. Problemet lidhur me dollarizimin duhet të trajtohen me kujdes, duke konsideruar dhe mundësinë e rënies së të ardhurave nga emigrantët. Këto të fundit, deri tani kanë krijuar një shtresë mbrojtëse ndaj ndikimit të përkeqësimit të deficitit të llogarisë korente si dhe kanë siguruar një kurs këmbimi relativisht të qëndrueshëm. Një sistem financiar i shëndoshë është i rëndësishëm për suksesin e IT, për disa arsye. Një sistem financiar i shëndoshë mund të përballojë më lehtë ndikimet negative të luhatshmërive të mundshme të kursit të këmbimit, që mund të vijnë si pasojë e euroizimit/dollarizimit të lartë.

Gjithashtu, duke marrë parasysh objektivat e ndryshëm të ndjekur nga Banka e Shqipërisë, është e rëndësishme të shqyrtohet nëse Banka e Shqipërisë rrezikon ta respektojë objektivin e inflacionit në rast se ai konflikton me arritjen e objektivave të tjerë si stabiliteti financiar. Një sistem financiar i shëndoshë do ta vinte Bankën e Shqipërisë nën një presion më të vogël për të sakrifikuar njërin objektiv për tjetrin.

Zhvillimi i sistemit financiar është gjithashtu një faktor kryesor për drejtimin e politikës monetare. Niveli aktual i zhvillimit të sistemit financiar në Shqipëri është i pamjaftueshëm për të realizuar një politikë monetare efektive. Aktualisht, shkalla e konkurrencës midis bankave është mjaft e ulët, ndërkohë që tregjet e parasë dhe bursat janë praktikisht joekzistente. Kështu që, mbetet shumë për t'u bërë për të rritur thellësinë e sistemit financiar veçanërisht atë të bursave dhe të tregjeve të parasë.

Privatizimi i kohëve të fundit i Bankës së Kursimeve pritet të nxisë konkurrencën e sistemit bankar shqiptar dhe të zgjerojë kredinë për ekonominë. Megjithatë, ekziston një shqetësim rreth mundësisë së një zgjerimi "të tepruar" të kredisë, duke parë eksperiencën e disa vendeve të tjera në tranzicion (Cottarelli etj., 2004). Kjo është një çështje shumë kritike e cila meriton vëmendje të veçantë dhe shqyrtim të mëtejshëm (shiko Box 1).

Megjithëse Mishkin dhe Sevastano (2002) argumentojnë se problemet e sipërpërmendura janë të rëndësishme edhe për regjimet e tjera të politikave monetare, nën një regjim IT kostoja e lidhur me vënien në rrezik të reputacionit të bankës qendrore mund të jetë shumë më e lartë.

Box 1: Rritja e mundshme e kreditimit.

Rritja e shpejtë e kreditimit, i cili jo shumë kohë më parë konsiderohej si një arritje e madhe, sot është kthyer në një shqetësim për vendet në tranzicion, përfshirë Shqipërinë e cila deri më sot ka mbetur mbrapa. Vëllimi i kredisë për sektorin privat në Shqipëri në përqindje të PBB-së ka mbetur pothuajse i pandryshuar që nga fillimi i tranzicionit deri kohët e fundit, në nivelin prej rreth 6 për qind. Kultura e pazhvilluar e biznesit dhe transparenca e ulët e ndërmarrjeve private të sapongritura, duket se kanë qenë pengesë kryesore për zgjerimin e aktiviteteve kredituese të bankave. Probleme të tjera që lidhen me të drejtat e pronësisë, me zbatimin e ligjit dhe me infrastrukturën e dobët në Shqipëri kanë ndikuar gjithashtu, në këtë rezultat. Mangësitë që karakterizuan bankat shtetërore çuan në akumulimin e një sasie të madhe të kredive me probleme të dhëna nga këto banka. Kjo detyroi autoritetet rregullatore të marrin fillimisht masa shtrënguese dhe pastaj të bllokojnë plotësisht aktivitetet e tyre kredituese. Në pamje të parë, vonesa e krijuar në privatizimin e bankave shtetërore, që mund të ketë mundësuar lirimin e fondeve të tyre për kreditim, duket se ka qenë arsyeja kryesore e nivelit të ulët të kreditimit në Shqipëri. Megjithatë, bankat private që nuk u kufizuan nga autoritetet rregullatore nuk i kanë kanalizuar një pjesë të mirë të fondeve të tyre në kredi tregtare.

	2002	2003	2004 –Q1	2004 –Q2	2004 –Q3	2004 –Q4
Kredia e brendshme ndaj M3 (%)	70.8	71.5	71.6	69.5	67.4	68.7
- për qeverinë	61.5	60.2	59.9	57.1	54.9	55.0
- për ekonominë	9.3	11.3	11 7	12.3	12.5	13.7
Kredia për ekonominë si % ndaj totalit të aktiveve	11.5	13.7	13.7	14.6	14.7	16.6
Raporti Kredi/Depozita (%)	13.5	15.7	15.8	16.6	16.8	18.8
Kredia për ekonominë (% ndaj PBB)	5.7	6.8	6.3	6.7	7.2	8.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur nivelin e ndërmjetësimit në sistemin bankar. Kjo ka konsistuar në sqarimin e kuadrit rregullator, që rregullon aktivitetin kreditues të bankave dhe në disa masa që janë marrë tashmë në lidhje me heqjen e shumave fikse të detyrueshme të kolateralit për kredinë. Tani, është përgjegjësi e bankës për të gjykuar lidhur me nevojën e kolateralit dhe për t'u siguruar që vlera e tij të jetë e përshtatshme për të mbuluar shumën e kredisë dhe çdo kosto tjetër që lidhet me ekzekutimin e saj. Megjithatë, në çdo rast, ne do të këmbëngulim që bankat t'i ruajnë në nivele të larta dhe t'i forcojnë proceset e tyre të administrimit të kredisë, në mënyrë që të sigurohet një rritje e balancuar

dhe e shëndoshë e aktivitetit. Nisur nga përbërja e portofolit të huave, që kryesisht janë akorduar në valutë, bankat janë të detyruara t'i kushtojnë vëmendje të veçantë fluksit të parasë së huamarrësve të tyre, meqë ai mund të mos shprehet në të njëjtën monedhë me atë të kredisë. Çdo ndryshim i disfavorshëm dhe i papritur në kursin e këmbimit mund të sjellë vështirësi, nëse nuk parashikohet në kohë.

Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë është përpjekur të nxisë kreditimin në monedhën vendase. Midis të tjerash, ajo do të përmirësojë efektivitetin e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Duke parë në një këndvështrim mikrofinanciar më të gjerë, Banka e Shqipërisë ka kontribuar për këtë qëllim duke e ulur normën e repos në nivele të ulëta historike dhe duke e ngushtuar diferencën e normave të interesit të kredive në lek me atë në valutë.

Megjithë zbutjen e politikës monetare dhe uljen e normës zyrtare të interesit (norma e repos është ulur me 3.25 pikë përqindjeje gjatë dy viteve të fundit), spread-i i normave të interesit të kredive në lek/valutë, mbetet i dukshëm. Një faktor tjetër që mbështet interesin për kredinë në valutë është natyra e aktivitetit të biznesit. Sipas statistikave, sektorët më të kredituar operojnë në shumicën e rasteve në valutë. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbështesë rritjen e kreditimit në lekë të ekonomisë. Parashikojmë që Banka Raiffeisen të kontribuojë në një zgjerim më të madh të kreditimit në lekë duke ditur se ajo zotëron 67 për qind të depozitave në lekë të sistemit bankar. Me një fjalë, 86 për qind e depozitave në këtë bankë janë në lekë.

Lidhur me rritjen e kreditimit për periudhën afatmesme, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë përpjekjet për ta nxitur atë akoma më shumë edhe gjatë viti 2005, meqë Banka Raiffeisen filloi aktivitetin e saj kredites dhe i shton tregut më tepër shërbime. Megjithatë, ndikimi i këtij ndryshimi në kreditimin e përgjithshëm bankar në sektorin privat është i kushtëzuar nga pasiguri të ndryshme, që kanë të bëjnë me evoluimin e mjedisit institucional dhe ligjor në të cilin zhvillohet aktiviteti kredites. Probleme në rregulloret dhe praktikat që prekin të drejtat e kreditorëve, përkeqësojnë kushtet e rrezikut në ekonomi, duke e bërë atë të vështirë për të vlerësuar shpejtësinë me të cilën përhapet shtrirja e kreditimit.

Disa vlerësime paraprake, të bazuara në ecurinë e rritjes së kreditimit gjatë tre viteve të fundit dhe në parashikimet e rritjes së kreditimit të bëra nga Banka Raiffeisen, si dhe në njëfarë shkalle, zëvendësimi me rritjen e kreditimit të bankave të tjera, tregojnë një rritje vjetore të kreditimit në sektorin privat në shumën prej rreth 30-35 miliardë lekësh, ose 45-50 për qind, për vitin 2005.

Rritja e kreditimit në periudhën afatmesme mendohet të stabilizohet me rreth 3-4 pikë përqindjeje të PBB-së në nivel vjetor. Kjo është nën kufirin kritik prej 5 për qind. Megjithatë, ne marrim parasysh gjithashtu edhe mundësinë e asaj që ka ndodhur në vendet e tjera të rajonit. Për këtë qëllim, janë marrë disa masa për të depërtuar më thellë në tregun e strehimit, i cili ka njohur një rritje të konsiderueshme të çmimeve dy vitet e fundit. Nëse kreditimi bankar zgjerohet me shpejtësi drejt kredive për strehim, rreziku është se kjo mund të çojë në një skemë spekulative të rrezikshme.

Nga njëra anë, nëse pjesa më e madhe e kredisë jepet në valutë të huaj, për bankën tonë do të jetë e vështirë të tkurrë zgjerimin e kësaj kredie, dhe ndoshta do të aplikojë disa lloje masash direkte, që do të thotë një hap mbrapa për politikën monetare. Nga ana tjetër, ajo do të aplikojë shtrëngime ndaj mbikëqyrjes bankare për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit bankar në rast se do të ketë një rënie të mundshme të çmimeve të strehimit.

(Bazuar në materiale të ndryshme të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë)

7. REGJIMET ALTERNATIVE

Alternativat e tjera ndaj targetimit të inflacionit dhe atij monetar janë fiksimi i kursit të këmbimit dhe e ashtuquajtura politika just to do it që zbaton Rezerva Federale - FED (Mishkin, 2002). Efekti përçues i kursit të këmbimit në Shqipëri mendohet të jetë i lartë, ndonëse asimetrik, duke patur parasysh pjesën e konsiderueshme që zënë mallrat e importit në shportën e konsumatorit (afërsisht 70%). Kjo të bën të mendosh që ky regjim mund të jetë një mënyrë efektive për të drejtuar politikën monetare. Megjithatë, fiksimi i kursit të këmbimit deri më sot është hedhur poshtë si një strategji e përshtatshme për Shqipërinë, për një sërë arsyesh. Fillimisht, për shkak të rezervave ndërkombëtare të pamjaftueshme, dhe më vonë prej rrezikut të mbiçmimit të kursit real të këmbimit, sidomos kur faktorët bazë të përcaktimit të tij janë ende të panjohur. Megjithëse mendojmë se lënia e përcaktimit të kursit të këmbimit nga forcat e lira të tregut është strategjia më e mirë për t'u ndjekur, në rrethana të caktuara ndërhyrja mund të jetë një mënyrë efektive për të frenuar inflacionin, sidomos kur vërehen spirale midis zhvlerësimit të kursit të këmbimit dhe pritshmërive të pabazuara inflacioniste. Megjithatë, në rastet kur burimi i presionit inflacionist është i natyrës strukturore, një strategji e tillë mund të shkaktojë më shumë probleme sesa përfitime.

Grafik 3. Kursi i këmbimit.

Megjithatë, shumica e diskutimeve mbi kursin e këmbimit i referohen skenarëve për të kontrolluar zhvlerësimin, me qëllim frenimin e inflacionit të lartë. Por, prej kohësh Shqipëria ashtu si disa nga vendet e tjera të tranzicionit po vëren një vlerësim të monedhës së saj. Ndërkohë që kjo ka ndihmuar në zbutjen e presioneve inflacioniste, shqetësimi për uljen e aftësisë konkurruese të jashtme ka ardhur duke u rritur. Kjo ka bërë që Banka e Shqipërisë të ndërhyjë herë pas here në treg dhe të ulë normat e interesit në monedhën vendase, për të parandaluar mbiçmimin "e tepruar" të Lekut në terma nominale kundrejt Euros. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse ky mbiçmim është një kthim në një ekuilibër afatgjatë të mbështetur në faktorë bazë. Diskutimi i mësipërm tregon se zhvillimet e kursit të këmbimit nuk mund të injorohen kaq lehtë në vendimmarrjen e politikës monetare, edhe në kushtet e ndjekjes së regjimit të luhatjes së lirë.

Strategjia tjetër "just do it" mund ta karakterizojë jo keq politikën aktuale monetare të ndjekur në Shqipëri. Megjithëse Banka e Shqipërisë ka një objektiv monetar të deklaruar dhe një objektiv inflacioni të nënkuptuar, siç u përmend dhe më lart, mënyra e drejtimit të politikës monetare ka shumë elemente diskrete brenda saj për të arritur objektivin kryesor të inflacionit të ulët, duke lënë mundësinë e përshtatjeve ndaj goditjeve të ofertës. Përkrahësit e këtij regjimi kundërshtojnë kalimin e ShBA nga ky regjim drejt një regjimi formal IT duke argumentuar që, "përsa kohë që funksionon s'ke pse rregullon". Megjithatë, në rastin e Shqipërisë ruajtja e efektivitetit të kësaj strategjie për një kohë të gjatë mund të jetë e dyshimtë, nëse konsiderojmë faktin që Banka e Shqipërisë nuk gëzon të njëjtën shkallë reputacioni si dhe FED. Sipas Stone (2003) në këtë regjim mund të kalohet vetëm pasi është zbatuar një regjim formal IT, dhe është shumë e vështirë dhe e rrezikshme për një vend në zhvillim të kalojë direkt në këtë regjim.

8. KONKLUZIONE

Mbështetja e Shqipërisë në regjimin e kontrollit monetar, edhe pse deri më sot duket të mos ketë përjetuar ndonjë problem serioz, mund jetë e pamjaftueshme për të ruajtur inflacionin e ulët në të ardhmen. Veçanërisht, fuqia sinjalizuese e agregatëve monetarë të targetuar nga Banka e Shqipërisë mund të fillojë të hasë vështirësi. Ndaj duhen konsideruar regjime alternative si ai IT, të cilët mund të transmetojnë më mirë sinjalet e bankës qendrore. Megjithatë, edhe regjimet alternative nuk janë pa probleme. Në rastin e regjimit IT, për shkak të rritjes së shkallës së qartësisë dhe të të kuptuarit të objektivit të synuar, ekziston një rrezik më i lartë që reputacioni i bankës qendrore të dëmtohet në rastin e mosarritjes së objektivit, krahasuar me regjimet e tjera. Për këtë arsye, zbatimi i tij duhet të mbajë parasysh të gjitha kërkesat e nevojshme teknike si dhe skenarët e pafavorshëm, që mund të vënë në rrezik suksesin e këtij regjimi.

Nga analiza jonë e shkurtër konkludohet se megjithë problemet që Banka e Shqipërisë mund të ndeshë në plotësimin e kërkesave të regjimit të ri, në periudhën afatmesme implementimi i tij mbetet i mundshëm, me kushtin që ndërkohë puna në këtë drejtim të intensifikohet.

BIBLIOGRAFIA

Bernake, S. B. dhe Mishkin, F. (1997) "Inflation Targeting: A New Framework for Monetary Policy?" (Targetimi i inflacionit: Një kuadër i ri për politikën monetare?), Journal of Economic Perspective, Vol. 11, No. 2, pp. 97-116.

Cukierman, A. dhe Liviatan, N. (1992) "The Dynamics of Optimal Gradual Stabilisation." (Dinamikat e stabilizimit gradual optimal), World Bank Economic Review, Vol. 6, pp. 439-58.

Cotarrelli, C., Dell' Ariccia, G. dhe Vladkova-Hollar, I. (2004) "Early Birds, Late Risers, and Sleeping Beauties: Bank Credit Growth to Private Sector in Central and Eastern Europe and the Balkans." IMF Working Paper, No. 03/313, International Monetary Fund, Washington DC.

Çeliku, E. (2005), "Inflacioni bazë: matja dhe lidhja e tij me agregatët monetarë", Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë.

Estrella, A. dhe Mishkin, F. (1997) "Is there a role for monetary aggregates in the conduct of monetary policy?" (A ekziston një rol për agregatët monetarë në drejtimin e politikës monetare?) Journal of Monetary Economics, Vol. 40, pp. 279-304.

Luçi, E. (1999) "Central bank independence of the transition economies", dissertation MA Economics, Staffs. Uni. UK.

Masson, P. R., Sevastano, M. A. dhe Sharma, S. (1997) "The Scope of Inflation Targeting in Developing Countries" (Sfera e targetimit të inflacionit në vendet e zhvilluara), IMF Working Paper No. WP/97/130, International Monetary Fund, Washington DC.

Mishkin, F. (2000) "Inflation Targeting in Emerging-Market Countries" (Targetimi i inflacionit në vendet me tregje në zhvillim), American Economic Review, Paper and Proceedings, Vol. 90, No. 2, pp. 105-109.

Mishkin, F. dhe Sevastano, M. A. (2002) "Monetary Policy Strategies For Emerging Market Countries: Lessons From Latin America" (Strategjitë e politikës monetare për vendet me tregje në zhvillim), Comparative Economic Studies, Vol. 54, No. 2, pp. 45-82.

Mishkin, F. S. (2002) "Monetary Policy" (Politika monetare), NBER Reporter Winter.

Sojli, E. (2004) "An evaluation of currency substitution in the Albanian economy" (Një vlerësim i zëvendësimit të monedhës në ekonominë shqiptare), forthcoming, Bank of Albania, Working Paper.

Stone M. R. (2003) "Inflation Targeting Lite" (Pikëpamje mbi targetimin e inflacionit), IMF Working Paper No. WP/03/12, International Monetary Fund, Washington DC.

Svenson L. E. O. (1997) "Inflation Forecast Targeting: Implementing and Monitoring Inflation Targets." (Targetimi i parashikimit të inflacionit: Implementimi dhe monitorimi i objektivave të inflacionit), NBER Working Paper No. 5797.

Taylor, J. (1985) "What Would Nominal GDP Targeting do to the Business Cycle?" (Çfarë do t'i sillte targetimi i PBB-së nominale ciklit të biznesit?), In Carnegie-Rochester Conference series on Public Policy. Vol. 22, North-Holland, Amsterdam. pp. 61-84.

SINJALET E BANKËS SË SHQIPËRISË, INFLACIONI I PRITUR NGA PUBLIKU PËRBALLË ATIJ TË FAKTUAR PËR VITIN 2004

*Dr. Evelina Çeliku**
*Rezarta Nasto***
Departamenti i Kërkimeve

Në këtë analizë janë bërë përpjekjet e para për të vlerësuar nga pikëpamja sasiore pritjet për inflacionin si edhe janë evidentuar disa nga burimet kryesore të krijimit të tyre. Analiza është një reflektim mbi rezultate e përpunime treguesish për pritjet inflacioniste për vitin 2004, të rreth 1200 konsumatorëve dhe të 540 bizneseve[1] duke i krahasuar ato me shifrën e faktuar të inflacionit gjatë këtij viti.

1. HYRJE.

Një nga çështjet e rëndësishme për të cilën politika monetare e një banke qendrore duhet të jetë e qartë para dhe gjatë aplikimit të vendimeve të marra për shqyrtimin e qëndrimit të saj, lidhet me faktin se si dhe sa agjentët ekonomikë, biznesi dhe popullata në përgjithësi, i thith dhe i kupton sinjalet që ajo "lëshon" gjatë procesit të vendimmarrjes.

Eficienca e politikës monetare, sidomos në kushtet e regjimit të "Inflacionit të Synuar" (Inflation Targeting), lidhet ngushtë me kanalin e komunikimit me publikun. Publiku dhe bizneset jo vetëm që i thithin sinjalet duke i përdorur ato për të parashikuar situatën financiare në vijim, por nga ana tjetër, me sjelljen apo perceptimet e tyre në treg, krijojnë disa inerci apo nxitje që ndikojnë mbi politikën monetare dhe aspekte të tjera të jetës ekonomike të vendit, për të ardhmen.

Sa e lartë është shkalla e kuptueshmërisë së këtyre sinjaleve nga ana e biznesit që ushtron veprimtari ekonomike në fushat e prodhimit, të ndërtimit dhe shërbimeve apo edhe nga ana e publikut shqiptar në rolin e thjeshtë të konsumatorit? Për t'i dhënë përgjigje një pyetjeje të tillë do të mbështetemi tek analiza e disa informacioneve të marra gjatë vrojtimit të bizneseve dhe konsumatorëve, në rubrikën e veçantë të ngritur për këtë qëllim në pyetësorët përkatës të indekseve të besimit (IBB dhe IBK). Informacioni i marrë nga rreth 540 biznese dhe nga rreth 1200 konsumatorë, përqendrohet në opinionet e tyre në lidhje me pyetje të tilla si: "si perceptohen informacionet e Bankës së Shqipërisë nga publiku?"; "a ndikojnë informacionet e publikuara për inflacionin në nivelin e pritjeve të ardhshme inflacioniste?"; "çfarë sugjerojnë vrojtimet në lidhje me mënyrën e formimit dhe përdorimin e pritjeve të agjentëve në vendimet e tyre financiare?".

** Zëvendësdrejtore e Departamentit të Kërkimeve.*
*** Specialiste e Departamentit të Kërkimeve.*
[1] Vrojtimi i muajit dhjetor 2003 për indeksin e besimit të biznesit dhe të konsumatorit (IBB dhe IBK).

Me këtë përpjekje do të donim të kuptonim nëse historia e inflacionit të viteve të fundit, e cila dëshmon për një normë vjetore të ulët dhe të qëndrueshme të këtij të fundit (figurë 1), është përçuar dhe në pritjet e biznesit dhe publikut.

Pra, në njëfarë mënyre do të donim të gjykonim mbi shkallën e besimit të publikut dhe të bizneseve ndaj vendimeve që merr banka qendrore? Nëse situata do të rezultonte pozitive (pra që Banka gëzon besim të kënaqshëm), a i mbështesin aktorët e tregut (bizneset dhe konsumatorët) këto vendime duke i asimiluar në drejtimin e duhur efektet e ekonomike të tyre?



Grafik 1. Ecuria e inflacionit në Shqipëri (1995-2004).

2. ANALIZA E REZULTATEVE.

Rezultatet e vrojtimit karakterizohen nga një asimetri midis pritjeve mbi inflacionin, bazuar në masën e pritur të rritjes së pagave që këto dy grupe të publikut shqiptar parashikonin të kishin gjatë vitit 2004 (Pyetje 3, Tabelë 1). Deri diku, kjo është disi e pritshme, për sa kohë që konsumatorët dhe bizneset përbëjnë dy grupe të ndryshme interesi ekonomik në treg.

Për vitin 2004, konsumatorët prisnin një rritje mesatare të pagave në masën rreth 7.9 për qind, ndërkohë që bizneset arsyetonin se kjo rritje mund të shkonte rreth 4.2 për qind. Nëse krahasohen shpërndarjet e pritjeve (figura 2 dhe 3) ndërmjet këtyre dy grupeve ekonomike, bie në sy përqendrimi i tyre drejt intervaleve skajore, ndërkohë që pritjet e bizneseve gjenden të grumbulluara në intervalin 1-5 për qind. Këtë e dëshmojnë edhe vlerat e devijimeve standarde për grupet përkatëse.

Megjithatë, nëse gjykojmë mbi shkallën e variacionit, ajo paraqitet pothuaj e njëjtë, madje në nivele të larta, si te konsumatorët ashtu edhe tek bizneset (rreth 46 për qind). Kjo do të thotë që pritjet mesatare për rritje të mundshme të pagave gjatë vitit 2004 duhen konsideruar me rezerva, nisur nga gjykimi i këtyre aktorëve.

Tabelë 1. Rezultatet përpunimit të përgjigjeve.

PYETJET E RUBRIKËS SË VEÇANTË	PËRGJIGJET E KONSUMATORËVE	PËRGJIGJET E BIZNESEVE
1 Frekuenca e rishikimit të pagave		
a. Çdo vit	65.4%	24.4
b. Çdo 2 vjet	3.8%	7.14
c. Mbi çdo 2 vjet	1.1%	12.6
d. Nuk ka një politikë të përcaktuar	29.7%	56.0
2 Faktorët nxitës për rritjen e pagave	(shkalla mesatare e rëndësisë)*	(shkalla mesatare e rëndësisë)
a. Rritja e parashikuar e çmimeve	4.3	2.6
b. Rritja e çmimeve në të kaluarën	3.9	2.3
c. Vjetërsia në punë	3.2	3.2
d. Nxitja e përkushtimit në punë	3.7	3.7
e. Rritja e pagave nga konkurrentët	N/A	3.1
f. Rritja e pagave në sektorin publik	N/A	2.6
3 Rritja aktuale e parashikuar për vitin 2004		
a. 0%	29.2 (0.0)** %	31.8 (0.0) %
b. 1 - 5%	18.6 (26.3) %	50.4 (73.9) %
c. 5 - 10%	29.8 (42.1) %	17.8 (26.1) % (Mbi 5%)
Mbi 10%	22.4 (31.6) %	N/A
Tregues statistikorë të shpërndarjes***		
Rritja mesatare e parashikuar	7.89 %	4.17 %
Devijimi standard i rritjes mesatare	3.61	1.97
Koeficienti i variancës (në %)	45.7 (%)	47.19 %
4 Informacionet më të ndjekura të Bankës së Shqipërisë	(shkalla mesatare e rëndësisë)	(shkalla mesatare e rëndësisë)
a. Rritja e çmimeve	4.0	3.3
b. Normat e interesit	2.6	3.2
c. Kursi i këmbimit	2.7	3.9

Shënim:
*Sa më e lartë shkalla mesatare e rëndësisë, aq më i rëndësishëm është faktori në raport me faktorët e tjerë të listuar. Shkalla mesatare e rëndësisë është matur si mesatare e peshuar e vlerës së shkallës me frekuencën përkatëse (numri i personave që e kanë zgjedhur atë).
**Në kllapa janë vendosur peshat në për qind të normalizuara, pas përjashtimit të grupit (a).
***Në llogaritjen e treguesve statistikorë mbi pritjet për rritje pagash, janë marrë parasysh vetëm alternativat që janë shprehur për rritje pagash, sepse grupi që shprehet për një rritje zero për qind është një grup cilësisht i ndryshëm nga të tjerët.

Grafik 2. Rritja e parashikuar e pagave (2004) - Konsumatorët.



Grafik 3. Rritja e parashikuar e pagave (2004) - Bizneset.



Nëse do t'i referoheshim vlerësimeve për prirjen historike të rritjes së pagave në sektorin privat, duket qartë që pas vitit 1999, bizneset private kanë aplikuar rritje mesatare vjetore që luhaten rreth vlerës 10 për qind. Po të supozonim se kjo rritje do të vijonte me të njëjtat ritme edhe për periudhën 2003-2004, duket se pritjet për rritje pagash, për të dyja grupet, gjenden brenda vlerave historike.

Aktiviteti ekonomik	Viti					
	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Industri	9411	10792	12203	13230	14839	15882
Ndërtim	8340	10617	10936	12489	13416	15014
Transport e komunikacion	9350	11744	14503	16225	18124	23434
Tregti	8819	9653	10901	10889	12856	13924
Shërbime	7814	11856	10718	13012	13140	14453
Gjithsej	9063	10894	12118	13355	14820	16541
Rritja (në %)		20.2	11.2	10.2	11.0	11.6

Burimi:www.instat.gov.al, ASN 1997-2002.

Tabelë 2: Pagat sipas sektorëve.

Analiza e renditjes së faktorëve që do të ndikonin në një rritje potenciale të pagave tregon se:

- "inflacioni i perceptuar", është faktori parësor, sipas konsumatorëve, që do të shtynte këtë rritje. Ky është një fakt që përputhet edhe me teorinë ekonomike të ngritur mbi sjelljen konsumatore. Prania e inflacionit të perceptuar tregon se ekziston njëfarë inercie nxitëse në rritje në shifrat e inflacionit, për shkak të rritjes së pritjeve të konsumatorit;

- rritja e çmimeve në periudhat e kaluara, pa dyshim duhet të reflektohet në treguesin aktual të inflacionit dhe që sipas konsumatorëve duhet të pasqyrohet në rritjen e pagave;

- përdorimi i rritjes së pagës mbetet element nxitës në punë apo si vlerësues i punës nga ana e konsumatorëve;

- rritja e pagës për shkak të vjetërsisë në punë, përsëri konsiderohet nga konsumatorët, si element që duhet të shoqërojë skemën e pagave, në të dy sektorët, publik dhe privat.

Nëse dy faktorët e parë do të kishin një peshë disi më të ulët se sa pesha e vlerës aktuale (përkatësisht 0.3 dhe 0.15) atëherë rritja e pagave për shkak të inflacionit të pritshëm do të ishte rreth 1.88 për qind. Ndërkohë, për shkak të inflacionit aktual (nëntor 2003 = 3.4 për qind), i ponderuar me (0.55), inflacioni do të rezultonte në rreth 1.87 për qind. Pra në total, inflacioni i perceptuar nga konsumatori pritej të ishte rreth vlerës 3.7 për qind për vitin 2004. Kjo tregoi se pritjet e konsumatorëve për të rezultuan brenda bandës së dëshiruar nga banka qendrore.

Duket se perceptimi i inflacionit të lartë i konsumatorëve ra disi ndesh përballë opinionit të bizneseve. Bizneset rritjen e pagave e shihnin më shumë të lidhur me faktin që kjo e fundit shton nxitjen në punë. Nga ana tjetër, edhe bizneset (të gjitha të sektorit privat të ekonomisë) mbajnë parasysh që një rritje page i adresohet më shumë një eksperience më të lartë në punë. Konkurrenca dhe rritjet e pagave në sektorin publik, u listuan gjithashtu ndër faktorët që do ta ndikonin rritjen e pagave nga ana e bizneseve. Kjo politikë rezultoi të jetë larg problemit të indeksimit të pagave për efekt të rritjes së kaluar dhe të pritshme të çmimeve. Ajo deri-diku, reflektoi mungesën e rolit real të sindikatave në tregun e punës në Shqipëri. Pra, e drejta e negocimit dhe e rinegocimit e evidentua si mjaft e zbehtë dhe e pafuqishme.

Megjithatë, nëse do t'i ktheheshim, një llogaritjeje të ponderuar të rritjes së pagave për shkak të rritjes së çmimeve, do të vinim re që edhe vetë bizneset kanë patur një inflacion të perceptuar, për vitin 2004, ndonëse më të ulët se sa konsumatorët. Nëse faktorët ponderues për rritjet e pritshme (të inflacionit dhe të pagave në sektorin publik) dhe të kaluara të çmimeve do të ishin përkatësisht 0.2, 0.2 dhe 0.1 (sepse janë në fund të renditjes), atëherë inflacioni i perceptuar për grupin e bizneseve do të ishte rreth 1.27 për qind. Ndërkohë, për shkak të inflacionit aktual (nëntor 2003 = 3.4 për qind), i ponderuar me (0.5), ai do të rezultonte në rreth 1.7 për qind. Në total, inflacioni i pritur për vitin 2004, nga ana e bizneseve do të vlerësohej rreth 2.97 për qind.

Për të dyja grupet së bashku, duke ponderuar opinionet e tyre në lidhje me pritjet për inflacionin[2], inflacioni i pritshëm për vitin 2004, do të rezultonte rreth 3.4 për qind, sinjal ky që tregonte se, ndonëse kjo kategori e inflacionit rezultonte brenda bandës 2-4 për qind, politika monetare gjatë vitit 2004, nuk duhej ta anashkalonte atë. Në fakt, duket qartë që gjatë procesit parashikues, ato janë konsideruar me shumë kujdes. Duke reflektuar mbi shifrën e faktuar të normës vjetore të inflacionit, e cila rezultoi në dhjetor 2004 vetëm 2.2 për qind, mund vlerësojmë, rreth një vit më pas, se inflacioni rezultoi më i ulët se sa pritej nga publiku dhe jo vetëm nga ky i fundit, por edhe nga vetë parashikimet e fillimvitit (janar 2004), të vetë bankierëve qendrorë për të.

E rëndësishme është të verifikohet fakti se sa pritjet e publikut (konsumatorëve dhe bizneseve), do të gjejnë pasqyrim në inflacionin e vitit në vijim. Nisur nga ekzistenca e një fuqie të ulët negociuese gjatë vendosjes së pagave, mund të konkludojmë se kanali i transmetimit të pritjeve inflacioniste të publikut në nivelin e pagave e më pas të çmimeve, nuk është i plotë. Këtu mund të gjejë shpjegim edhe fakti që niveli i pritjeve nuk pasqyrohet plotësisht në nivelin aktual të inflacionit, pra që pritjet për inflacion më të rritur nga ana e publikut ekzitojnë në nivele relativisht të larta, por që ato nuk do të përcillen plotësisht nëpërmjet kanalit të të ardhurave.

Shpallja e një objektivi sasior mbi inflacionin nga ana e një banke qendrore ndihmon në përmirësimin e konvergimit të pritjeve (Castelnuovo, Altimari & Palenzuela 2003)[3]. Kjo do të thotë, që në një të ardhme të afërt edhe publiku shqiptar, do të jetë më i orientuar në pritjet e tij për inflacionin, ndonëse kjo është pjesë e një procesi që në bazë ka besueshmërinë e tij ndaj Bankës së Shqipërisë, si edhe transparencën që kjo e fundit ka ndaj publikut.

[2] Elementet ponderuese janë 0.3 për bizneset dhe 0.7 për konsumatorët (pesha e secilit grup ndaj totalit).
[3] Atorët e mbështetin këtë përfundim, për një numër vendesh të industrializuara.

Box 1: Vrojtimet e IBB dhe IBK dhe pritjet për inflacionin.

Figura 4 paraqet një përpjekje për shfrytëzimin e vrojtimeve të IBK dhe IBB për matjen e pritjeve inflacioniste të publikut. Nga figura vihet re një sfazim në tendencat e inflacionit të pritur dhe të atij faktik. Modifikimi i pyetësorit për inflacionin pritet të sjellë një pamje më të qartë të inflacionit të pritur nëpërmjet vrojtimeve[4]. Po kështu, rritja e numrit të vrojtimeve, do të mundësojë zbatimin e metodologjisë së kuantifikimit të pritjeve, mbi seri më të plota kohore duke i bërë ato më të besueshme.



Grafik 4. Norma e pritur e inflacionit ndaj asaj të realizuar.

Më tepër informacion lidhur me politikat e pagave në vendin tonë na ofron pyetja 1 mbi frekuencën e rishikimit të pagave. Nga rezultatet e vrojtimit del se përgjithësisht firmat nuk zbatojnë politika të përcaktuara indeksimi, dhe kjo është veçanërisht e theksuar në industrinë e ndërtimit, ku 70 për qind e bizneseve raportojnë mungesën e politikave të rishikimit. Edhe këtu vërehet një asimetri ndërmjet konsumatorëve dhe punëdhënësve. Kështu, konsumatorët në masën 65.4 për qind shprehen për nevojën e indeksimit me bazë vjetore, ndërkohë që mesatarisht 56 për qind e bizneseve raportojnë mungesën në realitet të politikave të indeksimit.

Zgjedhja e indeksimit me bazë vjetore nga ana e konsumatorëve mund të jetë shprehje e një lloj pasigurie për të ardhmen apo e njohjes së praktikave vjetore të indeksimit në sektorin publik. Mospërputhja me opinionin e bizneseve dëshmon edhe një herë për forcën e ulët negociuese në tregun e punës.

Opinionet e publikut (konsumatorëve dhe bizneseve) sugjerojnë se në mungesë të politikave të indeksimit apo në praninë e politikave me bazë vjetore, ekziston një shkallë e lartë fleksibiliteti pagash. Ky fakt mund të përbëjë njëfarë interesi për politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, meqënëse në kushtet e pritjeve të ankoruara, efektet e politikës së saj monetare do të mund të transmetoheshin më shpejt në nivelin e pagave dhe për rrjedhojë, në nivelin e çmimeve.

Duket një sinjal pozitiv fakti që del nga pyetja 4, se inflacioni i publikuar është një informacion, i cili ndiqet rregullisht nga konsumatorët. Ai renditet i pari ndër treguesit për të cilët konsumatori shqiptar është më i interesuar.

[4] *Detaje mbi metodën e përdorur për matjen e pritjeve nëpërmjet vrojtimeve, si dhe modifikimet e pritshme në zbatimin e saj mund të gjenden në materialin e brendshëm "Matja e pritjeve" (R.Nasto, DK).*

Ky informacion mbështet faktin se nga njëra anë aspekti edukativ i Bankës së Shqipërisë ka ardhur duke u rritur nga njëri vit në tjetrin dhe nga ana tjetër duket se do të jetë, pikërisht, ky publik i përgatitur në të ardhmen e afërt që do të mund të bëhet pjesë aktive në kuptimin e sinjaleve që politika monetare "do të lëshojë".

Ndonëse edhe nga bizneset treguesi i inflacionit është mjaft i ndjekur, megjithatë ai renditet pas kursit të këmbimit. Interesimi i lartë i bizneseve në drejtim të kursit të këmbimit është i shpjegueshëm me rëndësinë e tij në përcaktimin e kostove, sidomos për bizneset që kanë aktivitet importi. Ndërkohë që informacioni mbi normat e interesit është me interes për faktin e ndikimit që ato kanë në nivelin e kredimarrjes për biznesin.

Përsa i takon informacionit mbi normat e interesit duket se konsumatorët janë ende larg tij. Familjariteti i kufizuar i publikut shqiptar me këto norma gjykohet se është i lidhur me kreditimin aktualisht të kufizuar në ekonominë shqiptare dhe me mungesën e një tregu aktiv financiar.

3. KONKLUZIONE

Në këtë analizë janë trajtuar disa ide paraprake mbi pritjet për inflacionin dhe perceptimet e publikut në lidhje me këtë tregues. Sugjerojmë se ato mund të shërbejnë si pikë krahasimi për studime të mëtejshme në këtë drejtim.

Asimetria ndërmjet pritjeve të konsumatorëve dhe atyre të bizneseve, lidhet me interesat e ndryshëm që këto grupe kanë në treg. Nga ana tjetër analiza verifikon se tregu i kontratave të punës është në favor të punëdhënësve, duke evidentuar aspektin krejtësisht të zbehtë të sindikatave. Problemi i indeksimit të pagave përballë rritjes së pritshme të çmimeve nuk mbështetet nga bizneset, ndërkohë që kërkohet nga konsumatorët.

Kjo bën që kanali i transmetimit të pritjeve inflacioniste të publikut në nivelin e pagave e më pas të çmimeve, të mos jetë i plotë.

Inflacioni i pritshëm i perceptuar për vitin 2004, do të rezultonte rreth 3.4 për qind, brenda kufijve të parashikuar nga banka qendrore. Krahasuar inflacionin e faktuar, në fund të vitit 2004 (2.2 për qind), duket se pritjet rezultuan më të forta, fakt që verifikon deri-diku, mbivlerësimin e këtij treguesi nga ana e publikut.

Për Bankën e Shqipërisë si institucion përgjegjës i politikës monetare, është e rëndësishme njohja e nivelit të pritjeve inflacioniste dhe efektet e tyre në nivelin e çmimeve ose ndryshe, njohja e elementeve të spiralit pritje-pagë-çmime.

Ndërkohë që ky material sjell disa përfundime mbi hallkën e parë të këtij spirali, do të ishte me interes të çohej më tej studimi i hallkës së dytë, dhe më konkretisht, konsideratat mbi të cilat bazohet sjellja çmim-vendosëse e

bizneseve, për të identifikuar rreziqet e mundshme me të cilat përballet ruajtja e stabilitetit të çmimeve në Shqipëri.

Është me interes për Bankën e Shqipërisë që ndjekja nga ana e publikut e treguesit të inflacionit, jep një sinjal shumë pozitiv për shkallën në rritje të njohjes së tij. Ndoshta, politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të ishte në të njëjtën shkallë e interesuar edhe për njohjen nga ana e publikut e normave të interesit, fakt që nuk dëshmohet nga informacioni i sjellë nga kjo analizë. Janë sinjalet e dhëna nëpërmjet normave të interesit, të cilat përcjellin mesazhe për mbajtjen e inflacionit në nivelet e parashikuara.

Do të rekomandonim, që një pyetësor i tillë të aplikohej jo vetëm çdo tremujor për të evidentuar tendencat dhe për t'i vlerësuar ato nga pikëpamja sasiore, siç edhe realisht veprohet në vrojtimet e IBB dhe IBK, duke krijuar kështu hap pas hapi një seri pritjesh për inflacionin, por ai të ishte në fund të vitit, më sasior, për të marrë informacion specifik, vetëm për pritjet dhe burimet që do t'i krijonin ato gjatë vitit të ardhshëm. Vlerësime të tilla, do të ndihmonin në pasurimin e skenarëve parashikues për inflacionin duke qartësuar kanalin e pritjeve në skemën e transmisionit të politikës monetare.

LITERATURA:

Banka e Shqipërisë, "Treguesit e besimit të biznesit dhe të konsumatorit", IBB dhe IBK, (2002-2004). Materiale të papublikuara.

Banka e Shqipërisë, Raport Statistikor, dhjetor 2004, www.bankofalbania.org.

Castelnuovo E., Nicoletti S., Rodriguez-Palenzuela R. (2003), "Definition of Price stability, range and point inflation targets: The anchoring of long term inflation expectations" ECB Working paper.273.

Nasto R., "Matja e Pritjeve" (2005), Material diskutimi në proces, Banka e Shqipërisë.

BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN E TRE MUAJVE (JANAR – MARS 2005)

"Problemet e politikës monetare dhe parashikimi i inflacionit" – Seminar i organizuar nga Banka e Shqipërisë

Më datë 26 janar 2005, në mjediset e hotel "Tirana International", u organizua seminari me temë "Problemet e politikës monetare dhe parashikimi i inflacionit". Qëllimi i këtij seminari ishte organizimi i një diskutimi mes ekspertëve nga bankat qendrore të vendeve fqinje dhe më gjerë, për çështje të politikës monetare dhe parashikimit të inflacionit, të rritjes së transparencës, çështje të parashikimit të likuiditetit etj..

Në fjalën e tij, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, shprehu disa mendime mbi politikën monetare dhe procesin e parashikimit të inflacionit të bankave qendrore dhe në veçanti të Bankës së Shqipërisë. Duke përmendur rezultatet e mira që ka arritur politika monetare vitet e fundit në drejtim të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, ai vuri theksin mbi punën e nisur nga Banka e Shqipërisë me asistencën e FMN-së, për ndërtimin e modeleve më të pasura strukturore për parashikimin e inflacionit, që t'i përshtaten më mirë zhvillimeve aktuale dhe të pritshme të ekonomisë.

Njëkohësisht, z.Fullani shprehu synimin e Bankës së Shqipërisë për mbajtjen e inflacionit në nivele të ulëta dhe angazhimin e saj për të vazhduar më tej reformat strukturore, me qëllim zgjerimin e ndërmjetësimit të sektorit bankar dhe rritjen e përdorimit të shërbimeve financiare. Në këtë drejtim, ai përmendi strategjinë e hartuar nga Banka e Shqipërisë, në konsultim të ngushtë me bankat e nivelit të dytë, me institucionet qeveritare dhe me sektorin privat, për rritjen e përdorimit të sistemit bankar në aktivitetin e përditshëm të biznesit, në kuadrin e reduktimit të ekonomisë *cash*.

Banka e Shqipërisë i jep bankës së propozuar "Union Bank" sh.a., miratimin paraprak për licencën për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e tij të datës 9 shkurt 2005, miratoi dhënien e licencës paraprake për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, bankës së propozuar "Union Bank" sh.a.". Ky vendim u mor mbështetur në konkluzionet e Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë lidhur me plotësimin nga ana e subjektit, të të gjitha kushteve të parashikuara në ligjin nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe të kërkesave e akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në formim Union Bank do të jetë në përputhje me ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe me licencën e marrë nga Banka e Shqipërisë.

Mbahet Kongresi i Parë i Kontabilistëve dhe Financierëve

Në datën 10 shkurt 2005, në Pallatin e Kongreseve, u zhvillua Kongresi i Parë i kontabilistëve dhe i financierëve shqiptarë, ngjarja e parë e këtyre përmasave në Shqipëri. Në këtë kongres, profesionistë të fushës diskutuan

mbi probleme të rëndësishme të kontabilitetit dhe të financës duke vënë theksin mbi sfidat e mëdha të së ardhmes, lidhur me unifikimin e evidencave kontabël në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raporteve Financiare, gjë që do të çojë sigurojë një pasqyrim më real të gjendjeve të llogarive dhe do të ndihmojë për një kontroll më të mirë mbi ekonominë informale dhe evazionin fiskal.

Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë me bizneset dhe me shoqëritë e shërbimeve utilitare

Përdorimi i instrumenteve moderne të pagesave, përparësitë dhe përfitimet e grupimeve të ndryshme të interesit prej përdorimit të tyre, si dhe kontributi i tyre real në uljen e ekonomisë cash dhe asaj informale, ishin këto linjat kryesore ku u përqëndrua tryeza e punës e thirrur nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani, në 25 shkurt 2005, në mjediset e hotel "Sheraton", me përfaqësues të bizneseve publike, private dhe shoqërive të shërbimeve utilitare.

Përfitimet do të përfshijnë gjithë ekonominë shqiptare në tërësi, nëpërmjet reduktimit të cash-it dhe të ekonomisë informale, rritjes së depozitave dhe vëllimit të kredisë në ekonomi, si dhe forcimit e konsolidimit të mëtejshëm të sistemit bankar vendas, por në veçanti biznesin, i cili do të mund të regjistrojë si përparësi të tij uljen e kostos dhe përmirësimin e kontrollit të procesit të mbledhjes së faturave, përmirësimin e shërbimit ndaj publikut si dhe zgjerimin e forcimin e marrëdhënieve të tij me bankën.

Nga kjo pikëpamje, në diskutimin e tij, z. Fullani theksoi hapat e hedhur deri tani në botën moderne të pagesave, duke tërhequr vëmendjen rreth disa produkteve të pagesave bankare, të realizuara apo të pritshme për t'u kryer në një periudhë të shkurtër, si për shembull: krijimi i sistemit të kryqëzimit të pagesave në vlerë të vogël ku kompanitë utilitare do të jenë përfituesit kryesorë; zgjerimi gjeografik i degëve dhe i shërbimeve bankare; futja e Internet Banking; ofrimi i pagesave me kartë brenda dhe jashtë vendit, për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, si dhe fillimi i bashkëpunimit mes bankave për krijimin e rrjeteve të përbashkëta të përdorimit të kartave plastike.

Në përfundim z. Fullani parashtroi si sfidë të ardhshme të sistemit bankar, krijimin e një rrjeti shlyerjeje të përbashkët për pagesat ndërbankare kombëtare me kartë, zgjerimin e shkallës së penetrimit të kartave si dhe të pranisë së terminaleve të pagesës në pikat e shitjes – ose ndryshe, krijimin e një "karte unike" për të gjithë sistemin.

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes bankare midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë

Në datën 23 mars 2005, në ambientet e hotel "Adriatik", Durrës, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes bankare midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë. Memorandumi u nënshkrua nga Zëvendësguvernatorja e Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë, zj.Emilija Nacevska dhe Zëvendësguvernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë, z.Limos Malaj.

Memorandumi i Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes bankare përfaqëson një dokument, i cili përmban parimet mbi marrëdhëniet midis dy institucioneve

në drejtim të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit rreth situatës së sistemeve bankare në vendet përkatëse. Këto parime do të zbatohen në funksion të legjislacioneve përkatëse në Shqipëri dhe në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, memorandumi do t'i shërbejë integrimit dhe stabilitetit financiar të të dyja palëve.

Zhvilloi punimet Konferenca e Pestë e Bankës së Shqipërisë "Banka qendrore në kohën e integrimit"

Në datat 24 -25 mars 2005, në hotelin "Adriatik", Durrës, zhvilloi punimet Konferenca e Pestë e Bankës së Shqipërisë "Banka qendrore në kohën e integrimit". Në këtë konferencë morën pjesë shumë të ftuar nga vendi, institucionet ndërkombëtare, personalitete të fushës akademike dhe bankare, të cilët hodhën ide dhe diskutuan probleme të rëndësishme, në përshtatje me realitetin ekonomik shqiptar.

Diskutimet në konferencë u përqendruan në dy tema kryesore të bankës qendrore: atë të stabilitetit të çmimeve, kryesisht në efektivitetin e politikës monetare dhe pavarësinë e bankës qendrore, si dhe të zhvillimit e qëndrueshmërisë të sektorit financiar.

Gjithashtu folësit trajtuan edhe çështje të tilla kryesore si qartësimi i kanaleve të politikës monetare dhe rritja e efektivitetit të instrumenteve të saj, roli i pavarësisë, jo vetëm për politikën monetare por edhe për stabilitetin dhe zhvillimin e sektorit financiar, rëndësia e koordinimit të mirë midis politikës monetare dhe fiskale, si dhe ajo e krijimit të një tregu të vërtetë financiar ku të gjithë aktorët të njohin rregullat e lojës dhe t'iu binden atyre me ndershmëri.

Nga të ftuarit u pranua gjerësisht se sistemi bankar është një segment i rregulluar dhe i mbikëqyrur mirë, i cili në kontekstin e zhvillimeve të fundit ka krijuar më shumë besueshmëri në publik, por që ka vend për rishikim të kuadrit ligjor dhe atij rregullator, veçanërisht në drejtim të rritjes së fleksibilitetit të tregut valutor, politikave të kreditimit dhe tregut të parasë.

Konferenca u mbyll me paraqitjen, nga ana e Guvernatorit Fullani të konkluzioneve të konferencës, ku mes të tjerash, ai apeloi për një rritje të frymës së bashkëpunimit jo vetëm brenda vendit por dhe në kuadrin rajonal e më gjerë, në rrugën drejt zhvillimit dhe integrimit.

Banka e Shqipërisë ul me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit

Me një vendim të tij të datës 30 mars 2004, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi uljen e normës bazë të interesit me 0,25 pikë përqindjeje. Pas këtij ndryshimi, norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes (repo) zbriti në 5.0 për qind, duke shënuar kështu një tjetër minimum historik që nga periudha e përdorimit të saj si instrumenti kryesor i zbatimit të politikës monetare.

Ulja e normës bazë të interesit synon të rrisë edhe më tej stimulin monetar, të akumuluar nga hapat lehtësues të politikës monetare të ndërmarë gjatë vitit të kaluar. Reduktimi i normës bazë të interesit pritet të ndikojë në uljen e normave të interesit të segmenteve të tregut financiar në lekë: të tregut

ndërbankar; të tregut të depozitave në lekë; të tregun të bonove të thesarit; dhe të tregut të kredive në lekë. Ulja e normave të interesit do të nxisë kërkesën për kredi në lekë, duke rritur peshën e saj në kredi dhe duke krijuar kushte për përshpejtimin e ritmeve të saj në të ardhmen.

NGJARJET JURIDIKE
JANAR – MARS 2005

POLITIKA MONETARE

Në datën 30.03.2005, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 24 "Për uljen e përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga Banka e Shqipërisë". Me këtë vendim, Këshilli Mbikëqyrës vendosi uljen me 0.25 pikë përqindjeje të normës bazë të interesit, e cila duke shkuar në 5.00 për qind, përbën sërish një minimum të ri historik.

MBIKËQYRJA

Në datën 26.01.2005, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.3 "Për një ndryshim në rregulloren për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë". Ndryshimi i kryer në këtë rregullore, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.71, datë 11.09.2002, konsiston në zëvendësimin në nenin 1, pikat 1.5 dhe 1.6, të vleftës 700 milionë lekë me vleftën 1 miliard lekë, që përfaqëson përkatësisht shumën e kapitalit fillestar minimal të paguar për licencimin e një banke dhe shumën e kapitalit fillestar minimal të dhuruar dhe të paguar, për licencimin e një dege të një banke të huaj.

Në datën 26.01. 2005, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.4 "Për caktimin e afateve të plotësimit të kërkesës për rritjen e kapitalit të kërkuar të bankave". Bankat dhe degët e bankave të huaja, sipas aktiviteteve të licencuara, detyrohen të derdhin brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit nr.3, datë 26.01. 2005 "Për një ndryshim në rregulloren për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë", 50 për qind të diferencës së kapitalit të rritur dhe pjesën e mbetur, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Në datën 09.02.2005, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.11"Për miratimin e dokumentit për misionin e mbikëqyrjes". Dokumenti ka për qëllim të përcaktojë misionin e Bankës së Shqipërisë si autoritet mbikëqyrës të bankave dhe subjekteve të tjera, si dhe mënyrat që do të përdorë ajo për realizimin e funksionit të saj, duke synuar nivelet më të larta të integritetit, të profesionalizmit, të eficiencës dhe të transparencës.

Në datën 09.02.2005, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.12 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, të bankës së propozuar "Union Bank" sh.a.". Vendimi u mor mbështetur në konkluzionet e Departamentit të Mbikëqyrjes, se

plotësohen të gjitha kushtet që kërkojnë ligji nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, si dhe ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

Në datën 30.03.2005, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.28 "Për miratimin e rregullores "Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike". Rregullorja e re përmban kushtet organizative e teknike për realizimin e shërbimit bankar në rrugë elekronike (e-banking), kryerjen e verifikimeve nga ana e Bankës së Shqipërisë për këtë shërbim, si dhe parimet e administrimit të rrezikut të veprimtarisë e-banking.

OPERACIONET MONETARE

Në datën 09.02.2005, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.13 "Për miratimin e kontratës - tip për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të letrave me vlerë ". Marrëveshja lidhet mes Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve në procesin e implementimit të instrumenteve monetare. Hartimi dhe miratimi i saj përbën një kontribut në krijimin e tregut ndërbankar, sidomos në drejtim të nxitjes së kredidhënies së kolateralizuar. Kontrata ka afat vlefshmërie një vit.

EMISIONI

Në datën 09.03.2005, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.18 "Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhave përkujtimore, që do të shtypen për qëllime numizmatike, në vitin 2005". Konfigurimet i përkasin monedhave metalike me prerje 10 lekë dhe pamja e monedhave do të ketë si tematikë "Tirana, 85-vjet kryeqytet, 1920 – 2005" dhe atë "Objekte të trashëgimisë kulturore".

Në datën 09.03.2005, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.19 "Për mënyrën e vlerësimit të vlerave numizmatike pa kosto, në Bankën e Shqipërisë". Vendimi erdhi pas shqyrtimit të propozimit të bërë nga ana e Departamentit të Emisionit dhe Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave, bazuar në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"; në ligjin nr.7661, datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin" si dhe në "Manualin kontabël të Bankës së Shqipërisë" miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 26.01.2001.

Në datën 30.03.2005, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë nëpërmjet vendimit nr.27 "Për shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, për vitin 2006", miratoi për qëllime numizmatike (përkujtimore), shtypjen dhe të dhënat teknike të monedhës metalike prej argjendi, me prerje 50 lekë, pa kurs ligjor, me tematikë "Kodiku i Purpurtë i Beratit - Beratinus 1".

POLITIKA BUXHETORE

Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 27.01.2005 "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2005".

POLITIKA EKONOMIKE

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 1, datë 25.01.2005 "Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike". Autoriteti për miratimin e rregullave të tregut për tregun e energjisë elektrike bazohet në ligjin nr. 9072 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe konkretisht në nenin 54 të tij.

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 2, datë 25.01.2005 "Për dhënien e licencës për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike shoqërisë GSA shpk. Afati i licencës për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike është 5 vjet.

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 3, datë 25.01.2005 "Për dhënien e licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike shoqërisë GSA sh.p.k. Afati i licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike është 1 vit.

DREJTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË
31 MARS 2005

KËSHILLI MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI	*Kryetar*
FATOS IBRAHIMI	*Zëvendëskryetar*
LIMOS MALAJ	*Anëtar*
SULO HADËRI	*Anëtar*
TONIN KOLA	*Anëtar*
TEFTA ÇUÇI	*Anëtare*
KSENOFON KRISAFI	*Anëtar*
ANDIS HARASANI	*Anëtar*
ELISABETA GJONI	*Anëtare*

GUVERNATORI

ARDIAN FULLANI

ZËVENDËSGUVERNATORËT

FATOS IBRAHIMI -	*Zëvendësguvernator i Parë*
LIMOS MALAJ -	*Zëvendësguvernator i Dytë*

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

ELSA BIZHGA

DEPARTAMENTET DHE NJËSITË E TJERA

GRAMOZ KOLASI	*Departamenti i Politikës Monetare*
ERJON LUÇI	*Departamenti i Kërkimeve*
MARJAN GJERMENI	*Departamenti i Operacioneve Monetare*
KLODION SHEHU	*Departamenti i Mbikëqyrjes*
SONILA TAÇI	*Departamenti i Emisionit*
LLAZI BALLIU	*Departamenti i Kontabilitetit dhe i Pagesave*
XHILDA DELIANA	*Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave*
DASHAMIR HALILAJ	*Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Juridik*
INA KRAJA	*Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun*
ELSA BIZHGA	*Departamenti i Kontrollit*
AGRON SKËNDERAGA	*Departamenti i Shërbimeve Logjistike*
ALFONS THEKA	*Shtypshkronja*

DEGËT

ERMIRA ISTREFI	*Shkodra*
VALENTINA DEDJA	*Elbasani*
ANILA THOMAJ	*Gjirokastra*
LILJANA ZJARRI	*Korça*
SHPRESA MEÇO	*Lushnja*

LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË

BANKA DHE DEGË TË BANKAVE TË HUAJA

1. BANKA ITALO – SHQIPTARE SH.A
Licenca nr.1/1996, datë 17.07.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.89, datë 18.06.1998. Çertifikata nr. 1 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori : Giovanni BOGANI
Adresa: Rruga e Barrikadave, Nr.70, Tiranë.
Tel. Central: 23 56 97, 23 56 98, 22 62 62.
Faks: 23 30 34.

2. BANKA RAIFFEISEN SH.A
Licenca nr.2/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.163, datë 11.12.1998. Çertifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Steven GRUNERUD
Adresa: Rruga e Kavajës, Tiranë.
Tel. Central: 22 45 40, 22 26 69, 22 54 16.
Faks: 22 35 87, 22 36 95, 22 40 51.

3. BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A
Licenca nr.3/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.165, datë 11.12.1998.
Çertifikata nr.3 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Abdul Waheed ALAVI
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.8, Tiranë.
Tel. Central: 22 84 60, 22 38 73, 22 74 08.
Faks: 22 84 60, 22 83 87.

4. BANKA DARDANIA SH.A
Licenca nr.5/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.164, datë 01.12.1998. Çertifikata nr.4 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Beqir MEZELXHIU
Adresa: Bulevardi "Zogu I" (pranë Fakultetit të Shkencave), Tiranë.
Tel. Central: 22 87 59, 25 93 50, 25 93 51.
Faks: 23 05 66.
Email: db@albaniaonline.net ; dardaniabank@hotmail.com

5. BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A
Licenca nr.6/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.162, datë 11.01.1999. Çertifikata nr.5 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Seyhan PENCAPLIGIL
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë.
Tel: 25 09 55.
Faks: 25 09 56.

** Deri në 31 mars 2005.*

6. BANKA TIRANA SH.A
Licenca nr.07, datë 12.09.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.9, datë 12.09.1996. Çertifikata nr.6 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Dimitrios FRANGETIS*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Nr.55/1, Tiranë.*
Tel. Central: *23 34 41/42/43/44/45/46/47.*
Faks: *23 3417.*

7. BANKA KOMBETARË E GREQISË - DEGA TIRANË
Licenca nr.08, datë 25.11.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.4, datë 14.03.1996. Çertifikata nr.7 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Spiro BRUMBULLI*
Adresa: *Rruga e Durrësit, Godina "Comfort", Tiranë.*
Tel. Central: *23 36 21/22/23/24.*
Faks: *23 36 13.*

8. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A
Licenca nr.09, datë 20.02.1997.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.9, datë 30.04.1996. Çertifikata nr.8 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Ooi Kooi KEAT*
Adresa: *Qendra e Biznesit, Rruga "Murat Toptani", Tiranë.*
Tel. Central: *23 75 67/68/69.*
Tel/Faks: *23 75 70.*

9. DEGA NË TIRANË E BANKËS ALPHA
Licenca nr.10, datë 07.01.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.01/03/96, datë 27.12.1997.
Çertifikata nr. 9 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Andrea GALATOULAS*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Nr.47, Tiranë.*
Tel: *23 35 32, 23 33 59, 34 04 76/77.*
Tel/Faks: *23 21 02.*

10. BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË SH.A.
Licenca nr.11, datë 10.08.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 10.08.1998. Çertifikata nr.10 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Lorenzo RONCARI*
Adresa: *Rruga "Ismail Qemali" Nr.27, P.O. Box 8319, Tiranë.*
Tel.: *24 87 53/54/55/56.*
Tel/Faks: *24 87 62.*

11. BANKA PROCREDIT SH.A.
Licenca nr. 12, datë 15.03.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 03.03.1999. Çertifikata nr. 11 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Ralf REITEMEIER*
Adresa: *Rruga "Sami Frashëri", Tirana e Re, P.O. Box. 2395, Tiranë.*
Tel: *27 12 72/73/74/75.*
Tel/Faks: *23 34 81.*

12. DEGA NË TIRANË E BANKËS SË PARË TË INVESTIMEVE SH.A
Licenca nr. 13, datë 16.04.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.45, datë 13.04.1999. Çertifikata nr. 12 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Petar Gavrillov KRASTEV*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Nr. 64, Tiranë.*
Tel: *35 64 23, 35 64 24.*
Tel/Faks: *35 64 22.*

13. BANKA EMPORIKI – SHQIPËRI SH.A.
Licenca nr. 14, datë 28.10.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999. Çertifikata nr. 13 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *George CARACOSTAS*
Adresa: *Rruga e Kavajës, "Tirana Tower", Tiranë.*
Tel: *25 87 55/56/57/58/59/60.*
Tel/Faks: *25 87 52.*

14. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.66, datë 28.08.2002. Çertifikata nr. 14 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Kamal Abdel MONEIM*
Adresa: *Rruga "Perlat Rexhepi", Al-Kharafi Group Administration Building, Kati 1&2, Tiranë.*
Tel.: *27 21 68; 27 21 62.*
Tel/Faks: *27 21 62.*
E-mail: *creditbkalb@icc-al.org*

15. BANKA "CREDINS" SH.A.
Licenca nr. 16, datë 31.03.2003.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 26.03.2003. Çertifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Artan SANTO*
Adresa: *Rruga ''Ismail Qemali'', Nr.21 Tiranë.*
Tel: *22 29 16; 23 40 96.*

16. BANKA POPULLORE SH.A.
Licenca nr.17, datë 16.02.2004.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.06, datë 11.02.2004. Çertifikata nr.16 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Edvin Libohova*
Adresa: *Rruga ''Donika Kastrioti'', Pall.11/1, Kati I, Tiranë.*
Tel: *27 27 88/8990/91.*
Faks: *27 27 81*

SUBJEKTE JOBANKA

1. UNIONI FINANCIAR I TIRANËS SH.P.K. (UFT)
Licenca nr.1, datë 08.12.1999, për ushtrimin e veprimtarive financiare:
- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar.

Drejtor: *Niko Leka; Edmond Leka*
Adresa: *Rruga "Reshit Çollaku", Pall. "Shallvare", Sh.2, Nr.18, Tiranë.*
Tel: *25 06 53.*
Faks: *25 06 54*

2. DINERS CLUB ALBANIA SH.P.K.
Licenca nr.2, datë 09.10.2000, për ushtrimin e veprimtarisë financiare:
- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare.

Drejtor: *Vebi Velia*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit VEVE, Tiranë.*

3. POSTA SHQIPTARE SH.A.
Licenca nr.3, datë 18.04.2001, për ushtrimin e veprimtarive financiare:
- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar.

Pronësia : *Shtetërore.*
Drejtore : *Luiza Hoxha.*
Adresa: *Rruga "Reshit Çollaku", Nr.4 Tiranë.*
Tel: *22 23 15.*

4. "CREDINS" SH.A. TIRANË
Licenca nr. 4, datë 13.06.2001, për ushtrimin e veprimtarive financiare:
- të dhënies së kredive;
- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- të ofrimit të garancive;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikat 3/a dhe 3/b të nenit 26, të ligjit: "Për bankat në Republikën e Shqipërisë").

Drejtore: *Monika Milo*
Adresa: *Rruga "Ismail Qemali", Nr.21, Tiranë.*
Tel: *22 29 16; 23 40 96.*

5. FONDI I FINANCIMIT TË ZONAVE MALORE
Licenca nr.5, datë 29.03.2002, si subjekt financiar jobankë, për ushtrimin e veprimtarisë financiare:
- të dhënies së kredive.
Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Drejtori: *Arben Jorgji*
Adresa: *Rruga "Mustafa Matohiti", Vila nr.12, Tiranë.*
Tel: *25 06 33.*

6. "AK – INVEST" SH.A.
Licenca nr.7, datë 03.12.2003, si subjekt financiar jobankë, për ushtrimin e veprimtarive financiare:
- të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- të shërbejë si agjent dhe këshilltar financiar.

Administratori: Ilir Adili
Adresa : Rruga "Ded Gjon Luli", Nr.2/3, Tiranë.
Tel: 24 01 47.

7. TIRANA LEASING SH.A.
Licenca nr. 8, datë 08.11.2004

Drejtori : Fatos Aliaj
Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Pall. Samos Tower, Kati II, Zyra 2/1 B, Tiranë.
Tel: 26 97 05/06.

SUBJEKTET FINANCIARE QË NUK LICENCOHEN NGA BANKA E SHQIPËRISË PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË TYRE, NË MBËSHTETJE TË VENDIMIT NR. 26, DATË 29.03.2000, TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË "PËR PËRJASHTIMIN E DISA SUBJEKTEVE NGA ZBATIMI I DISPOZITAVE TË LIGJIT NR. 8365, DATË 02.07.1998 "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"".

(Këto subjekte nuk licencohen apo mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, por kanë detyrimin të raportojnë në Bankën e Shqipërisë.)

1. FONDI I FINANCIMIT RURAL
Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 28.04.1999.
Objekti i veprimtarisë: Financimi i zonave rurale.
Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr.1843, datë 01.08.2000.

Drejtore: Zana Konini.
Adresa: Rruga"Ismail Qemali", P.32, Tiranë.

2. FONDACIONI "BESA"
Themeluar nga "Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë" (SOROS).
Objekti i veprimtarisë: Financimi i ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla.
Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 2895/1, datë 19.01.2001.

Drejtori: Bajram Muça.
Adresa: Rruga "Asim Vokshi", Nr. 35, Tiranë.

3. PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI
Aksioner: "Opportunity International" (East Europe).
Objekti i veprimtarisë: Kredidhënia.
Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 828/1, datë 08.04.2002.

Drejtori James Reiff.
Adresa: Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr. 7/1, Tiranë.

ZYRA TË KËMBIMEVE VALUTORE

1. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "JOARD" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 1, datë 01.10.1999.*
Adresa: *Rruga "Ded Gjon Luli", Nr.2, Tiranë.*
Kambistë: *Josif Kote, Pajtim Kodra.*

2. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "AMA" SH.P.K., DURRËS
Licenca: *Nr. 2, datë 01.10.1999.*
Adresa: *Rruga "Tregtare", Lagja 3, Durrës.*
Kambistë: *Mirlinda Ceka, Ilir Hoxha.*

3. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARIS" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 3, datë 01.10.1999.*
Adresa: *Rruga "Luigj Gurakuqi" , Tiranë.*
Kambistë: *Ardian Goci, Ismet Noka.*

4. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI FINANCIAR TIRANË" SH.P.K.
Licenca: Nr. 4, datë 01.10.1999.
Adresa: *Rruga "Reshit Çollaku", "Pall. Shallvare", Shk. 2/18, Tiranë.*
Administrator: *Niko Leka*
Kambistë: *Arjan Lezha (Përgjegjës i agjencisë), Albert Sara, Dhimitër Papadhopulli, Genta Angjeli (Agalliu), Piro Teti, Flora Simixhi, Petrika Mano (Përgjegjës i agjencisë), Lindita Shala, Mirela Bakalli, Anila Demiri, Emili Bakalli (Nako), Astrit Sfërdelli, Mirela Kaiku, Erisa Emiri.*

5. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "AGLI" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 5, datë 01.10.1999.*
Adresa: *Agjencia 1: Rruga "Islam Alla", Nr.1, Tiranë.*
Agjencia 2: Rruga e Kavajës, pranë Pastiçeri "Rinia", Tiranë.
Kambistë: *Kujtim Nina (Drejtor i Shoqërisë), Agim Cani, Selim Luli.*

6. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EXCHANGE" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 08, datë 24.11.1999.*
Adresa: *Rruga e Durrësit, Nr. 170, Tiranë dhe Rruga "Reshit Çollaku", Pallati Shallvare, Shk.2, Ap. 42, Tiranë*
Kambistë: *Ivan Pavllovski, Ervis Myftari.*

7. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNISIX" SH.P.K., KORÇË
Licenca: *Nr. 09, datë 26.11.1999.*
Adresa: *Bulevardi "Republika", Pall.4, Korçë.*
Kambistë: *Pandi Cunoti, Ernest Golka, Nikolin Bicka, Eli Bode.*

8. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EKSPRES J & E" SH.P.K., DURRËS
Licenca: *Nr. 10, datë 26.11.1999.*
Adresa: *Lagja 11, Rruga "Prokop Meksi" (pranë Hotel "Durrësi"), Durrës.*
Kambistë: *Kostandin Ekonomi, Entela Ekonomi.*

9. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ILIRIA '98" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 12, datë 25.02.2000.*
Adresa: *Sheshi "Skënderbej", Teatri i Kukullave, Tiranë.*
Kambistë: *Edmond Ymeri, Ali Topalli, Ilir Janku.*

10. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "SERXHIO" SH.P.K., ELBASAN
Licenca: *Nr. 14, datë 07.04.2000.*
Adresa: *Lagja "Luigj Gurakuqi", Rruga "11 Nëntori", Pall. 70, Nr.14, Elbasan.*
Kambistë: *Amarildo Canoku.*

11. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBTUR" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 15, datë 07.04.2000.*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Pall. 32, Shk.1 (përballë Bankës Tirana), Tiranë.*
Kambistë: *Albert Rahmani, Artur Rahmani.*

12. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "R & M" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 16, datë 22.05.2000.*
Adresa: *Rruga "Punëtorët e Rilindjes", Pall.182, Tiranë.*
Kambistë: *Edmond Stepa, Miranda Stepa.*

13. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TEUTA 2000" SH.P.K., DURRËS
Licenca: *Nr. 17, datë 22.05.2000.*
Adresa: *Lagja 4, Rruga "Skënderbej", Ap. 950, Durrës.*
Kambistë: *Adelina Hoxha, Arben Çuni.*

14. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "T & E" SH.P.K., DURRËS
Licenca: *Nr. 18, datë 11.06.2000.*
Adresa: *Lagja 4, Rruga "9 Maji", Durrës.*
Kambist: *Shpëtim Hysa.*

15. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "SHIJAK 2000" SH.P.K., SHIJAK
Licenca: *Nr. 19, datë 24.11.2000.*
Adresa: *Lagja "Popullore", Shijak.*
Kambistë: *Nazmi Ademi, Farije Ademi.*

16. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "R & T" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 20, datë 20.12.2000.*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I" (pranë BPI-së), Tiranë.*
Kambist: *Renis Tershana.*

17. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MANUSHI" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 22, datë 18.04.2001.*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit VEVE, Tiranë.*
Kambist: *Roland Manushi.*

18. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI SELVIA" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 23, datë 21.05.2001.*
Adresa: *Godina 2-katëshe në krah të Postës Qendrore, Kati I, Tiranë.*
Kambistë: *Leonat Zenelaj, Gani Xhaja.*

19. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "KALENJA" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 24, datë 29.06.2001.*
Adresa: *Rruga e Kavajës (pranë Ambasadës Turke), Tiranë.*
Kambistë: *Hair Shametaj, Fatmir Shametaj.*

20. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TILBA" SH.P.K., ELBASAN
Licenca: *Nr. 25, datë 30.09.2001.*

Adresa: *Lagja "Luigj Gurakuqi", Bulevardi "Qemal Stafa", Njësia nr.12, Elbasan.*
Kambistë: *Kristaq Bako, Vjollca Bako.*

21. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ANAGNOSTI" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 26, datë 31.10.2001.*
Adresa: *Zyra 1: Bulevardi "Zogu I", Pall. 97, Shk.3, Ap, 28, Tiranë.*
Kambistë: *Jani Anagnosti, Odise Anagnosti, Edlira Anagnosti.*
Zyra 2: Rruga "Kajo Karafili", Nr.11 Tiranë.
Kambist: *Fredi Cami.*

22. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "KO-GO" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 27, datë 12.11.2001.*
Adresa: *Rruga "Vaso Pasha", Pall.16, Shk.2, Ap. 9, Tiranë.*
Kambistë: *Mihal Konomi, Perparim Goxhaj.*

23. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALB- FOREX" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 28, datë 22.11.2001.*
Adresa: *Agjencia 1: Rruga "Abdyl Frashëri, Nr.3, Tiranë.*
Kambistë: *Almir Duli, Agim Xhemo.*
Agjencia 2: *Rruga "Mine Peza", Pall. 102, Shk.1 (pranë Bar "Grand"), Tiranë.*
Kambist: *Fatmir Baholli.*

24. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "L&N" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 29, datë 22.11.2001.*
Adresa: *Rruga "Muhamet Gjollesha", ish Gjelltorja tek sheshi ATATURK, Tiranë.*
Kambist: *Leonora Mihalcka.*

25. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EXHANGE ALOG" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 31, datë 22.11.2001.*
Adresa: *Rruga "Mine Peza" (përballë Selisë së Vatikanit), Tiranë.*
Kambistë: *Almida Sterio, Fatmir Tafaj, Eduard Andoni, Elida Hasamemi.*

26. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BASHKIMI 2001" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 35, datë 12.12.2001.*
Adresa: *Rruga e Kavajës (Pastiçeri "Rinia"), Tiranë.*
Kambistë: *Bashkim Shametaj, Luan Shametaj, Ilir Mesini.*

27. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARJON 2002" SH.P.K., ELBASAN
Licenca: *Nr. 36, datë 14.12.2001.*
Adresa: *Lagja "Kongresi i Elbasanit", Bulevardi "Qemal Stafa", Pall. 9-katësh, Elbasan.*
Kambistë: *Arben Kovaçi, Besnik Lulja.*

28. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALAKTH" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 42, datë 18.01.2002.*
Adresa: *Rruga e Dibrës, Nr.105/1, Tiranë.*
Kambistë: *Kosta Papa, Arben Memko, Lorenc Konomi, Thoma Konomi, Aleko Plaku.*

29. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "FORMAT" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 43, datë 21.01.2002.*
Adresa: *Rruga e Durrësit, Pall.85, Shk.1, Ap.1, Tiranë.*
Kambistë: *Diana Lemi, Egon Sinani.*

30. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TRI URAT" SH.P.K., ELBASAN
Licenca: Nr. 44, datë 05.02.2002.
Adresa: Lagja "29 Nëntori", pranë Filialit të Postës Elbasan.
Kambistë: Fahri Sanco, Ismail Bejta.

31. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BESA 2001" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 46, datë 15.02.2002.
Adresa: Rruga "Myslym Shyri", Nr.25,Tiranë.
Kambistë: Belul Lleshi, Vladimir Avda, Mimoza Avda.

32. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MARIO" SH.P.K., SARANDË
Licenca: Nr. 47, datë 14.03.2002.
Adresa: Lagja 1, pranë ish-Komitetit Ekzekutiv të rrethit Sarandë.
Kambistë: Vangjel Gramozi, Blerim Dhima.

33. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "JAV" SH.P.K., TIRANË.
Ka ndryshuar emrin Zyra e Këmbimit Valutor "R&T EXCHANGE" Sh.p.k.
Licenca: Nr. 48, datë 20. 03.2002.
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina e "Zërit të Popullit", Tiranë.
Kambistë: Ervin Lera, Ilir Gurashi.

34. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "DROGU" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 49, datë 23.04.2002.
Adresa: Rruga "Vaso Pasha", Kulla 1(pas pallatit Agimi), Kati I, Tiranë.
Kambistë: Shkëlqim Drogu, Kostandin Koteci.

35. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "HYSEN-C" SH.P.K., LAÇ
Licenca: Nr. 50, datë 23.04.2002.
Adresa: Lagja nr.3, përballë Komisariatit të Policisë, Laç.
Kambist: Cen Hyseni.

36. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI FIER" SH.P.K., FIER
Licenca: Nr. 51, datë 08.05.2002.
Adresa: Lagja "15 Tetori", Rruga "Kastriot Muça", Fier.
Kambistë: Gjergj Dulaj; Lartim Isufaj.

37. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MERO" SH.P.K., DEVOLL
Licenca: Nr. 53, datë 22.05.2002.
Adresa: Zyra nr.1 : Bulevardi "Fuat Babani", Bilisht.
Zyra nr.2 : Dogana, Kapshticë.
Kambistë: Gëzim Demcolli, Valter Miza, Genti Mahmutaj, Albert Haxhia, Edmond Miza.

38. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "GLEAR" SH.P.K., SHIJAK
Licenca Nr. 55, datë 23.07.2002.
Adresa: Lagja "Kodër", Shijak, Durrës.
Kambistë: Argjend Calliku, Afërdita Calliku.

39. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "POSTA SHQIPTARE" SH.A. TIRANË
Licenca: Nr. 56, datë 28.08.2002.
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", nr.4 Tiranë.

40. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI BALLSH" SH.P.K., BALLSH
Licenca: Nr. 57, datë 11.09.2002.
Adresa: Rruga "8 Nëntori", Ballsh.
Kambistë: Luan Zenelaj, Lavdimir Zenelaj.

41. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ESLULI" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 58, datë 17.10.2002.
Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Pallati "Shallvare", Shk.4/1, Tiranë.
Kambistë: Selim Luli, Kleomen Gjiknuri.

42. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "AMERICAN GLOBAL CAPITAL FUND-ORLDWIDE INVESTMENT" SH.P.K. TIRANË
Licenca: Nr. 59, datë 26 .11.2002.
Përfaqësues me prokurë: Dashnor Shena, Vilson Ahmeti.
Adresa: Rruga "Ismail Qemali", NL Business Center, Nr.27, Tiranë.
Kambistë: Elda Skënderi, Vasil Llogoro, Arian Kokali.

43. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "DENI&KRISTI-2002" SH.P.K. TIRANË
Licenca: Nr. 61, datë 02.06.2003.
Adresa: Rruga "Myslym Shyri", Pall.60, Ap.3, Tiranë.
Kambist: Maksim Çeku.

44. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "YLDON" SH.P.K. TIRANË
Licenca: Nr. 62, datë 03. 06.2003.
Adresa: Rruga "Qemal Stafa", Pall. 382/2/2, Tiranë.
Kambist: Ylli Ndoqi (themelues dhe administrator).

45. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BILLI" SH.P.K. TIRANË
Licenca: Nr. 63, datë 16. 02.2004.
Adresa: Sheshi "Wilson", Pallati i ri në kryqëzimin e Tiranës së Re.
Kambist: Sybi Cenolli (themelues dhe administrator).

46. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBA&ARBËR" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 65, datë 06.05.2004.
Adresa: Rruga e Kavajës, Pall. 3, Kati I, Tiranë.
Kambistë: Pëllumb Memetaj, Bukurosh Jaho.

47. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "I.S.N." SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 66, datë 06.05.2004.
Adresa: Rruga e Kavajës, Pall. 3, Kati I, Tiranë.
Kambistë: Evzi Zemzadja, Nexhmi Uka, Salandi Brojaj.

48. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARIABA" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 67, datë 07.06.2004.
Adresa: Rruga "Abdyl Frashëri", pranë Librit Universitar, Kati I, Shk.5, Tiranë.
Kambistë: Agim Xhemo, Astrit Hado.

49. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBACREDITS" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 68, datë 13.07.2004.
Adresa: Rruga "Murat Toptani", Pallati 12 katësh, Kati përdhe, Tiranë.
Kambistë: Ermira Skënderi (administratore), Engjëll Skënderi, Burhan Kodra.

50. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALB-KREDIT" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr.69, datë 19.07.2004.
Adresa: Rruga "Kongresi i Përmetit", Nr.2, Tiranë.
Kambistë: Arben Cani, Vasil Marto, Rudina Muskaj, Teuta Koltarka, Hajredin Toca.

51. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "IDEA - 2" SH.P.K., KAVAJË
Licenca: No. 70, datë 02.09.2004
Adresa: Lagja nr.2, Rruga "10 korriku", Kavajë.
Kambist: Taulant Karkini (administrator).

52. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "O & G" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 71, datë 30.09.2004
Adresa: Rruga e Kavajes, përballë Kishës Katolike, Tiranë
Kambistë: Prandvera Ago (administratore), Teuta Broqi.

53. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "OMEGA" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 72, datë 20.12.2004
Adresa: Rruga "Abdyl Frashëri", Pallati 1, Shk. 2, Ap. 10, Tiranë.
Kambistë: Mihallaq Peko (administrator).

UNIONET E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT

1. UNIONI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT "JEHONA" TIRANË
Licenca: Nr.1, datë 27.06.2002.
Kryetar i bordit drejtues: Vojsava Rama.
Anëtare të këtij unioni janë 41 shoqëri të kursim-kreditit, të cilat janë të licencuara edhe si shoqëri të veçanta. Mbështeten me asistencë teknike nga Fondacioni "Lëvizja për zhvillimin e shoqërive të kursim-kredive".

2. UNIONI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT "UNIONI SHQIPTAR KURSIM-KREDITIT", TIRANË
Licenca: Nr.2, datë 09.08.2002.
Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Nr.32.
Kryetar i bordit drejtues: Zana Konini
Anëtare të këtij unioni janë 98 shoqëri të kursim-kreditit, të cilat janë të licencuara edhe si shoqëri të veçanta. Mbështeten me asistencë teknike nga Fondi i Financimit Rural.

ZYRA TË PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË HUAJA

1. ZYRA E PËRFAQËSIMIT TË BANKËS POPULLORE PULIEZE NË SHQIPËRI.
Licenca: Nr.1, datë 02.07.2003.
Përfaqësuesi: Giancarlo Stasi.
Adresa: Sheshi "Skënderbej", Pallati i Kulturës, Kati III, Tiranë.